2. Section 3.04 (*Prepayment*) is modified to read as follows:

“Section 3.04. *Prepayment*

(a) After giving not less than forty-five (45) days' notice to the Bank, the Borrower may repay the Bank the following amounts in advance of maturity, as of a date acceptable to the Bank (provided that the Borrower has paid all Loan Payments due as at such date): (i) the entire Withdrawn Loan Balance as at such date; or (ii) the entire principal amount of any one or more maturities of the Loan. Any partial prepayment of the Withdrawn Loan Balance shall be applied in the manner specified by the Borrower, or in the absence of any specification by the Borrower, in the following manner: (A) if the Loan Agreement provides for the separate amortization of specified Disbursed Amounts of the principal of the Loan the prepayment shall be applied in the inverse order of such Disbursed Amounts, with the Disbursed Amount which has been withdrawn last being repaid first and with the latest maturity of said Disbursed Amount being repaid first; and (B) in all other cases, the prepayment shall be applied in the inverse order of the Loan maturities, with the latest maturity being repaid first.



(b) If, in respect of any amount of the Loan to be prepaid, a Conversion has been effected and the Conversion Period has not terminated at the time of prepayment, the provisions of Section 4.06 shall apply.”

3. In paragraphs originally numbered 73, and 79 of the Appendix, the terms “Loan Payment” and “Payment Date”, respectively are modified to read as follows:

73. “Loan Payment” means any amount payable by the Loan Parties to the Bank pursuant to the Legal Agreements, including (but not limited to) any amount of the Withdrawn Loan Balance, interest, the Front-end Fee, the Commitment Charge, interest at the Default Interest Rate (if any), any surcharge, any transaction fee for a Conversion or early termination of a Conversion, any premium payable upon the establishment of an Interest Rate Cap or Interest Rate Collar, and any Unwinding Amount payable by the Borrower.

“79. “Payment Date” means each date specified in the Loan Agreement occurring on or after the date of the Loan Agreement on which interest, Commitment Charge and other Loan charges and fees (other than the Front-end Fee) are payable, as applicable.”

4. The definitions in paragraphs 4 (Allocated Excess Exposure Amount); 51 (Exposure Surcharge); 93 (Standard Exposure Limit) and 99 (Total Exposure) in the Appendix are all deleted in their entirety and the remaining definitions and paragraphs (as the case may be) renumbered accordingly.

DEKRET

Nr. 392, datë 17.11.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 58/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e programit ‘Aftësia ripërtëritëse dhe zhvillimi i gjelbër – hua e dytë për politikën e zhvillimit”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ

Nr. 59/2025

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN
SHITESË TË KONVENTËS PËR
KONTRATËN E TRANSPORTIT
RRUGOR NDËRKOMBËTAR TË
MALLRAVE (CMR), NË LIDHJE ME
FATURËN ELEKTRONIKE TË
NGARKESËS, BËRË NË GJENEVË,
NË DATËN 20.2.2008**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin shtesë të Konventës për Kontratën e Transportit



Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave (CMR), në lidhje me faturën elektronike të ngarkesës, bërë në Gjenevë, në datën 20.2.2008, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.10.2025.

Shpallur me dekreten nr. 393, datë 17.11.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

PROTOKOLL SHITESË

I KONVENTËS PËR KONTRATËN E TRANSPORTIT RRUGOR NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE (CMR), NË LIDHJE ME FATURËN ELEKTRONIKE TË NGARKESËS

Palët e këtij Protokoll,

duke qenë Palë të Konventës për Kontratën për Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave (CMR), të bërë në Gjenevë, më 19 maj 1956;

duke dëshiruar të plotësojnë Konventën, me qëllim lehtësimin e hartimit opsional të faturës së ngarkesës me anë të procedurave të përdorura për regjistrimin dhe trajtimin elektronik të të dhënave,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimet e këtij Protokoll,

“Konventë” nënkupton Konventën për Kontratën e Transportit Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave (CMR);

“Komunikim elektronik” nënkupton informacionin e gjeneruar, të dërguar, të marrë ose të ruajtur me anë të mjeteve elektronike, optike, digjitale ose të ngjashme, me rezultatin që informacioni i komunikuar është i arritshëm, në mënyrë që të jetë i përdorshëm për referencë të mëvonshme;

“Faturë elektronike e ngarkesës” nënkupton një faturë ngarkese të lëshuar përmes komunikimit elektronik nga transportuesi, dërguesi ose çdo palë

tjetër e interesuar në realizimin e një kontrate transporti, për të cilën zbatohet Konventa, duke përfshirë të dhëna të lidhura logjiksht me komunikimin elektronik përmes bashkëlidhjeve, ose të lidhura ndryshe me komunikimin elektronik, në mënyrë të njëkohshme ose pas lëshimit të saj, duke u bërë pjesë e faturës elektronike të ngarkesës.

“Nënshkrim elektronik” nënkupton të dhëna në formë elektronike, të cilat janë të bashkëlidhura ose të shoqëruara logjiksht me të dhëna të tjera elektronike dhe të cilat shërbejnë si metodë autentifikimi.

Neni 2

Fusha e zbatimit dhe efekti i faturës elektronike të ngarkesës

1. Në bazë të dispozitave të këtij Protokoll, fatura e ngarkesës së përmendur në Konventë, si dhe çdo kërkim, deklaratë, udhëzim, kërkesë, rezervë ose komunikim tjetër, në lidhje me përmbushjen e një kontrate transporti për të cilën zbatohet Konventa, mund të bëhet me anë të komunikimit elektronik.

2. Një faturë elektronike e ngarkesës që pajtohet me dispozitat e këtij Protokoll, konsiderohet ekuivalente me faturën e ngarkesës së përmendur në Konventë dhe për këtë arsye duhet të ketë të njëjtën vlerë provuese dhe të prodhojë të njëjtat efekte si ajo faturë ngarkese.

Neni 3

Autentifikimi i faturës elektronike të ngarkesës

1. Fatura elektronike e ngarkesës duhet të vërtetohet nga palët në kontratën e transportit me anë të një nënshkrimi elektronik të besueshëm që siguron lidhjen e tij me faturën elektronike të transportit. Besueshmëria e një metode të nënshkrimit elektronik supozohet, përveç nëse provohet ndryshe, nëse nënshkrimi elektronik:

a) është i lidhur në mënyrë unike me nënshkruesin;

b) është i aftë të identifikojë nënshkruesin;

c) krijohet duke përdorur mjete që nënshkruesi mund t'i mbajë nën kontrollin e tij të vetëm; dhe

d) është i lidhur me të dhënat me të cilat lidhet në një mënyrë të tillë që çdo ndryshim i mëvonshëm i të dhënave është i dallueshëm.



2. Fatura elektronike e ngarkesës mund të autentifikohet edhe me çdo metodë tjetër të autentifikimit elektronik të lejuar nga ligji i vendit në të cilin është hartuar fatura elektronike e ngarkesës.

3. Detajet e përfshira në faturën elektronike të ngarkesës do të jenë të arritshme për çdo palë që ka të drejtë për to.

Neni 4

Kushtet për krijimin e faturës elektronike të ngarkesës

1. Fatura elektronike e ngarkesës duhet të përmbajë të njëjtat detaje si fatura e ngarkesës e përmendur në Konventë.

2. Procedura e përdorur për lëshimin e faturës elektronike të ngarkesës duhet të garantojë integritetin e të dhënave të përfshira në të, që nga koha kur është gjeneruar për herë të parë në formën e saj përfundimtare. Integriteti konsiderohet i plotë kur të dhënat kanë mbetur të plota dhe të pandryshuara, përveç ndonjë shtese ose ndryshimi që lind gjatë rrjedhës normale të komunikimit, ruajtjes dhe shfaqjes.

3. Detajet e përfshira në faturën elektronike të ngarkesës mund të plotësohen ose të ndryshohen në rastet e autorizuar nga Konventa.

Procedura e përdorur për plotësimin ose ndryshimin e faturës elektronike të ngarkesës, duhet të mundësojë zbulimin si të tillë të çdo shtese ose ndryshimi në faturën elektronike të ngarkesës dhe duhet të ruajë të dhënat që përmbahen fillimisht në të.

Neni 5

Zbatimi i faturës elektronike të ngarkesës

1. Palët e interesuara në zbatimin e kontratës së transportit duhet të bien dakord mbi procedurat dhe zbatimin e tyre, në mënyrë që të përmbushin kërkesat e këtij Protokollit dhe të Konventës, në veçanti në lidhje me:

a) metoda për lëshimin dhe dorëzimin e faturës elektronike të ngarkesës te pala e autorizuar;

b) një garanci që fatura elektronike e ngarkesës ruan integritetin e saj;

c) mënyra në të cilën pala e autorizuar për të drejtat që rrjedhin nga fatura elektronike e ngarkesës, është e aftë të provojë këtë të drejtë;

d) mënyra sesi jepet konfirmimi se dorëzimi të marrësi është kryer;

e) procedurat për plotësimin ose ndryshimin e faturës elektronike të ngarkesës; dhe

f) procedurat për zëvendësimin e mundshëm të faturës elektronike të ngarkesës me një faturë ngarkese të lëshuar me mjete të ndryshme.

2. Procedurat në paragrafin 1 duhet të përmenden në faturën elektronike të ngarkesës dhe duhet të jenë lehtësisht të dallueshme.

Neni 6

Dokumente që plotësojnë faturën elektronike të ngarkesës

1. Transportuesi duhet t'i dorëzojë dërguesit, me kërkesë të këtij të fundit, një faturë për mallrat dhe të gjitha informacionet e nevojshme për identifikimin e dërgesës dhe për akses në faturën elektronike të ngarkesës së cilës i referohet ky Protokoll.

2. Dokumentet e përmendura në nenin 6, paragrafi 2 (g), dhe nenin 11 të Konventës mund të ofrohen nga dërguesi te transportuesi në formën e një komunikimi elektronik, nëse dokumentet ekzistojnë në këtë formë dhe nëse palët kanë rënë dakord për procedurat që mundësojnë vendosjen e një lidhjeje midis këtyre dokumenteve dhe faturës elektronike të ngarkesës të cilës i referohet ky Protokoll në një mënyrë që garanton integritetin e tyre.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 7

Nënshkrimi, ratifikimi, aderimi

1. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim nga Shtetet që janë nënshkruese ose Palë të Konventës dhe janë ose anëtarë të Komisionit Ekonomik për Evropën, ose janë pranuar në Komision në një cilësi konsultative sipas paragrafit 8 të termave të referencës së Komisionit.

2. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim në Gjenevë nga data 27 deri më 30 maj 2008, përfshirë edhe këtë datë, dhe pas kësaj date, në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork deri më 30 qershor 2009, përfshirë edhe këtë datë.

3. Ky Protokoll do t'i nënshtrohet ratifikimit nga Shtetet nënshkruese dhe do të jetë i hapur për



aderim nga Shtetet jonëshkruese, të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, të cilat janë Palë në Konventë.

4. Shtetet që mund të marrin pjesë në aktivitete të caktuara të Komisionit Ekonomik për Evropën në përputhje me paragrafin 11 të termave të referencës së Komisionit dhe që kanë aderuar në Konventë, mund të bëhen Palë në këtë Protokoll, duke aderuar në të pas hyrjes së tij në fuqi.

5. Ratifikimi ose aderimi do të kryhet me depozitimin e një instrumenti te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

6. Çdo instrument ratifikimi ose aderimi, i depozituar pas hyrjes në fuqi të një amendamenti të këtij Protokoll, të miratuar në përputhje me dispozitat e nenit 13 më poshtë, do të konsiderohet se zbatohet për Protokollin e ndryshuar nga amendamenti.

Neni 8 Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pasi pesë nga Shtetet e përmendura në nenin 7, paragrafi 3 të këtij Protokoll, të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose të aderimit.

2. Për çdo shtet që e ratifikon ose aderon në të pasi pesë shtete të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose aderimit, ky Protokoll hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë, pasi shteti në fjalë të ketë depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 9 Denoncimi

1. Çdo Palë mund ta denoncojë këtë Protokoll, duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi hyn në fuqi 12 muaj pas datës së marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm të njoftimit të denoncimit.

3. Çdo shtet që pushon së qeni palë në Konventë, në të njëjtën datë pushon së qeni palë në këtë Protokoll.

Neni 10 Përfundimi

Nëse, pas hyrjes në fuqi të këtij Protokoll, numri i Palëve reduktohet, si rezultat i denoncimeve, në më

pak se pesë, ky Protokoll pushon së qeni në fuqi nga data në të cilën denoncimi i fundit prej këtyre denoncimeve hyn në fuqi. Ai, gjithashtu, pushon së qeni në fuqi nga data kur Konventa pushon së qeni në fuqi.

Neni 11 Mosmarrëveshja

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Palëve, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Protokoll, të cilën Palët nuk mund ta zgjidhin me negociata ose mjete të tjera, me kërkesë të cilësdo prej Palëve të interesuara, mund t'i referohet për zgjidhje Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Neni 12 Rezervat

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit në këtë Protokoll, mund të deklarojë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se nuk konsiderohet nën detyrimin ligjor nga neni 11 i këtij Protokoll. Palët e tjera nuk do të jenë të detyruara ligjërisht nga neni 11 i këtij Protokoll, në lidhje me asnjë Palë që ka bërë një rezervë të tillë.

2. Deklarata e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, mund të tërhiqet në çdo kohë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Asnjë rezervë tjetër ndaj këtij Protokoll nuk lejohet.

Neni 13 Amendamentet

1. Pasi ky Protokoll të hyjë në fuqi, ai mund të ndryshohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen.

2. Çdo ndryshim i propozuar i këtij Protokoll i paraqitur nga një Palë e këtij Protokoll, duhet t'i paraqitet Grupit të Punës për Transportin Rugor të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) për shqyrtim dhe vendim.

3. Palët në këtë Protokoll do të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për të arritur konsensus. Nëse, pavarësisht këtyre përpjekjeve, nuk arrihet konsensus mbi amendamentin e propozuar, si mjet i fundit, për miratim do të kërkohet një shumicë prej dy të tretash të Palëve të pranishme dhe votuese. Një amendament i propozuar, i miratuar qoftë me



konsensus ose nga një shumicë prej dy të tretash të Palëve, do t'i paraqitet Sekretarit të Përgjithshëm nga Sekretariati i Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën për t'u shpërndarë për pranim të të gjitha Palët në këtë Protokoll, si dhe të Shtetet nënshkruese.

4. Brenda një periudhe prej nëntë muajsh nga data kur amendamenti i propozuar komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm, çdo Palë mund ta informojë Sekretarin e Përgjithshëm se ka një kundërshtim ndaj amendamentit të propozuar.

5. Amendamenti i propozuar do të konsiderohet i pranuar nëse, deri në fund të periudhës nëntëmuajore të parashikuar në paragrafin pararendës, nuk është njoftuar asnjë kundërshtim nga një Palë e këtij Protokoll. Nëse deklarohet një kundërshtim, amendamenti i propozuar nuk do të ketë efekt.

6. Në rastin e një vendi që bëhet Palë Kontraktuese e këtij Protokoll midis momentit të njoftimit të një propozimi për ndryshim dhe përfundimit të periudhës nëntëmuajore, siç parashikohet në paragrafin 4 të këtij neni, Sekretariati i Grupit të Punës për Transportin Rrugor të Komisionit Ekonomik për Evropën duhet të njoftojë Shtetin e ri Palë për ndryshimin e propozuar sa më shpejt të jetë e mundur. Ky i fundit mund të informojë Sekretarin e Përgjithshëm para përfundimit të kësaj periudhe prej nëntë muajsh se ka një kundërshtim ndaj ndryshimit të propozuar.

7. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë, sa më shpejt të jetë e mundur, të gjitha Palët për kundërshtimet e ngritura në përputhje me paragrafët 4 dhe 6 të këtij neni, si dhe për çdo ndryshim të pranuar sipas paragrafit 5 më sipër.

8. Çdo ndryshim që konsiderohet i pranuar, hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së njoftimit të një pranimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm drejtuar Palëve.

Neni 14

Thirrja e një konference diplomatike

1. Pasi ky Protokoll të hyjë në fuqi, çdo Palë mund të kërkojë, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, që të thirret një konferencë, me qëllim shqyrtimin e këtij Protokoll. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët për kërkesën dhe një konferencë shqyrtimi do të thirret nga Sekretari i Përgjithshëm nëse, brenda një periudhe prej katër muajsh pas datës së njoftimit nga

Sekretari i Përgjithshëm, jo më pak se një e katërta e Palëve të këtij Protokoll e njoftojnë atë për pajtueshmërinë e tyre me kërkesën.

2. Nëse thirret një konferencë në përputhje me paragrafin pararendës, Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët dhe do t'i ftojë të paraqesin brenda një periudhe prej tre muajsh, propozime që ato dëshirojnë që Konferenca t'i shqyrtojë. Sekretari i Përgjithshëm do t'u qarkullojë të gjitha Palëve rendin e ditës paraprak të Konferencës, së bashku me tekstet e këtyre propozimeve të paktën tre muaj para datës në të cilën do të thirret Konferenca.

3. Sekretari i Përgjithshëm do të ftojë në çdo konferencë të thirrur në përputhje me këtë nen, të gjitha Shtetet e përmendura në nenin 7, paragrafët 1, 3 dhe 4 të këtij Protokoll.

Neni 15

Njoftimet për Shtetet

Përveç njoftimeve të parashikuara në nenet 13 dhe 14, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të njoftojë Shtetet e përmendura në nenin 7, paragrafi 1 më sipër, dhe Shtetet që janë bërë Palë në këtë Protokoll, në përputhje me paragrafët 3 dhe 4 të nenit 7, për:

- a) ratifikimet dhe aderimet sipas nenit 7;
- b) datat e hyrjes në fuqi të këtij Protokoll, në përputhje me nenin 8;
- c) denoncimet sipas nenit 9;
- d) përfundimi i këtij Protokoll, në përputhje me nenin 10;
- e) deklaratat dhe njoftimet e marra, në përputhje me nenin 12, paragrafët 1 dhe 2.

Neni 16

Depozitari

Origjinali i këtij Protokoll do të depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili do t'u dërgojë kopje të vërtetuara të tij të gjitha shteteve të përmendura në nenin 7, paragrafët 1, 3 dhe 4 të këtij Protokoll.

Bërë në Gjenevë, më njëzet shkurt, dy mijë e tetë, në një kopje të vetme në gjuhët angleze dhe frënge, ku secili tekst është njëloj autentik.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullave për këtë, kanë nënshkruar këtë Protokoll.



**ADDITIONAL PROTOCOL TO THE CONVENTION ON
THE CONTRACT FOR THE INTERNATIONAL CARRIAGE OF
GOODS BY ROAD (CMR) CONCERNING THE ELECTRONIC
CONSIGNMENT NOTE**

The Parties to this Protocol,

Being Parties to the Convention on the Contract for the International Carriage of Goods by Road (CMR), done at Geneva on 19 May 1956,

Desirous of supplementing the Convention in order to facilitate the optional making out of the consignment note by means of procedures used for the electronic recording and handling of data,

Have agreed as follows:

Article 1
Definitions

For the purposes of this Protocol,

“Convention” means the Convention on the Contract for the International Carriage of Goods by Road (CMR);

“Electronic communication” means information generated, sent, received or stored by electronic, optical, digital or similar means with the result that the information communicated is accessible so as to be usable for subsequent reference;

“Electronic consignment note” means a consignment note issued by electronic communication by the carrier, the sender or any other party interested in the performance of a contract of carriage to which the Convention applies, including particulars logically associated with the electronic communication by attachments or otherwise linked to the electronic communication contemporaneously with or subsequent to its issue, so as to become part of the electronic consignment note;

“Electronic signature” means data in electronic form which are attached to or logically associated with other electronic data and which serve as a method of authentication.



Article 2

Scope and effect of the electronic consignment note

1. Subject to the provisions of this Protocol, the consignment note referred to in the Convention, as well as any demand, declaration, instruction, request, reservation or other communication relating to the performance of a contract of carriage to which the Convention applies, may be made out by electronic communication.
2. An electronic consignment note that complies with the provisions of this Protocol shall be considered to be equivalent to the consignment note referred to in the Convention and shall therefore have the same evidentiary value and produce the same effects as that consignment note.

Article 3

Authentication of the electronic consignment note

1. The electronic consignment note shall be authenticated by the parties to the contract of carriage by means of a reliable electronic signature that ensures its link with the electronic consignment note. The reliability of an electronic signature method is presumed, unless otherwise proved, if the electronic signature:
 - (a) is uniquely linked to the signatory;
 - (b) is capable of identifying the signatory;
 - (c) is created using means that the signatory can maintain under his sole control; and
 - (d) is linked to the data to which it relates in such a manner that any subsequent change of the data is detectable.
2. The electronic consignment note may also be authenticated by any other electronic authentication method permitted by the law of the country in which the electronic consignment note has been made out.
3. The particulars contained in the electronic consignment note shall be accessible to any party entitled thereto.



Article 4

Conditions for the establishment of the electronic consignment note

1. The electronic consignment note shall contain the same particulars as the consignment note referred to in the Convention.
2. The procedure used to issue the electronic consignment note shall ensure the integrity of the particulars contained therein from the time when it was first generated in its final form. There is integrity when the particulars have remained complete and unaltered, apart from any addition or change which arises in the normal course of communication, storage and display.
3. The particulars contained in the electronic consignment note may be supplemented or amended in the cases authorized by the Convention.

The procedure used for supplementing or amending the electronic consignment note shall make it possible to detect as such any supplement or amendment to the electronic consignment note and shall preserve the particulars originally contained therein.

Article 5

Implementation of the electronic consignment note

1. The parties interested in the performance of the contract of carriage shall agree on the procedures and their implementation in order to comply with the requirements of this Protocol and the Convention, in particular as regards:
 - (a) The method for the issuance and the delivery of the electronic consignment note to the entitled party;
 - (b) An assurance that the electronic consignment note retains its integrity;
 - (c) The manner in which the party entitled to the rights arising out of the electronic consignment note is able to demonstrate that entitlement;
 - (d) The way in which confirmation is given that delivery to the consignee has been effected;
 - (e) The procedures for supplementing or amending the electronic consignment note; and



- (f) The procedures for the possible replacement of the electronic consignment note by a consignment note issued by different means.
2. The procedures in paragraph 1 must be referred to in the electronic consignment note and shall be readily ascertainable.

Article 6
Documents supplementing the electronic consignment note

1. The carrier shall hand over to the sender, at the latter's request, a receipt for the goods and all information necessary for identifying the shipment and for access to the electronic consignment note to which this Protocol refers.
2. The documents referred to in Article 6, paragraph 2 (g) and Article 11 of the Convention may be furnished by the sender to the carrier in the form of an electronic communication if the documents exist in this form and if the parties have agreed to procedures enabling a link to be established between these documents and the electronic consignment note to which this Protocol refers in a manner that assures their integrity.

FINAL PROVISIONS

Article 7
Signature, ratification, accession

1. This Protocol shall be open for signature by States which are signatories to or Parties to the Convention and are either members of the Economic Commission for Europe or have been admitted to the Commission in a consultative capacity under paragraph 8 of the Commission's terms of reference.
2. This Protocol shall be open for signature at Geneva from 27 to 30 May 2008 inclusive and after this date, at United Nations Headquarters in New York until 30 June 2009 inclusive.
3. This Protocol shall be subject to ratification by signatory States and open for accession by non-signatory States, referred to in paragraph 1 of this article, which are Parties to the Convention.
4. Such States as may participate in certain activities of the Economic Commission for Europe in accordance with paragraph 11 of the Commission's



terms of reference and which have acceded to the Convention may become Parties to this Protocol by acceding thereto after its entry into force.

5. Ratification or accession shall be effected by the deposit of an instrument with the Secretary-General of the United Nations.

6. Any instrument of ratification or accession, deposited after the entry into force of an amendment to this Protocol adopted in accordance with the provisions of Article 13 hereafter, shall be deemed to apply to the Protocol as modified by the amendment.

Article 8 Entry into force

1. This Protocol shall enter into force on the ninetieth day after five of the States referred to in article 7, paragraph 3, of this Protocol, have deposited their instruments of ratification or accession.

2. For any State ratifying or acceding to it after five States have deposited their instruments of ratification or accession, this Protocol shall enter into force on the ninetieth day after the said State has deposited its instrument of ratification or accession.

Article 9 Denunciation

1. Any Party may denounce this Protocol by so notifying the Secretary-General of the United Nations.

2. Denunciation shall take effect 12 months after the date of receipt by the Secretary-General of the notification of denunciation.

3. Any State which ceases to be Party to the Convention shall on the same date cease to be Party to this Protocol.

Article 10 Termination

If, after the entry into force of this Protocol, the number of Parties is reduced, as a result of denunciations, to less than five, this Protocol shall cease to be in force from the date on which the last of such denunciations takes



effect. It shall also cease to be in force from the date on which the Convention ceases to be in force.

Article 11 Dispute

Any dispute between two or more Parties relating to the interpretation or application of this Protocol which the Parties are unable to settle by negotiation or other means may, at the request of any one of the Parties concerned, be referred for settlement to the International Court of Justice.

Article 12 Reservations

1. Any State may, at the time of signing, ratifying, or acceding to this Protocol, declare by a notification addressed to the Secretary-General of the United Nations that it does not consider itself bound by article 11 of this Protocol. Other Parties shall not be bound by article 11 of this Protocol in respect of any Party which has entered such a reservation.

2. The declaration referred to in paragraph 1 of this article may be withdrawn at any time by a notification addressed to the Secretary-General of the United Nations.

3. No other reservation to this Protocol shall be permitted.

Article 13 Amendments

1. Once this Protocol is in force, it may be amended according to the procedure defined in this article.

2. Any proposed amendment to this Protocol presented by a Party to this Protocol shall be submitted to the Working Party on Road Transport of the United Nations Economic Commission for Europe (UNECE) for consideration and decision.

3. The Parties to this Protocol shall make all possible efforts to achieve consensus. If, despite these efforts, consensus is not reached on the proposed amendment, it shall require, as a last resort, for adoption a two-thirds majority of Parties present and voting. A proposed amendment adopted either by



consensus or by a two-thirds majority of Parties shall be submitted by the secretariat of the United Nations Economic Commission for Europe to the Secretary-General to be circulated for acceptance to all Parties to this Protocol, as well as to signatory States.

4. Within a period of nine months from the date on which the proposed amendment is communicated by the Secretary-General, any Party may inform the Secretary-General that it has an objection to the amendment proposed.

5. The proposed amendment shall be deemed to have been accepted if, by the end of the period of nine months foreseen in the preceding paragraph, no objection has been notified by a Party to this Protocol. If an objection is stated, the proposed amendment shall be of no effect.

6. In the case of a country which becomes a Contracting Party to this Protocol between the moment of notification of a proposal for amendment and the end of the nine-month period foreseen in paragraph 4 of this article, the secretariat of the Working Party on Road Transport of the Economic Commission for Europe shall notify the new State Party about the proposed amendment as soon as possible. The latter may inform the Secretary-General before the end of this period of nine months that it has an objection to the proposed amendment.

7. The Secretary-General shall notify, as soon as possible, all the Parties of objections raised in accordance with paragraphs 4 and 6 of this Article as well as of any amendment accepted according to paragraph 5 above.

8. Any amendment deemed to have been accepted shall enter into force six months after the date of notification of such acceptance by the Secretary-General to Parties.

Article 14

Convening of a diplomatic conference

1. Once this Protocol is in force, any Party may, by notification to the Secretary-General of the United Nations, request that a conference be convened for the purpose of reviewing this Protocol. The Secretary-General shall notify all Parties of the request and a review conference shall be convened by the Secretary-General if, within a period of four months following the date of notification by the Secretary-General, not less than one fourth of the Parties to this Protocol notify him of their concurrence with the request.



2. If a conference is convened in accordance with the preceding paragraph, the Secretary-General shall notify all the Parties and invite them to submit within a period of three months such proposals as they may wish the Conference to consider. The Secretary-General shall circulate to all Parties the provisional agenda for the Conference together with the texts of such proposals at least three months before the date on which the Conference is to meet.

3. The Secretary-General shall invite to any conference convened in accordance with this article all States referred to in Article 7, paragraphs 1, 3 and 4, of this Protocol.

Article 15 Notifications to States

In addition to the notifications provided for in Articles 13 and 14, the Secretary-General of the United Nations shall notify the States referred to in Article 7, paragraph 1, above, and the States which have become Parties to this Protocol in accordance with paragraphs 3 and 4 of Article 7, of:

- (a) Ratifications and accessions under Article 7;
- (b) The dates of entry into force of this Protocol in accordance with Article 8;
- (c) Denunciations under Article 9;
- (d) The termination of this Protocol in accordance with Article 10;
- (e) Declarations and notifications received in accordance with Article 12, paragraphs 1 and 2.

Article 16 Depositary

The original of this Protocol shall be deposited with the Secretary-General of the United Nations, who shall send certified true copies thereof to all the States referred to in Article 7, paragraphs 1, 3 and 4, of this Protocol.

DONE at Geneva, this twentieth day of February two thousand and eight, in a single copy in the English and French languages, each text being equally authentic.

**DEKRET**
Nr. 393, datë 17.11.2025**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 59/2025, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin shtesë të Konventës për Kontratën e Transportit Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave (CMR), në lidhje me faturën elektronike të ngarkesës, bërë në Gjenevë në datën 20.2.2008”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM
Nr. 94/2025**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË
KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE
DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE PËR
MOSNGRITJEN E KOMISIONIT
HETIMOR PARLAMENTAR PËR
SHKARKIMIN E PRESIDENTIT TË
REPUBLIKËS, ZOTIT BAJRAM BEGAJ**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 112, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Miratimin e raportit të datës 31.10.2025 të Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike për mosngritjen e komisionit hetimor parlamentar për shkarkimin e Presidentit të Republikës, zotit Bajram Begaj.

II. Rrëzimin e kërkesës.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 6.11.2025.

URDHËR
Nr. 171, datë 11.11.2025**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
MBI PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE
TEKNIKE DHE PROCEDURAVE
ADMINISTRATIVE, NË LIDHJE ME
LICENCAT DHE CERTIFIKATAT E
KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT
AJROR¹**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës “ç”, të nenit 7, nenit 28 dhe pikës 2, të nenit 91, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës

¹ Ky urdhër përfaqëson plotësisht Rregulloren e Komisionit Evropian 2015/340, të datës 20 shkurt 2015, që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror, në pajtim me rregulloren (KE) nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon rregulloren (BE) nr. 805/2011, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 63, datë 6.3.2015, si dhe Rregulloren e Komisionit (BE) 2023/893, të datës 21 prill 2023, për ndryshimin e

Rregullores (BE) 2015/340, që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 118, datë 4.5.2023, dhe rregulloren e Komisionit (BE) 2023/203, të datës 27 tetor 2022, që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rrezeve të sigurisë së informacionit, me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 31, datë 2.2.2023.



së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”, dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Mbi përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative, në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Urdhri i ministrit nr. 91, datë 21.2.2019, “Për përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative, në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Autoritetit i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE

MBI PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE
TEKNIKE DHE PROCEDURAVE
ADMINISTRATIVE, NË LIDHJE ME
LICENCAT DHE CERTIFIKATAT E
KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT AJROR

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Kjo Rregullore përcakton rregullat e detajuara, për:

a) rregullat dhe procedurat për lëshimin, mbajtjen, ndryshimin, kufizimin, pezullimin ose revokimin e licencave të kontrollorëve të trafikut ajror dhe të student-kontrollorëve të trafikut ajror, kategorive dhe miratimeve përkatëse, duke përfshirë rregullat dhe procedurat për konvertimin e licencave kombëtare të kontrollorëve të trafikut ajror të marra gjatë shërbimit ushtarak në licenca të kontrollorëve

të trafikut ajror të Republikës së Shqipërisë, si dhe privilegjet dhe përgjegjësitë e atyre që i mbajnë ato;

b) kushtet për lëshimin, kufizimin, pezullimin dhe revokimin e certifikatave mjekësore të kontrollorëve të trafikut ajror dhe të student-kontrollorëve të trafikut ajror, privilegjet, si dhe përgjegjësitë e atyre që i mbajnë ato;

c) certifikimin e ekzaminuesve aeromjekësorë dhe qendrave aeromjekësore për kontrollorët e trafikut ajror dhe student-kontrollorët e trafikut ajror;

d) certifikimin e organizatave trajnuese të kontrollorëve të trafikut ajror;

e) kushtet për vlefshmërinë, rivlefshmërinë, rinovimin dhe përdorimin e këtyre licencave dhe certifikatave.

2. Kjo Rregullore do të zbatohet, për:

a) student-kontrollorët e trafikut ajror dhe kontrollorët e trafikut ajror që ushtrojnë funksionet e tyre brenda fushëveprimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar;

b) personat dhe organizatat e përfshira në licencimin, trajnimin, testimin, kontrollin, ekzaminimin dhe vlerësimin mjekësor të aplikantëve në përputhje me këtë Rregullore.

Neni 2

Përputhshmëria me kërkesat dhe procedurat

1. Student-kontrollorët e trafikut ajror, kontrollorët e trafikut ajror dhe personat e përfshirë në licencimin, trajnimin, testimin, kontrollin, ekzaminimin dhe vlerësimin mjekësor të aplikantëve të referuar në nenin 1(2)(a) dhe (b) kualifikohen dhe licencohen, në përputhje me dispozitat e anekseve I, III dhe IV nga Autoriteti i Aviacionit Civil, siç përcaktohet në nenin 6.

2. Organizatat e referuara në nenin 1(2)(b) kualifikohen në përputhje me kërkesat teknike dhe procedurat administrative të përcaktuara në anekset I, III dhe IV do të certifikohen nga Autoriteti Kompetent i referuar në nenin 6.

3. Certifikimi mjekësor i personave të referuar në nenin 1(2)(a) dhe (b) do të jetë në pajtim me kërkesat teknike dhe procedurat administrative të përcaktuara në anekset III dhe IV.

4. Kontrollorët e trafikut ajror të punësuar nga



ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror që ofrojnë shërbimet e trafikut ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, por që kanë vendin kryesor të operimit dhe zyrën e tyre të regjistrimit (nëse kanë), të ndodhur jashtë territorit ku aplikohet kjo rregullore (ose e barasvlershmja e saj në BE), do të konsiderohet se janë licencuar, në përputhje me paragrafin 1, kur ata plotësojnë dy kushtet e mëposhtme:

a) ata mbajnë një licencë të kontrollorëve të trafikut ajror të lëshuar nga një vend tjetër, jashtë ZPEA-së, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos;

b) ata i kanë vërtetuar Autoritetit të Aviacionit Civil, në përputhje me nenin 6, që ata kanë marrë trajnimin dhe kanë kaluar me sukses ekzaminimet dhe vlerësimet ekuivalente me ato të kërkuara nga pjesa ATCO, nën pjesa D, seksionet 1-4, të përcaktuara në aneksin 1 të kësaj Rregulloreje.

Detyrat dhe funksionet e caktuara për kontrollorët e trafikut ajror të referuar në nënparagrafin e parë nuk do të tejkalojnë privilegjet e licencës të lëshuar nga vendi tjetër, jashtë ZPEA-së, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe.

Kontrollorët e trafikut ajror të punësuar nga ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror, që ofrojnë shërbimet e trafikut ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, por që kanë vendin kryesor të operimit dhe zyrën e tyre të regjistrimit (nëse kanë), në një vend të Bashkimit Evropian, do të konsiderohet se janë licencuar në përputhje me paragrafin 1, kur ata mbajnë një licencë të kontrollorëve të trafikut ajror të lëshuar nga një vend i Bashkimit Evropian.

Detyrat dhe funksionet e caktuara për kontrollorët e trafikut ajror të referuar në nënparagrafin e parë nuk do të tejkalojnë privilegjet e licencës të lëshuar nga vendi i BE-së.

5. Instruktorët dhe vlerësuesit, të punësuar nga një organizatë trajnuese e ndodhur jashtë territorit të aplikimit të kësaj Rregulloreje, pra Republika e Shqipërisë apo një shteti të ZPEA-së në referencë të Marrëveshjes Shumëpalëshe, do të mendohen se janë kualifikuar në përputhje me paragrafin 1, kur ata përmbushin dy kushtet e mëposhtme:

a) ata mbajnë një licencë të kontrollorëve të trafikut ajror të lëshuar nga një vend tjetër, jashtë ZPEA-së, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes

Shumëpalëshe në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos me një kategori dhe nëse aplikohet, miratimi i kategorisë që i korrespondon atij për të cilin ata janë autorizuar për të instruktuar ose vlerësuar;

b) ata i kanë treguar Autoritetit të Aviacionit Civil si Autoritet Kompetent, në përputhje me nenin 6, se ata kanë marrë trajnimin dhe kanë kaluar me sukses ekzaminimet dhe vlerësimet ekuivalente me ato të kërkuara nga pjesa ATCO, nën pjesa D, seksioni 5, të përcaktuara në aneksin 1.

Privilegjet e referuara në nënparagrafin e parë do të specifikohen në një certifikatë të lëshuar nga një vend tjetër, jashtë ZPEA-së, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe dhe do të kufizohen për të ofruar instruksion dhe vlerësim për organizatat trajnuese, që ndodhen jashtë territorit të aplikimit të kësaj Rregulloreje.

6. Certifikatat e lëshuara në një vend të BE-së, ku zbatohet Rregullorja (BE) 2015/340 do të konsiderohen si të lëshuara sipas kërkesave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Ofrimi i shërbimeve të kontrollit të trafikut ajror

1. Shërbimet e kontrollit të trafikut ajror do të ofrohen vetëm nga kontrollorët e trafikut ajror të kualifikuar dhe të licencuar në përputhje me këtë Rregullore.

2. Kjo Rregullore mund të zbatohet për personelin ushtarak që ofron shërbime për publikun.

Neni 4

Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “Ekzaminimi” nënkupton një test të formatizuar që vlerëson njohuritë dhe të kuptuarit e personit;

2. “Indikatori i ICAO-s për vendndodhjen” nënkupton grupin e kodit me katër shkronja, të formuluar në përputhje me rregullat e parashikuara nga ICAO në manualin “DOC 7910”, në versionin e fundit të përditësuar dhe të caktuar për vendndodhjen e një stacioni aeronautik të fiksuar;



3. “Trajnim në vendin e punës” nënkupton fazën e trajnimit të njësisë gjatë së cilës rutinat dhe aftësitë e fituara më parë, në lidhje me punën integrohen në praktikë nën mbikëqyrjen e një instruktori të kualifikuar të trajnimit në vendin e punës në një situatë trafikut të drejtpërdrejtë;

4. “Licencë” nënkupton një dokument të lëshuar dhe miratuar në përputhje me këtë Rregullore dhe që i jep të drejtën mbajtësit të ligjshëm të saj për të ushtruar privilegjet e kategorive dhe miratimeve që përmbahen aty;

4.a) “Miratim në licencë” nënkupton autorizimin e shënuar në licencë dhe që është pjesë e licencës, duke treguar një kualifikim specifik të mbajtësit të licencës. Është një term i përgjithshëm që përdoret për të përshkruar përfshirjen e miratimeve të instruktorit të trajnimit në vendin e punës, instruktorit të pajisjeve të trajnimit sintetik, vlerësuesit dhe miratimeve të aftësisë gjuhësore;

5. “Kursi i trajnimit” nënkupton instruksionin teorik dhe/ose praktik të zhvilluar brenda një kuadri të strukturuar dhe të ofruar brenda një kohëzgjatje të përcaktuar;

6. “Material udhëzues (GM)” nënkupton materialin jo të detyrueshëm të zhvilluar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, që ndihmon për të ilustruar kuptimin e kriterëve ose specifikimeve që përdoren për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe për të mbështetur interpretimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; Autoriteti i Aviacionit Civil mund të pranojë dhe të publikojë materialet udhëzuese të zhvilluara nga Agjencia për të ilustruar kuptimin e kriterëve ose specifikimeve që përdoren për zbatimin e Rregullores (BE) 2015/340 dhe për të mbështetur interpretimin e Rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil, dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese.

7. “Ministri” nënkupton ministrin përgjegjës për transportin;

8. “Miratimi i aftësisë gjuhësore” nënkupton deklaratën (vërtetimin) bashkëlidhur e që formon pjesë të një licence, duke treguar aftësinë gjuhësore të mbajtësit;

9. “Miratimi i vlerësuesit” nënkupton autorizimin e dhënë dhe që bën pjesë në licencë, duke treguar kompetencën e mbajtësit për të vlerësuar aftësitë

praktike të student-kontrollorëve të trafikut ajror dhe kontrollorëve të trafikut ajror;

10. “Miratimi i njësisë” nënkupton autorizimin e dhënë dhe që përbën pjesë të një licence, që tregon indikatorin e vendndodhjes së ICAO-s dhe sektorin, grupin e sektorëve ose pozicionet e punës ku mbajtësi i licencës është kompetent për të punuar;

11. “Miratimi i instruktorit për trajnimin me pajisje sintetike (STDI/IPTS)” nënkupton autorizimin e dhënë dhe që përbën pjesë të një licence, që tregon kompetencën e mbajtësit për të dhënë instruksion mbi pajisjet sintetike të trajnimit;

12. “Miratimi i instruktorit të trajnimit në vendin e punës (OJTI/ITVP)” nënkupton autorizimin e dhënë dhe që formon pjesë të një licence, që tregon kompetencën e mbajtësit për të dhënë instruksionin e trajnimit në vendin e punës dhe instruksionin mbi trajnimet me pajisje sintetike (STD/IPTS);

13. “Miratimi i kategorisë” nënkupton autorizimin e dhënë dhe që bëhet pjesë e një licence, që tregon kushtet specifike, privilegjet ose kufizimet që kanë të bëjnë me kategorinë përkatëse;

13.a) “Kategori” do të thotë autorizimi i futur në ose i shoqëruar me një licencë dhe që përbën pjesë të saj, duke deklaruar kushte, privilegje ose kufizime të veçanta që lidhen me një licencë të tillë;

14. “Mjetet të pranueshme të përputhshmërisë (AMC)” nënkupton standardet jo të detyrueshme të miratuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil për të ilustruar mjetet me të cilat vendoset përputhshmëria me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Autoriteti i Aviacionit Civil mund të pranojë dhe publikojë Mjetet e Pranueshme të Përputhshmërisë të zhvilluara nga Agjencia për të ilustruar mjetet me të cilat vendoset përputhshmëria me Rregulloren (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil, dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese.

15. “Mjetet alternative të përputhshmërisë” nënkupton një alternativë për një AMC ekzistuese ose një mjet i ri për të krijuar përputhshmërinë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij për të cilat AMC nuk është miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

16. “Njësia e kontrollit të trafikut ajror (ATC)”



nënkupton një term të përgjithshëm që nënkupton sipas rastit, qendrën e kontrollit të hapësirës ACC), njësinë e kontrollit të afrimit (APP) ose kullën e kontrollit të aerodromit (TWR);

17. “Objektivi i performancës” nënkupton një demonstrim të qartë dhe të pakundërshtueshëm të performancës që pritët nga personi që kryen trajnimin, kushtet në të cilat kryhet performanca dhe standardet që duhet të përmbushë personi që kryen trajnimin.

18. “Organizata trajnuese” nënkupton një organizatë që është certifikuar nga autoriteti kompetent për të ofruar një ose më shumë lloje trajnimi;

19. “Paaftësia e përkohshme” nënkupton një gjendje të përkohshme në të cilën mbajtësi i licencës ndalohej nga ushtrimi i privilegjeve të licencës kur kategoritë, miratimet dhe certifikata e tij ose e saj mjekësore janë të vlefshme;

20. “Pajisje trajnimi sintetike” nënkupton çdo lloj pajisje me të cilën imitohen kushtet operacionale, duke përfshirë simulatorët dhe trajnuesit me detyrë të pjesshme;

21. “Rinovimi” nënkupton aktin administrativ të marrë, pasi një kategori, miratim ose certifikatë ka skaduar, dhe i cili rinovon privilegjet e kategorisë, miratimit ose certifikatës për një periudhë specifike që i nënshtrohet përmbushjes së kërkesave specifike;

22. “Rivlefshmëria” nënkupton aktin administrativ të marrë brenda periudhës së vlefshmërisë të një kategorie, miratimi ose certifikatë që lejon mbajtësin të vazhdojë të ushtrojë privilegjet e një kategorie, miratimi ose certifikatë për një periudhë specifike të mëtejshme që i nënshtrohet përmbushjes së kërkesave specifike;

23. “Sektori” nënkupton një pjesë e një zone kontrolli dhe/ose një pjesë e një rajoni informacioni fluturimi ose rajoni të sipërm.

24. “Simulator” nënkupton një pajisje trajnimi sintetike që paraqet tiparet e rëndësishme të mjedisit real operacional dhe riprodhon kushtet operacionale nën të cilat personi që ndërmerr trajnimin mund të praktikojë detyrat në kohë reale në mënyrë direkte;

25. “Situatë emergjence” nënkupton një situatë serioze dhe të rrezikshme që kërkon veprime të menjëhershme;

26. “Situatë anormale” nënkupton rrethanat, duke përfshirë situatat e degraduara, të cilat nuk përjetojnë as në mënyrë rutinore, as zakonisht dhe

për të cilat një kontrollor i trafikut ajror nuk ka zhvilluar aftësi automatike;

27. “Stres i incidentit kritik” nënkupton manifestimin e reagimeve të pazakonshme dhe/ose ekstreme emocionale, fizike dhe/ose të sjelljes në një individ pas një ngjarjeje të papritur, një aksidenti, një incidenti ose incidenti serioz;

28. “Substanca psikoaktive” nënkupton alkoolin, opioidet, kanabinoidet, sedativët dhe hipnotikët, kokainën, psikostimulantë të tjerë, halucinogjenët dhe tretësit e avullueshëm, ndërsa kafeina dhe duhani përjashtohen;

29. “Shërbimi i kontrollit të trafikut ajror (ATC)” nënkupton një shërbim të ofruar për qëllimin e:

a) parandalimit të përplasjeve:

- ndërmjet avionëve; dhe

- ndërmjet avionëve dhe pengesave në zonën e manovrimit; dhe

b) përsheptimit dhe të ruajtjes së një rrjedhe të rregullt të trafikut ajror;

30. “Trajnues me detyrë të pjesshme (PTT/TDP)” nënkupton një pajisje trajnuese sintetike për të ofruar trajnim për detyra operacionale specifike dhe të përzgjedhura pa i kërkuar praktikantit që të praktikojë të gjitha detyrat që lidhen normalisht me një mjedis plotësisht operacional;

31. “Vlefshmëri” nënkupton një proces me anë të të cilit, nëpërmjet përfundimit të suksesshëm të një kursi për miratimin e njësisë të lidhur me një kategori ose miratim kategorie, mbajtësi mund të fillojë ushtrimin e privilegjeve të asaj kategorie ose miratim kategorie;

32. “Vlerësimi” nënkupton një vlerësim të aftësive praktike që çojnë në lëshimin e licencës, shkallës së kategorisë dhe/ose miratimit/ve dhe rivlefshmërisë dhe/ose rinovimit të tyre, duke përfshirë sjelljen dhe aplikimin praktik të njohurive dhe të kuptuarit, që tregohet nga personi që vlerësohet.

33. “Kreditim” nënkupton njohjen e trajnimit të kryer nga një kontrollor i trafikut ajror gjatë shërbimit të tij ushtarak, me qëllim të aplikimit për një licencë të student-kontrollorëve të trafikut që do të lëshohet në përputhje me këtë Rregullore;

34. “Raporti kombëtar i konvertimit” nënkupton një raport, mbi bazën e të cilit, trajnimit paraparak të kontrollorëve të trafikut ajror mund t’i jepet kreditim nga autoriteti kompetent të cilit i është dorëzuar aplikimi për lëshimin e licencës të student-kontrollorëve të trafikut ajror.



Neni 5

Autoriteti kompetent

1. Në zbatim të kësaj Rregulloreje, autoriteti kompetent do të jetë autoriteti i Aviacionit Civil, si Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës, siç është përcaktuar në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë.

2. Brenda një blloku funksional të hapësirës ajrore (nëse aplikohet) ose në rastin e ofrimit të shërbimit ndërkufitar, autoritetet kompetente do të caktohen me marrëveshje të vendeve të interesuara, duke respektuar parashikimet ligjore në fuqi për marrëdhëniet ndërkombëtare.

3. Nëse shteti cakton ose krijon një ose më shumë autoritete kompetente, fushat e kompetencës të secilit autoritet do të përcaktohen qartësisht në aspektin e përgjegjësisë dhe zonës gjeografike, sipas rastit. Koordinimi do të vendoset ndërmjet atyre autoriteteve për të siguruar mbikëqyrjen efektive të gjithë personave dhe organizatave që i nënshtrohen kësaj Rregulloreje brenda kompetencave të tyre përkatëse.

4. Autoritetet kompetente janë të pavarura nga ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror dhe organizatat trajnuese. Kjo pavarësi do të arrihet përmes ndarjes së përshtatshme, së paku në nivel funksional të autoriteteve kompetente nga njëra anë dhe ofruesve të shërbimit të lundrimit ajror dhe organizatave trajnuese nga ana tjetër. Autoritetet kompetente do të ushtrojnë fuqitë e tyre paanësisht dhe në mënyrë transparente.

5. Autoriteti kompetent merr masa që të sigurojë aftësitë e nevojshme për të kryer aktivitetet e certifikimit dhe mbikëqyrjes të mbuluara nga programet e certifikimit dhe mbikëqyrjes, duke përfshirë burimet e mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e aneksit II (pjesa ATCO.AR). Në veçanti, do të përdorin vlerësimet e prodhuara nga autoriteti kompetent, në përputhje me pikën ATCO.AR.A.005 (a) të aneksit II, me qëllim për të treguar aftësinë e tyre.

6. Personeli i Autoritetit të Aviacionit Civil apo çdo autoritet kompetent, që kryen aktivitetet të mbikëqyrjes dhe certifikimit sipas kësaj Rregulloreje, nuk duhet të ketë konflikt interesi direkt ose indirekt, në veçanti në lidhje me interesat familjarë ose financiare të personelit në fjalë.

Neni 6

Autoriteti kompetent për qëllime të anekseve I, III dhe IV

1. Për qëllim të aneksit I, autoriteti kompetent do të jetë Autoriteti i Aviacionit Civil.

2. Për qëllim të aneksit III dhe për mbikëqyrjen e kërkesave të aneksit I, në lidhje me ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror, autoriteti kompetent do të jetë:

a) Autoriteti i Aviacionit Civil, kur vendi kryesor i operimit ose regjistrimit është Republika e Shqipërisë;

b) Autoriteti i Aviacionit Civil, nëse aplikanti ka vendin e tij kryesor të funksionimit ose zyrën e tij të regjistrimit (nëse ka), jashtë territorit të Bashkimit Evropian. Kur Republika e Shqipërisë të jetë Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian, do të jetë EASA.

b.1) Për aplikantët që kanë certifikime nga një vend i Bashkimit Evropian ose EASA, për qëllim të aneksit III, do të pranohet këto certifikime.

3. Për qëllim të aneksit IV, autoriteti kompetent do të jetë:

a) Për qendrat aeromjekësore:

i. Autoriteti i Aviacionit Civil, kur Shqipëria është shteti në të cilin qendra aeromjekësore ka vendin e saj kryesor të biznesit;

ii. Autoriteti i Aviacionit Civil, nëse aplikanti ka vendin e tij kryesor të funksionimit ose zyrën e tij të regjistrimit (nëse ka), jashtë territorit të Bashkimit Evropian;

iii. Për aplikantët që kanë certifikime nga një vend i BE ose EASA, për qëllim të aneksit III, do të pranohet këto certifikime.

b) Për ekzaminuesit aeromjekësor:

i. Autoriteti i Aviacionit Civil, kur Shqipëria është shteti në të cilin ekzaminuesi aeromjekësor ka vendin e tij kryesor të praktikës;

ii. Autoriteti i Aviacionit Civil, nëse aplikanti ka vendin e tij kryesor të funksionimit ose zyrën e tij të regjistrimit (nëse ka), jashtë territorit të Bashkimit Evropian;

iii. Për aplikantët që kanë certifikime nga një vend i BE ose EASA, për qëllim të aneksit III, do të pranohen këto certifikime.

Neni 7

Dispozita kalimtare

1. AAC-ja, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje do të bëjë zëvendësimin e licencave të



lëshuara sipas formatit të parashikuar në këtë Rregullore.

2. Mbajtësit e kategorisë të Kontrollit Vizual të Aerodromit (ADV), të cilët nuk zotërojnë një kategori të Kontrollit me Instrument të Aerodromit (ADI), do të vazhdojnë të jenë të autorizuar të ofrojnë shërbim të kontrollit të trafikut ajror për trafikun e aerodromit në një aerodrom që nuk ka procedura të publikuara me instrumente afrimi ose nisjeje, me kusht që të ruhet vlefshmëria e miratimit të njësisë në lidhje me klasifikimin ADV.

3. Pikat ATCO.AR.A.020 (c), ATCO.AR.A.025A, ATCO.AR.B.001 (e), ATCO.AR.B.005 (c) ATCO.AR.C.001 (f), ATCO.AR.E.010A, ATCO.OR.C.001A në këtë Rregullore do të zbatohen nga data 22 shkurt 2026.

Neni 8

Ndryshimet në kategoritë dhe miratimet e kategorive

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të ndryshojë emrin e kategorisë së Kontrollit me Instrument të Aerodromit (ADI), të lëshuar para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje në kategorinë Kontrolli i Aerodromit (ADC), jo më vonë se data 4 gusht 2027, në mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil nuk do të lëshojë licenca, duke përfshirë kategorinë Kontrolli Vizual i Aerodromit (ADV), pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, përveç atyre kontrollorëve të trafikut ajror të përmendur në paragrafin 2 të nenit 7.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil nuk do të lëshojë licenca duke përfshirë miratimet e kategorisë të Kontrollit Ajror (AIR), Kontrollit të Lëvizjes Tokësore (GMC), Kontrollit të Kullës (TWR), Mbikëqyrjes së Lëvizjes Tokësore (GMS), Kontrollit të Aerodromit me Radar (RAD) dhe Kontrollit të Terminalit (TCL), pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

4. Privilegjet e miratimeve të kategorisë së Kontrollit Ajror (AIR), Kontrollit të Lëvizjes Tokësore (GMC) dhe Kontrollit të Kullës (TWR) të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje do të bëhen pjesë e privilegjeve të kategorisë të Kontrollit të Aerodromit (ADC). Nëse ushtrimi i privilegjeve të mbajtësit kufizohet vetëm në kontrollin ajror ose në tokë, kjo do të tregohet në miratimin e njësisë, në përputhje me pikën

ATCO.B.020(d) të aneksit I, në momentin e ndryshimit të emrit të kategorisë të Kontrollit me Instrumente të Aerodromit (ADI) në Kontrollin e Aerodromit (ADC) në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

5. Privilegjet e miratimit të vlerësimit të Mbikëqyrjes së Lëvizjes Tokësore (GMS), të lëshuar përpara hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje do të bëhen pjesë e privilegjeve të miratimit të njësisë që lidhen me kategorinë e Kontrollit të Aerodromit.

6. Autoriteti i Aviacionit Civil do të ndryshojë emrin e miratimit të kategorisë të Kontrollit të Aerodromit me Radar (RAD) të lëshuar përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje në miratimin e vlerësimit të Mbikëqyrjes së Kontrollit të Aerodromit (SUR), në kohën e ndryshimit të emrit të kategorisë të Kontrollit me Instrumente të Aerodromit (ADI) në Kontrollin e Aerodromit (ADC), në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

7. Privilegjet e miratimit të kategorisë së Kontrollit të Terminalit (TCL), të lëshuara përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, do të bëhen pjesë e privilegjeve të miratimit të njësisë që lidhet me miratimin e kategorisë së Mbikëqyrjes së Kontrollit të Afrimit (APS), ose kategorisë së Mbikëqyrjes së Kontrollit të Zonës (ACS).

Neni 8a

Konvertimi i licencave kombëtare të kontrollit të trafikut ajror ushtarak në licenca të student-kontrollorëve të trafikut ajror

1. Një mbajtës i një licence kombëtare të kontrollorëve të trafikut ajror ushtarak të lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes mund të aplikojë për konvertimin e kësaj licence në një licencë të student-kontrollorëve të trafikut ajror të përmendur në pikën ATCO.B.001. Kërkesa për konvertimin e licencës i paraqitet Autoriteti i Aviacionit Civil, kur aplikanti ka shërbyer në forcat e armatosura.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil që ka marrë aplikimin e përmendur në paragrafin 1 do t'i japë kreditum aplikantit, me qëllim të demonstrimit të përputhshmërisë me kërkesat përkatëse të aneksit I (pjesa ATCO), në përputhje me raportin kombëtar të konvertimit të krijuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

3. Kur është e zbatueshme, raporti kombëtar i konvertimit i njoftohet Agjencisë nga Autoriteti i Aviacionit Civil, dhe:

a) përshkruan kërkesat kombëtare në bazë të të



cilave lëshohen licencat e kontrollorëve ushtarakë të trafikut ajror në Shqipëri;

b) përshkruan shtrirjen e privilegjeve të licencave të kontrollorëve ushtarakë të trafikut ajror të përmendur në shkronjën (a);

c) tregon për cilat kërkesa të aneksit I (pjesa ATCO) do të jepet kreditimi;

d) tregon trajnimin shtesë, duke përfshirë provimet dhe vlerësimet e kërkuara, që do të ndërmerren nga aplikantët; provimet dhe vlerësimet e kërkuara do të kryhen nga një organizatë trajnuese që plotëson kërkesat e përcaktuara në aneksin III (pjesa ATCO.OR) dhe që është e certifikuar për të ofruar trajnim fillestar për qëllimin e lëshimit të licencave të studentëve të kontrollit të trafikut ajror në përputhje me këtë Rregullore;

e) përfshin një deklaratë që konfirmon se përputhshmëria e aplikantit me kërkesat e trajnimit, ekzaminimit dhe vlerësimit të përshkruara në raportin kombëtar të konvertimit mund të konsiderohet si ekuivalente me përfundimin me sukses të trajnimit fillestar të kërkuar sipas kësaj Rregulloreje, për qëllimin e lëshimit të një licence të student-kontrollorëve të trafikut ajror;

f) përfshin kopjet e të gjithë dokumentacionit mbështetës përkatës, duke përfshirë kopjet e kërkesave dhe procedurave përkatëse kombëtare, që tregojnë se si Autoriteti i Aviacionit Civil ka vendosur elementet e renditura në shkronjat (a) deri (e) më sipër.

TABELA E PËRMBAJTJES

ANEKSI I – PJESA ATCO – KËRKESAT PËR LICENCIMIN E KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT AJROR

NËNPJESA A – KËRKESAT E PËRGJITHSHME

ATCO.A.001 Fushëveprimi

ATCO.A.005 Aplikimi për lëshimin e licencave, kategorive dhe miratimeve

ATCO.A.010 Kërkesa për ndryshimin e autoritetit kompetent

ATCO.A.015 Ushtrimi i privilegjeve të licencave dhe pamundësia e përkohshme

ATCO.A.020 Revokimi dhe pezullimi i licencave, kategorive dhe miratimeve

NËNPJESA B – LICENCAT, KATEGORITË DHE MIRATIMET

ATCO.B.001 Licenca e student-kontrollorëve të trafikut ajror

ATCO.B.005 Licenca e kontrollorëve të trafikut ajror

ATCO.B.010 Kategoritë e kontrollorëve të trafikut ajror

ATCO.B.015 Miratimet e kategorive

ATCO.B.020 Miratimet e njësisë

ATCO.B.025 Skema e kompetencës së njësisë

ATCO.B.030 Miratimi për aftësitë gjuhësore

ATCO.B.035 Vlefshmëria e miratimit të aftësisë gjuhësore

ATCO.B.040 Vlerësimi i aftësisë gjuhësore

ATCO.B.045 Trajnimi gjuhësor

NËNPJESA C – KËRKESAT PËR INSTRUKTORËT DHE VLERËSUESIT

SEKSIONI 1 – INSTRUKTORËT

ATCO.C.001 Instruktorët teorikë

ATCO.C.005 Instruktorët praktikë

ATCO.C.010 Privilegjet e instruktorit të trajnimit në vendin e punës (OJTI)

ATCO.C.015 Aplikimi për miratimin e instruktorit të trajnimit në vendin e punës

ATCO.C.020 Vlefshmëria e miratimit të instruktorit të trajnimit në vendin e punës

ATCO.C.025 Autorizimi i përkohshëm i OJTI-së

ATCO.C.030 Privilegjet e instruktorit të pajisjeve stërvitore sintetike (STDI)

ATCO.C.035 Aplikimi për miratimin e instruktorit të pajisjeve sintetike të trajnimit

ATCO.C.040 Vlefshmëria e miratimit të instruktorit të pajisjeve sintetike të trajnimit

SEKSIONI 2 – VLERËSUESIT

ATCO.C.045 Privilegjet e vlerësuesit

ATCO.C.050 Interesa personale

ATCO.C.055 Aplikimi për miratimin e vlerësuesit

ATCO.C.060 Vlefshmëria e miratimit të vlerësuesit

ATCO.C.065 Autorizimi i përkohshëm i vlerësuesit

NËNPJESA D – TRAJNIMI I KONTROLLOREVE TË TRAFIKUT AJROR

SEKSIONI 1 – KËRKESAT E PËRGJITHSHME

ATCO.D.001 Objektivat e trajnimit të kontrollorëve të trafikut ajror



ATCO.D.005 Llojet e trajnimit të kontrollorëve të trafikut ajror

SEKSIONI 2 – KËRKESAT E TRAJNIMIT FILLESTAR

ATCO.D.010 Përbërja e trajnimit fillestar

ATCO.D.015 Plani fillestar i trajnimit

ATCO.D.020 Kurset bazë dhe të trajnimit të vlerësimit

ATCO.D.025 Ekzaminimet dhe vlerësimi i trajnimit bazë

ATCO.D.030 Objektivat bazë të performancës së trajnimit

ATCO.D.035 Ekzaminime dhe vlerësime të trajnimit të vlerësimit

ATCO.D.040 Vlerësimi i objektivave të performancës së trajnimit

SEKSIONI 3 – KËRKESAT E TRAJNIMIT TË NJËSISË

ATCO.D.045 Përbërja e trajnimit të njësisë

ATCO.D.050 Parakushtet e trajnimit të njësisë

ATCO.D.055 Plani i trajnimit të njësisë

ATCO.D.060 Kursi i miratimit të njësisë

ATCO.D.065 Demonstrimi i njohurive dhe të kuptuarit teorik

ATCO.D.070 Vlerësimet gjatë kurseve të miratimit të njësisë

SEKSIONI 4 – KËRKESAT E TRAJNIMIT TË VAZHDUESHËM

ATCO.D.075 Trajnimi i vazhdueshëm

ATCO.D.080 Trajnimi rifreskues

ATCO.D.085 Trajnimi për konvertim

SEKSIONI 5 – TRAJNIMI I INSTRUKTORËVE DHE VLERËSUESVE

ATCO.D.090 Trajnimi i instruktorëve praktikë

ATCO.D.095 Trajnimi i vlerësuesve

SHTOJCA 1 E ANEKSIT I – SHKALLA E VLERËSIMIT TË AFTËSISË GJUHËSORE – KËRKESAT PËR AFTËSINË GJUHËSORE

SHTOJCA 2 E ANEKSIT I – TRAJNIMI BAZË

Subjekti 1: Hyrje në kurs

Subjekti 2: Ligji i aviacionit

Subjekti 3: Menaxhimi i trafikut ajror

Subjekti 4: Meteorologjia

Subjekti 5: Navigacioni

Subjekti 6: Aeroplanët

Subjekti 7: Faktorët njerëzorë

Subjekti 8: Pajisjet dhe sistemet

Subjekti 9: Mjedisi profesional

SHTOJCA 3 E ANEKSIT I – VLERËSIMI I KONTROLLIT TË AERODROMIT (ADC)

Subjekti 1: Hyrje në kurs

Subjekti 2: Ligji i aviacionit

Subjekti 3: Menaxhimi i trafikut ajror

Subjekti 4: Meteorologjia

Subjekti 5: Navigacioni

Subjekti 6: Aeroplanët

Subjekti 7: Faktorët njerëzorë

Subjekti 8: Pajisjet dhe sistemet

Subjekti 9: Mjedisi profesional

Subjekti 10: Situatat jonormale dhe të emergjencës

Subjekti 11: Aeroportet

SHTOJCA 4 E ANEKSIT I – VLERËSIMI PROCEDURAL I KONTROLLIT TË AFRIMIT (APP)

Subjekti 1: Hyrje në kurs

Subjekti 2: Ligji i aviacionit

Subjekti 3: Menaxhimi i trafikut ajror

Subjekti 4: Meteorologjia

Subjekti 5: Navigacioni

Subjekti 6: Aeroplanët

Subjekti 7: Faktorët njerëzorë

Subjekti 8: Pajisjet dhe sistemet

Subjekti 9: Mjedisi profesional

Subjekti 10: Situatat jonormale dhe të emergjencës

Subjekti 11: Aeroportet

SHTOJCA 5 E ANEKSIT I – VLERËSIMI PROCEDURAL I KONTROLLIT TË ZONËS (ACP)

Subjekti 1: Hyrje në kurs

Subjekti 2: Ligji i aviacionit

Subjekti 3: Menaxhimi i trafikut ajror

Subjekti 4: Meteorologjia

Subjekti 5: Navigacioni

Subjekti 6: Aeroplanët

Subjekti 7: Faktorët njerëzorë

Tema 8: Pajisjet dhe sistemet

Tema 9: Mjedisi profesional

Subjekti 10: Situatat jonormale dhe të emergjencës



SHTOJCA 6 E ANEKSIT I – VLERËSIMI I MBIKËQYRJES SË KONTROLLIT TË AFRIMIT (APS)

Subjekti 1: Hyrje në kurs

Subjekti 2: Ligji i aviacionit

Subjekti 3: Menaxhimi i trafikut ajror

Subjekti 4: Meteorologjia

Subjekti 5: Navigacioni

Subjekti 6: Aeroplanët

Subjekti 7: Faktorët njerëzorë

Subjekti 8: Pajisjet dhe sistemet

Subjekti 9: Mjedisi profesional

Subjekti 10: Situatat jonormale dhe të emergjencës

Subjekti 11: Aeroportet

SHTOJCA 7 E ANEKSIT I – VLERËSIMI I MBIKËQYRJES SË KONTROLLIT TË ZONËS (ACS)

Subjekti 1: Hyrje në kurs

Subjekti 2: Ligji i aviacionit

Subjekti 3: Menaxhimi i trafikut ajror

Subjekti 4: Meteorologjia

Subjekti 5: Navigacioni

Subjekti 6: Aeroplanët

Subjekti 7: Faktorët njerëzorë

Subjekti 8: Pajisjet dhe sistemet

Subjekti 9: Mjedisi profesional

Subjekti 10: Situatat jonormale dhe të emergjencës

ANEKSI II – PJESA ATCO.AR – KËRKESAT PËR AUTORITETET KOMPETENTE

NËNPJESA A – KËRKESAT E PËRGJITHSHME

ATCO.AR.A.001 Fushëveprimi

ATCO.AR.A.005 Personeli

ATCO.AR.A.010 Detyrat e autoriteteve kompetente

ATCO.AR.A.015 Mjetet e përputhshmërisë

ATCO.AR.A.020 Informacioni për Agjencinë

ATCO.AR.A.025 Reagimi i menjëhershëm ndaj një problemi sigurie

NËNPJESA B – MENAXHIMI

ATCO.AR.B.001 Sistemi i menaxhimit

ATCO.AR.B.005 Ndarja e detyrave të subjektet e kualifikuara

ATCO.AR.B.010 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit

ATCO.AR.B.015 Mbajtja e të dhënave

NËNPJESA C – MBIKËQYRJA DHE ZBATIMI

ATCO.AR.C.001 Mbikëqyrja

ATCO.AR.C.005 Programi i mbikëqyrjes

ATCO.AR.C.010 Gjetjet dhe masat zbatuese për personelin

NËNPJESA D – LËSHIMI, RIVALIDIMI, RINOVIMI, PEZULLIMI DHE REVOKIMI I LICENCAVE, KATEGORIVE DHE MIRATIMEVE

ATCO.AR.D.001 Procedura për lëshimin, rivalidimin dhe rinovimin e licencave, kategorive, miratimeve dhe autorizimeve

ATCO.AR.D.003 Ndryshimi i autoritetit kompetent

ATCO.AR.D.005 Revokimi dhe pezullimi i licencave, kategorive dhe miratimeve

NËNPJESA E – PROCEDURA E CERTIFIKIMIT PËR ORGANIZATAT E TRAJNIMIT TË KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT AJROR DHE MIRATIMI I KURSIT TË TRAJNIMIT

ATCO.AR.E.001 Procedura e certifikimit për organizatat e trajnimit dhe lëshimi i certifikatës

ATCO.AR.E.005 Miratimi i kurseve të trajnimit dhe i planeve të trajnimit

ATCO.AR.E.010 Ndryshimet në organizatat e trajnimit

ATCO.AR.E.010A Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit

ATCO.AR.E.015 Gjetjet, veprimet korrigjuese dhe masat zbatuese

NËNPJESA F – KËRKESAT SPECIFIKE QË LIDHEN ME CERTIFIKIMIN AEROMJEKËSOR

NENI 1 – KËRKESAT E PËRGJITHSHME

ATCO.AR.F.001 Qendrat aeromjekësore dhe certifikimi aeromjekësor

SEKSIONI 2 – DOKUMENTACIONI

ATCO.AR.F.005 Certifikata mjekësore

ATCO.AR.F.010 Certifikata AME



ATCO.AR.F.015 Certifikata AeMC
ATCO.AR.F.020 Format aeromjekësore

SHTOJCA 1 E ANEKSIT II – FORMATI I
LICENCËS – LICENCA E
KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT AJROR

SHTOJCA 2 E ANEKSIT II – CERTIFI-
KATA PËR ORGANIZATAT E TRAJNIMIT
TË KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT
AJROR (ATCO TO)

SHTOJCA 3 E ANEKSIT II – CERTIFI-
KATA PËR EKZAMINUESIT AEROMJËKË-
SORË (AME)

SHTOJCA 4 E ANEKSIT II – CERTIFI-
KATA PËR QENDRAT AEROMJËKËSORE
(AeMC)

ANEKSI III – PJESA ATCO.OR –
KËRKESAT PËR ORGANIZATAT E TRAJNI-
MIT TË KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT
AJROR DHE QENDRAT AEROMJËKËSORE

NËNPJESA A – KËRKESAT E PËRGJITH-
SHME

ATCO.OR.A.001 Qëllimi

NËNPJESA B – KËRKESAT PËR ORGANI-
ZATAT E TRAJNIMIT TË KONTRO-
LLOREVE TË TRAFIKUT AJROR

ATCO.OR.B.001 Aplikimi për një certifikatë të
organizatës së trajnimit

ATCO.OR.B.005 Mjetet e përputhshmërisë

ATCO.OR.B.010 Kushtet e miratimit dhe
privilegjet e një certifikate të organizatës së trajnimit

ATCO.OR.B.015 Ndryshimet në organizatën e
trajnimit

ATCO.OR.B.020 Vlefshmëria e vazhdueshme

ATCO.OR.B.025 Aksesit në facilitetet dhe të
dhënat e organizatës trajnuese

ATCO.OR.B.030 Gjetjet

ATCO.OR.B.035 Reagimi i menjëhershëm për
një problem në sigurinë në operim

ATCO.OR.B.040 Raportimi i ngjarjeve

NËNPJESA C – MENAXHIMI I ORGANI-
ZATAVE TË TRAJNIMIT TË KONTRO-
LLOREVE TË TRAFIKUT AJROR

ATCO.OR.C.001 Sistemi i menaxhimit të
organizatave të trajnimit

ATCO.OR.C.001A Sistemi i menaxhimit të
sigurisë së informacionit

ATCO.OR.C.005 Aktivitete të kontraktuara

ATCO.OR.C.010 Kërkesat e personelit

ATCO.OR.C.015 Facilitetet dhe pajisjet

ATCO.OR.C.020 Mbajtja e rekordeve

ATCO.OR.C.025 Financimi dhe sigurimet

NËNPJESA D – KËRKESAT PËR KURSET
E TRAJNIMIT DHE PLANET E TRAJNIMIT

ATCO.OR.D.001 Kërkesat për kurset e trajnimit
dhe planet e trajnimit

ATCO.OR.D.005 Rezultatet e ekzhaminimit,
vlerësimit dhe certifikatat

NËNPJESA E – KËRKESAT PËR
QENDRAT AEROMJËKËSORE

ATCO.OR.E.001 Qendrat aeromjekësore

ANEKSI IV – PJESA ATCO.MED – KËRKE-
SAT MJEKËSORE PËR KONTROLLORËT E
TRAFIKUT AJROR

NËNPJESA A – KËRKESAT E PËRGJITH-
SHME

SEKSIONI 1 – PËRGJITHSHME

ATCO.MED.A.001 Autoriteti kompetent

ATCO.MED.A.005 Fushëveprimi

ATCO.MED.A.010 Përkufizime

ATCO.MED.A.015 Konfidencialiteti mjekësor

ATCO.MED.A.020 Rënia në gjendjen fizike

ATCO.MED.A.025 Detyrimet e AeMC dhe
AME-ve

SEKSIONI 2 – KËRKESAT PËR CERTI-
FIKATA MJEKËSORE

ATCO.MED.A.030 Certifikatat mjekësore

ATCO.MED.A.035 Aplikimi për një certifikatë
mjekësore

ATCO.MED.A.040 Lëshimi, rivalidimi dhe
rinovimi i certifikatave mjekësore

ATCO.MED.A.045 Vlefshmëria, rivalidimi dhe
rinovimi i certifikatave mjekësore

ATCO.MED.A.046 Pezullimi ose revokimi i një
certifikate mjekësore

ATCO.MED.A.050 Referenca



NËNPJESA B – KËRKESAT PËR CERTIFIKATAT MJEKËSORE TË KONTROLLOREVE TË TRAFIKUT AJROR

SEKSIONI 1 – TË PËRGJITHSHME

ATCO.MED.B.001 Kufizimet për certifikatat mjekësore

SEKSIONI 2 – KËRKESAT MJEKËSORE PËR CERTIFIKATA MJEKËSORE TË KLASËS 3

ATCO.MED.B.005 Të përgjithshme

ATCO.MED.B.010 Sistemi kardiovaskular

ATCO.MED.B.015 Sistemi respirator

ATCO.MED.B.020 Sistemi tretës

ATCO.MED.B.025 Sistemet metabolike dhe endokrine

ATCO.MED.B.030 Hematologjia

ATCO.MED.B.035 Sistemi gjeniturinor

ATCO.MED.B.040 Sëmundjet infektive

ATCO.MED.B.045 Obstetrika dhe gjinekologjia

ATCO.MED.B.050 Sistemi muskuloskeletor

ATCO.MED.B.055 Psikiatria

ATCO.MED.B.060 Psikologjia

ATCO.MED.B.065 Neurologjia

ATCO.MED.B.070 Sistemi vizual

ATCO.MED.B.075 Shikimi i ngjyrave

ATCO.MED.B.080 Otorinolaringologjia

ATCO.MED.B.085 Dermatologjia

ATCO.MED.B.090 Onkologjia

NËNPJESA C – EKZAMINUESIT AEROMJEKËSORE (AME)

ATCO.MED.C.001 Privilegjet

ATCO.MED.C.005 Aplikimi

ATCO.MED.C.010 Kërkesat për lëshimin e një certifikate AME

ATCO.MED.C.015 Kurset e trajnimit në mjekësinë e aviacionit

ATCO.MED.C.020 Ndryshimet në certifikatën AME

ATCO.MED.C.025 Vlefshmëria e certifikatave AME

ANEKSI I

PJESA ATCO

KËRKESAT PËR LICENCIMIN E KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT AJROR

NËNPJESA A

KËRKESAT E PËRGJITHSHME

ATCO.A.001 Fushëveprimi

Kjo pjesë, e përcaktuar në këtë aneks, vendos kërkesat për lëshimin, revokimin dhe pezullimin e licencave të student-kontrollorëve të trafikut ajror dhe licencat e kontrollorëve të trafikut ajror, kategorive dhe miratimeve të tyre përkatëse, si dhe kushtet e vlefshmërisë dhe përdorimit të tyre.

ATCO.A.005 Aplikimi për lëshimin e licencave, kategorive dhe miratimeve

a) Aplikimi për lëshimin e licencave, kategorive dhe miratimeve do të dorëzohet në Autoritetin e Aviacionit Civil, në përputhje me procedurën e përcaktuar prej tij.

b) Aplikimi për lëshimin e kategorive ose miratimeve të mëtejshme, për rivlefshmërinë ose rinovimin e miratimeve dhe për rilëshimin e licencës do të dorëzohen në Autoritetin e Aviacionit Civil, si autoriteti që e ka lëshuar atë licencë.

c) Licenca do të mbetet pronë e personit për të cilin ajo është lëshuar, derisa të revokohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Mbajtësi i licencës do të nënshkruajë licencën.

d) Licenca do të specifikojë të gjitha informacionet përkatëse të lidhura me privilegjet që jepen nga licenca dhe do të jetë në përputhje me kërkesat e shtojcës 1 të aneksit II.

ATCO.A.010 Kërkesa për ndryshimin e Autoritetit Kompetent

a) Nëse mbajtësi i licencës do të ushtrojë privilegjet e miratimit të njësisë në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që licenca është lëshuar nga një autoritet kompetent i një shteti të BE-së, mbajtësi i licencës do të kërkojë ndryshimin e autoritetit kompetent tek Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Shqipërisë, ku këto privilegje do të ushtrohen në përputhje me procedurën e vendosur nga ky i fundit. Për këtë qëllim, autoritetet kompetente të përfshira do të ndajnë të gjitha informacionet përkatëse të nevojshme për të kryer ndryshimin e autoritetit kompetent dhe shkëmbimin e licencës, sipas procedurave të përmendura në



pikën ATCO.AR.B.001(c) dhe pikën ATCO.AR.D.003.

b) Me përjashtim të pikës (a) më sipër, një ndryshim i autoritetit kompetent nuk kërkohet, kur vetëm privilegjet e instruktorit ose vlerësuesit të trajnimit me pajisje sintetike ushtrohen në një mjedis trajnimi me pajisje sintetike ose kur ushtrohen privilegjet e një licence të student-kontrollorëve të trafikut ajror.

c) Për qëllime të ushtrimit të privilegjeve të licencës në Republikën e Shqipërisë, kur Shqipëria nuk është vendi që ka lëshuar licencën, mbajtësi i licencës duhet të plotësojë kërkesat e aftësisë gjuhësore të përmendura në pikën ATCO.B.030 të përcaktuara nga Republika e Shqipërisë.

ATCO.A.015 Ushtrimi i privilegjeve të licencave dhe paaftësia e përkohshme

a) Ushtrimi i privilegjeve të dhëna nga një licencë do të varet nga vlefshmëria e miratimeve të kategorive, vlefshmëria e miratimeve të njësisë dhe licencës, si dhe nga certifikata mjekësore, përveç rasteve kur certifikata mjekësore nuk kërkohet në përputhje me shkronjën (b).

b) Certifikata mjekësore nuk kërkohet kur ushtrohen privilegjet e instruktorit ose vlerësuesit në një mjedis të trajnimit me pajisje sintetike.

c) Mbjtësit e licencës nuk do të ushtrojnë privilegjet e licencës së tyre, kur kanë dyshime mbi të qenët në gjendje për të ushtruar në mënyrë të sigurt privilegjet e licencës dhe në të tilla raste duhet të njoftojnë menjëherë ofruesin përkatës të shërbimit të lundrimit ajror për paaftësinë e përkohshme për të ushtruar privilegjet e licencës së tyre.

d) Ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror mund të deklarojnë paaftësinë e përkohshme të mbajtësit të licencës, nëse vihen në dijeni të ndonjë dyshimi në lidhje me aftësinë e mbajtësit të licencës për të ushtruar në mënyrë të sigurt privilegjet e licencës.

e) Ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror do të zhvillojnë dhe zbatojnë procedura objektive, transparente dhe jodiskriminuese për t'u mundësuar mbajtësve të licencës që deklarojnë paaftësinë e përkohshme për të ushtruar privilegjet e licencës së tyre, në përputhje me shkronjën (c), të deklarojnë paaftësinë e përkohshme të mbajtësit të licencës në përputhje me shkronjën (d) dhe të informojnë Autoritetin e Aviacionit Civil, siç përcaktohet në atë procedurë.

f) Procedurat e përmendura në shkronjën (e) do

të përfshihen në skemën e kompetencës së njësisë sipas pikës ATCO.B.025(a)(13).

ATCO.A.020 Revokimi dhe pezullimi i licencave, kategorive dhe miratimeve

a) Licencat, kategoritë dhe miratimet mund të pezullohen ose revokohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil sipas ATCO.AR.D.005, kur mbajtësi i licencës nuk pajtohet me kërkesat e kësaj Pjese.

b) Kur mbajtësit të licencës i revokohet licenca e tij/saj, ai/ajo do t'i kthejë menjëherë licencën Autoritetit të Aviacionit Civil, sipas procedurave administrative të vendosura nga ai.

c) Me lëshimin e licencës së kontrollorit të trafikut ajror, licenca e student-kontrollorit të trafikut ajror revokohet dhe do t'i kthehet Autoritetit të Aviacionit Civil si autoriteti që lëshon licencën e kontrollorit të trafikut ajror.

NËNPJESA B LICENCAT, KATEGORITË DHE MIRATIMET

ATCO.B.001 Licenca e student-kontrollorëve të trafikut ajror

a) Mbjtësit e licencës së student-kontrollorit të trafikut ajror do të autorizohen për të ofruar shërbime të kontrollit të trafikut ajror, në përputhje me kategoritë dhe miratimet e kategorive që përmbahen në licencën e tyre nën mbikëqyrjen e një instruktori të trajnimit në vendin e punës dhe të ndërmarrin trajnime për miratimin e kategorisë shtesë dhe miratimet e njësisë.

b) Aplikantët për një licencë të student-kontrollorit të trafikut ajror duhet:

1) të jenë së paku 18 vjeç;

2) brenda 12 muajve para aplikimit, të kenë përfunduar me sukses trajnimin fillestar në një organizatë trajnimi që plotëson kërkesat e përcaktuara në aneksin III (pjesa ATCO.OR), në lidhje me kategorinë, dhe nëse është e aplikueshme, për miratimin e kategorisë, siç përcaktohet në pjesën ATCO, nënpjesa D, seksioni 2;

3) të kenë një certifikatë të vlefshme mjekësore;

4) të kenë treguar një nivel të përshtatshëm të njohurive gjuhësore në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën ATCO.B.030.

c) Licenca e student-kontrollorëve të trafikut ajror duhet të përmbajë miratimin/et e aftësisë



gjuhësore dhe të paktën një kategori dhe, nëse zbatohet, një miratim kategorie.

d) Mbajtësi i licencës së student-kontrollorëve të trafikut ajror që nuk ka filluar ushtrimin e privilegjeve të kësaj licence brenda 1 viti nga data e lëshimit të saj ose ka ndërprerë ushtrimin e këtyre privilegjeve për një periudhë më shumë se 1 vit, mund të fillojë ose të vazhdojë trajnimin në vendin e punës vetëm në atë kategori:

1) nëse një organizatë trajnimi që plotëson kërkesat e përcaktuara në aneksin III (pjesa ATCO.OR) dhe e certifikuar për të ofruar trajnim fillestar në lidhje me kategoritë, ka kryer një vlerësim të kompetencës së mëparshme që mbajtësi i licencës së student-kontrollorëve të trafikut ajror vazhdon të përmbushë kërkesat përkatëse për atë kategori; dhe

2) pas përmbushjes së çdo kërkesë trajnimi që rezulton nga vlerësimi i përmendur në shkronjën (d)(1) më sipër.

ATCO.B.005 Licenca e kontrollorëve të trafikut ajror

a) Mbajtësit e një licence të kontrollorëve të trafikut ajror do të autorizohen për të ofruar shërbime të kontrollit të trafikut ajror, në përputhje me kategoritë dhe miratimet e kategorive që gjenden në licencën e tyre dhe për të ushtruar privilegjet e miratimeve që gjenden aty.

b) Privilegjet e licencës së kontrollorëve të trafikut ajror do të përfshijnë privilegjet e licencës së student-kontrollorëve të trafikut ajror, siç përcaktohet në ATCO.B.001(a).

c) Aplikantët për lëshimin e parë të një licence të kontrollorëve të trafikut ajror duhet:

1) të mbajnë një licencë të student-kontrollorëve të trafikut ajror;

2) të kenë përfunduar një kurs për miratimin e njësish dhe të kenë kaluar me sukses ekzaminimet dhe vlerësimet e përshtatshme në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pjesën ATCO, nënpjesa D, seksioni 3;

3) të mbajnë një certifikatë mjekësore të vlefshme;

4) të kenë treguar një nivel të përshtatshëm të aftësisë gjuhësore në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ATCO.B.030.

d) Licenca e kontrollorëve të trafikut ajror do të vlefshë nga përfshirja e një ose më shumë kategorive dhe kategorisë përkatëse, miratimet e njësish dhe të aftësisë gjuhësore, për të cilat trajnimi është kryer me sukses.

e) Mbajtësi i licencës së kontrollorëve të trafikut ajror, i cili nuk ka filluar të ushtrorë privilegjet e një kategorie brenda 1 viti nga data e lëshimit të tij, mund të fillojë trajnimin në vendin e punës vetëm në atë kategori:

1) nëse një organizatë trajnimi që plotëson kërkesat e përcaktuara në aneksin III (pjesa ATCO.OR) dhe e certifikuar për të ofruar trajnim fillestar në lidhje me kategorinë, ka kryer një vlerësim të kompetencës së mëparshme për të përcaktuar që kompetenca e mëparshme e mbajtësit të një licence të kontrollorëve të trafikut ajror vazhdon të përmbushë kërkesat përkatëse për atë kategori; dhe

2) pas përmbushjes së çdo kërkesë trajnimi që rezulton nga vlerësimi i përmendur në shkronjën (e)(1) më sipër.

f) Një licencë e kontrollorëve të Trafikut Ajror do të jetë e vlefshme deri në momentin që aplikanti mbush 60 vjeç. Pas kësaj moshe licenca nuk mund të rinovohet. Ofruesit e Shërbimit të Lundrimit Ajror duhet të marrin masa dhe të ngrenë procedura për sistemin e personelit, që preket nga ky kriter, brenda administratës operacionale.

ATCO.B.010 Kategoritë e kontrollorëve të trafikut ajror

a) Licencat duhet të përmbajnë një ose më shumë prej kategorive të mëposhtme, me qëllim për të treguar llojin e shërbimit që mbajtësi i licencës është i autorizuar të ofrojë:

1) Kategoritë e Kontrollit të Aerodromit (ADC), që tregon se mbajtësi i licencës është kompetent për të ofruar shërbime të kontrollit të trafikut ajror për trafikun e aerodromit;

2) Kategoritë e Kontrollit Procedural të Afrimit (APP), që tregon se mbajtësi i licencës është kompetent për të ofruar shërbime të kontrollit të trafikut për mbërritjen, nisjen, ose tranzitimin e avionit pa përdorimin e pajisjeve të survejimit;

3) Kategoritë e Kontrollit të Afrimit me Survejim (APS), që tregon se mbajtësi i licencës është kompetent për të ofruar shërbime të kontrollit të trafikut ajror për mbërritjen, nisjen, ose tranzitimin e avionit duke përdorur pajisjet e survejimit;

4) Kategoritë e Kontrollit Procedural të Hapësirës (ACP), që tregon se mbajtësi i licencës është kompetent për të ofruar shërbime të kontrollit të trafikut ajror për avionin pa përdorimin e pajisjeve të survejimit;

5) Kategoritë e Kontrollit të Hapësirës me Survejim (ACS), që tregon se mbajtësi i licencës



është kompetent për të ofruar shërbim të kontrollit të trafikut ajror për avionin me përdorimin e pajisjeve tëurvejimit.

b) Mbajtësi i një kategorie që ka ndërprerë ushtrimin e privilegjeve të lidhura me atë kategori për një periudhë prej 4 ose më shumë vitesh të njëpasnjëshme që sapo kanë kaluar, mund të fillojë trajnimin në punë vetëm në atë kategori:

1) nëse një organizatë trajnimi që plotëson kërkesat e përcaktuara në aneksin III (pjesa ATCO.OR) dhe e certifikuar për të ofruar trajnime përkatëse për kategorinë, ka kryer një vlerësim të kompetencës së mëparshme për të përcaktuar që mbajtësi i një kategorie vazhdon të përmbushë kushtet e asaj kategorie; dhe

2) pas përmbushjes së çdo kërkesë trajnimi që rezulton nga vlerësimi i përmendur në shkronjën (b)(1) më sipër.

ATCO.B.015 Miratimet e kategorive

a) Kategoria e Kontrollit të Aerodromit (ADC) mund të ketë miratimin e Mbikëqyrjes së Kontrollit të Aerodromit (SUR), që tregon se mbajtësi i licencës është kompetent për të siguruar kontrollin e aerodromit me ndihmën e sistemeve të mbikëqyrjes.

b) Kategoria e Kontrollit të Afrimit meurvejim (APS) mund të ketë një ose më shumë nga miratimet e mëposhtme:

1) Miratimin e Radarit të Afrimit me Precizion (PAR), që tregon se mbajtësi i licencës është kompetent të ofruar kontrollin nga toka të afrimit me përdorimin e radarit të afrimit me precizion për avionin, në afrimin përfundimtar drejt pistës;

2) Miratimin eurvejimit të Afrimit me Radar (SRA), që tregon se mbajtësi i licencës është kompetent për të ofruar kontrollin nga toka për afrimin jopreciz me përdorimin e pajisjes sëurvejimit, për avionin, në afrimin përfundimtar drejt pistës.

c) Kategoria e Kontrollit Procedural të Hapësirës (ACP) mund të mbajë miratimin e Kontrollit Oqeanik (OCN), që tregon se mbajtësi i licencës është kompetent për të ofruar shërbimet e kontrollit të trafikut ajror për avionin që operon në Hapësirën Oqeanike të Kontrollit.

d) Kategoria e Kontrollit të Hapësirës meurvejim (ACS) mund të mbajë miratimin OCN, që tregon se mbajtësi i licencës është kompetent për të ofruar shërbimet e kontrollit të trafikut ajror për avionin që operon në një Hapësirë Oqeanike të Kontrollit.

ATCO.B.020 Miratimet e njësive

a) Miratimi i njësive do të autorizojë mbajtësin e licencës për të ofruar shërbimet e kontrollit të trafikut ajror për një sektor specifik, grup sektorësh dhe/ose pozicione pune nën përgjegjësinë e një njësie të shërbimeve të trafikut ajror.

b) Aplikantët për një miratim njësie duhet të kenë përfunduar me sukses një kurs të miratimit të njësive, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pjesën ATCO, nënpjesa D, seksioni 3.

c) Si përjashtim nga shkronja (b), faza e trajnimit në vendin e punës në pjesën ATCO, nënpjesa D, seksioni 3 mund të mos kërkohet kur miratimi i njësive lëshohet në lidhje me lëshimin e një autorizimi të përkohshëm OJTI për të njëjtën njësi.

d) Kufizimet në ushtrimin e privilegjeve të Kategorisë së Kontrollit të Aerodromit (ADC) do të tregohen në miratimin e njësive.

e) Aplikantët për miratimin e njësive që ndryshojnë autoritetin e tyre kompetent, siç përmendet në pikën ATCO.A.010, përveç kërkesave të përcaktuara në pikën ATCO.B.020(b), duhet të plotësojnë kërkesat e pikës ATCO.D.060(f).

f) Për kontrollorët e trafikut ajror që ofrojnë shërbime të kontrollit të trafikut ajror për avionët që kryejnë teste fluturimi, Autoriteti i Aviacionit Civil, përveç kërkesave të përcaktuara në shkronjën (b), mundet që të përcaktojë kërkesa shtesë që duhen përmbushur.

g) Miratimet e njësive do të jenë të vlefshme për një periudhë të përcaktuar në skemën e kompetencës së njësive. Kjo periudhë nuk duhet të kalojë 3 vjet.

h) Periudha e vlefshmërisë së miratimeve të njësive për lëshimin fillestar dhe rinovimin do të fillojë jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën vlerësimi është përfunduar me sukses.

i) Miratimet e njësive do të rivlefshmërohen, nëse:

1) aplikanti ka ushtruar privilegjet e një licence për një numër minimal orësh, siç përcaktohet në skemën e kompetencës së njësive;

2) aplikanti ka kryer trajnime rifreskuese brenda periudhës së vlefshmërisë së miratimit të njësive sipas skemës së kompetencës së njësive;

3) kompetenca e aplikantit është vlerësuar në përputhje me skemën e kompetencës së njësive jo më herët se 3 muaj përpara datës së skadencës të miratimit të njësive.



j) Miratimet e njësisë rivlefshëmohen, me kusht që kërkesat e përcaktuara në pikën (i) të plotësohen brenda periudhës 3-mujore menjëherë para datës së tyre të skadencës. Në raste të tilla, periudha e vlefshmërisë do të llogaritet nga ajo datë e skadencës.

k) Nëse miratimi i njësisë rivlefshëmohet përpara periudhës së parashikuar në shkronjën (j), periudha e vlefshmërisë së tij do të fillojë jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën vlerësimi është përfunduar me sukses, me kusht që të plotësohen, gjithashtu, kërkesat në pikën (i) (1) dhe (2).

l) Nëse vlefshmëria e një miratimi njësie skadon, mbajtësi i licencës do të përfundojë me sukses kursin e miratimit të njësisë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pjesën ATCO, nënpjesa D, seksioni 3, 3 me qëllim për të rinovuar miratimin.

ATCO.B.025 Skema e kompetencës së njësisë

a) Skemat e kompetencës së njësisë do të krijohen nga ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror dhe do të miratohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Një skemë e kompetencës së njësisë duhet të përfshijë të paktën elementet e mëposhtme:

1) vlefshmërinë e miratimit/ve të njësisë në përputhje me pikën ATCO.B.020(g);

2) periudhën maksimale të vazhdueshme kur privilegjet e një miratimi të njësisë nuk ushtrohen gjatë vlefshmërisë së tij; kjo periudhë nuk duhet të kalojë 90 ditë kalendarike;

3) numrin minimal të orëve ose, në rastin e miratimeve të kategorisë SRA dhe PAR, numrin minimal të afrimeve, për ushtrimin e privilegjeve të miratimit të njësisë brenda një periudhe kohe të përcaktuar, e cila nuk duhet të kalojë 12 muaj, për qëllimin e pikës ATCO.B.020(i)(1). Për instruktorët e trajnimit në vendin e punës që ushtrojnë privilegjet e miratimit të OJT-i-së, koha e shpenzuar, duke instruktuar do të llogaritet për maksimumin e 50% të orëve të kërkuara për rivlefshëmimin e miratimit të njësisë;

4) procedurat për rastet kur mbajtësi i licencës nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në shkronjën (a), pikat (2) dhe (3);

5) proceset për vlerësimin e kompetencës, duke përfshirë vlerësimin e subjekteve të trajnimit rifreskues sipas ATCO.D.080(b);

6) proceset për ekzaminimin e njohurive teorike dhe të kuptuarit të nevojshëm për të ushtruar privilegjet e kategorive dhe miratimeve;

7) proceset për të identifikuar temat dhe nëntemat, objektivat dhe metodat trajnuese për trajnimin e vazhdueshëm;

8) kohëzgjatjen minimale dhe frekuencën e trajnimit rifreskues;

9) proceset për ekzaminimin e njohurive teorike dhe/ose vlerësimin e aftësive praktike të fituara gjatë trajnimit të konvertimit, duke përfshirë pikët kaluese për provimet;

10) proceset në rast të moskalimit të një ekzaminimi ose vlerësimi, duke përfshirë proceset e apelimit;

11) kualifikimet, rolet dhe përgjegjësitë e personelit trajnues;

12) procedurat për të siguruar që instruktorët praktikë kanë praktikuar teknika mësimore, në procedurat në të cilat jepet mësimi në përputhje me pikën ATCO.C.010(b)(3) dhe me pikën ATCO.C.030(b)(3);

13) procedurat për deklarimin dhe menaxhimin e rasteve të paaftësisë së përkohshme për të ushtruar privilegjet e licencës, si dhe për informimin e Autoritetit të Aviacionit Civil, në përputhje me pikën ATCO.A.015(e);

14) identifikimin rekordeve specifike për t'u mbajtur në trajnimin e vazhdueshëm dhe vlerësimet, në përputhje me ATCO.OR.C.020;

15) proceset dhe arsyet për rishikimin dhe ndryshimin e skemës së kompetencës së njësisë dhe dorëzimit të saj tek Autoriteti i Aviacionit Civil. Rishikimi i skemës së kompetencës së njësisë do të bëhet të paktën një herë në 3 vjet.

b) Për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në shkronjën (a) (3), ofruesit e shërbimeve të lundrimit ajror do të mbajnë shënime për orët gjatë të cilave çdo mbajtës i licencës ushtron privilegjet e miratimit/ve të njësisë së tij/saj, duke punuar në sektorë, grup sektorësh dhe/ose pozicione pune në njësinë ATC, dhe do t'ia ofrojnë këto të dhëna Autoritetit të Aviacionit Civil dhe mbajtësit të licencës sipas kërkesës.

c) Kur vendosen procedurat e referuara në shkronjën (a) (4) dhe (a) (13), ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror duhet të sigurojnë që të zbatohen mekanizmat për të garantuar trajtim të drejtë të mbajtësve të licencës kur vlefshmëria e miratimeve të tyre nuk mund të zgjatet.

ATCO.B.030 Miratimi i aftësisë gjuhësore

a) Kontrollorët e trafikut ajror dhe student-kontrollorët e trafikut ajror nuk do të ushtrojnë



privilegjet e licencave të tyre, pa pasur një miratim të vlefshëm të aftësisë gjuhësore në gjuhën angleze dhe, nëse aplikohet, në gjuhën/ët e vendosura nga shteti për arsye të sigurisë në operim në njësitë e ATC-së, siç botohet në Publikimet e Informacioneve Aeronautike (AIP). Miratimi i aftësisë gjuhësore do të tregojë gjuhën, nivelin e aftësisë dhe datën e skadencës.

b) Niveli i aftësisë gjuhësore do të përcaktohet në përputhje me shkallën e vlerësimit të përcaktuar në shtojcën 1 të aneksit I.

c) Aplikanti për miratimin e aftësisë gjuhësore do të tregojë, në përputhje me shkallën e vlerësimit të referuar në shkronjën (b), së paku në një nivel operacional (niveli katër).

Për ta bërë këtë, aplikanti duhet:

1) të komunikojë në mënyrë efektive vetëm me zë (telefon/radiotelefon) dhe në situatat ballë për ballë;

2) të komunikojë mbi temat e zakonshme, konkrete dhe të lidhura me punën me saktësi dhe qartësi;

3) të përdorë strategji të përshtatshme komunikimi për të shkëmbyer mesazhe dhe të njohë dhe zgjidhë keqkuptimet në një kontekst të përgjithshëm ose të lidhur me punën;

4) të trajtojë me sukses dhe me lehtësinë përkatëse sfidat gjuhësore të paraqitura nga një komplikim ose ndërrim i papritur ngjarjesh që ndodhin brenda kontekstit të një situatë pune rutinë ose detyrë komunikuese me të cilën ata janë të njohur; dhe

5) të përdorë një dialekt ose theks që është i kuptueshëm për komunitetin aeronautik.

d) Pavarësisht shkronjës (c), niveli i zgjeruar (niveli pesë) i shkallës së vlerësimit të aftësisë gjuhësore i përcaktuar në shtojcën 1, të aneksit I, mund të kërkohej nga ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror, kur rrethanat operationale të një kategorie ose miratimi të veçantë kërkojnë një nivel më të lartë të aftësisë gjuhësore për arsye të sigurisë në operim (*Safety*). Një kërkesë e tillë duhet të jetë jodiskriminuese, proporcionale, transparente dhe objektive dhe të justifikuar nga ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror që dëshiron të aplikojë për nivel më të lartë të aftësisë dhe do të miratohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

e) Aftësia gjuhësore do të tregohet nga një certifikatë që tregon dhe rezultatin e vlerësimit.

ATCO.B.035 Vlefshmëria e miratimit të aftësisë gjuhësore

a) Vlefshmëria e miratimit të aftësisë gjuhësore, në varësi të nivelit të përcaktuar, në përputhje me shtojcën 1 të aneksit I, do të jetë:

1) për nivelin operacional (niveli katër), tre vjet nga data e vlerësimit; ose

2) për nivelin e zgjeruar (niveli pesë), gjashtë vjet nga data e vlerësimit;

3) për nivelin ekspert (niveli gjashtë):

i. nëntë vjet nga data e vlerësimit, për gjuhën angleze;

ii. e pakufizuar, për çdo gjuhë tjetër të referuar në ATCO.B.030 (a).

b) Periudha e vlefshmërisë së miratimeve të aftësisë gjuhësore për lëshimin fillestar dhe rinovimin do të fillojë jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën vlerësimi i aftësisë gjuhësore është përfunduar me sukses.

c) Miratimet e aftësisë gjuhësore do të rivlefshmërohen pas përfundimit me sukses të vlerësimit të aftësisë gjuhësore që ndodh brenda tre muajve para datës së skadencës së tyre. Në raste të tilla, periudha e re e vlefshmërisë do të llogaritet nga ajo e datës së skadencës.

d) Nëse miratimi i aftësisë gjuhësore rivlefshmërohet para periudhës së parashikuar në shkronjën (c), periudha e tij e vlefshmërisë do të fillojë jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën vlerësimi i aftësisë gjuhësore është përfunduar me sukses.

e) Kur vlefshmëria e një miratimi të aftësisë gjuhësore skadon, mbajtësi i licencës do të përfundojë me sukses një vlerësim të aftësisë gjuhësore me qëllim që të rinovojë miratimin e tij/saj.

ATCO.B.040 Vlerësimi i aftësisë gjuhësore

a) Demonstrimi i aftësisë gjuhësore do të bëhet përmes një metode të vlerësimit të miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, që duhet të përmbajë:

1) procesin me të cilin bëhet një vlerësim;

2) kualifikimin e vlerësuesve;

3) procedurën e apelimit.

b) Organet e vlerësimit të gjuhës duhet të përputhen me kërkesat e vendosura nga Autoriteti i Aviacionit Civil sipas ATCO.AR.A.010.

ATCO.B.045 Trajnimi gjuhësor

a) Ofruesit e shërbimit të lundrimit ajror do të vendosin në dispozicion trajnimit gjuhësor për të ruajtur nivelin e kërkuar të aftësisë gjuhësore të kontrollorëve të trafikut ajror, për:



1) mbajtësit e miratimit të aftësisë gjuhësore në nivel operacional (niveli katër);

2) mbajtësit e licencës pa mundësinë për të aplikuar aftësitë e tyre rregullisht, me qëllim ruajtjen e aftësisë së tyre gjuhësore.

b) Trajnimi gjuhësor mund të bëhet, gjithashtu, në formën e trajnimit të vazhdueshëm.

NËNPJESA C KËRKESAT PËR INSTRUKTORËT DHE VLERËSUESIT

SEKSIONI 1 INSTRUKTORËT

ATCOC.001 Instruktorët teorikë

a) Trajnimi teorik do të kryhet vetëm nga instruktorët e kualifikuar në mënyrë të përshtatshme.

b) Një instruktor teorik është kualifikuar në mënyrë të përshtatshme nëse ai/ajo:

1) mban një licencë të kontrollorëve të trafikut ajror dhe/ose mban një kualifikim profesional të përshtatshëm për lëndën që jep mësim dhe/ose ka treguar njohuri dhe eksperiencë të përshtatshme për organizatën trajnuese;

2) ka treguar aftësi instruktuese për organizatën trajnuese.

ATCO.C.005 Instruktorët praktikë

Një person do të kryejë trajnuesin praktik kur ai/ajo mban një licencë të kontrollorëve të trafikut ajror me një miratim të instruktorit trajnues në vendin e punës (ITVP) ose një miratim të instruktorit të pajisjes trajnuese sintetike (STDI/IPTS).

ATCO.C.010 Privilegjet e instruktorit të trajnimit në vendin e punës (ITVP)

a) Mbajtësit e një miratimi ITVP janë të autorizuar për të ofruar trajnim praktik dhe mbikëqyrje mbi pozicionet e punës operationale, për të cilat ka një miratim njësie të vlefshëm dhe mbi pajisjet trajnuese sintetike në kategoritë e mbajtura.

b) Mbajtësit e një miratimi ITVP do të ushtrojnë vetëm privilegjet e miratimit kur ka:

1) ushtruar për së paku dy vjet privilegjin e kategorisë për të cilin ata do të instruktojnë;

2) ushtruar për të paktën gjashtë muajt e fundit pararendës privilegjin e miratimit të vlefshëm të njësisë, në të cilin instruksioni do të jepet;

3) ushtruar aftësitë instruktuese në ato procedura

në të cilat mendohet të ofrojnë instruksion.

c) Periudha prej dy vjetësh e referuar në shkronjën (b)(1) mund të shkurtohet në jo më pak se një vit nga Autoriteti i Aviacionit Civil kur kërkohet nga organizata trajnuese.

ATCO.C.015 Aplikimi për miratimin e instruktorit trajnues në vendin e punës

Aplikantët për lëshimin e një miratimi ITVP duhet të:

a) mbajnë një licencë të kontrollorëve të trafikut ajror me një miratim të vlefshëm të njësisë;

b) kenë ushtruar privilegjet e një licence të kontrollorëve të trafikut ajror për një periudhë prej të paktën 2 vjetësh përpara aplikimit; kjo periudhë mund të shkurtohet në jo më pak se 1 vit nga Autoriteti i Aviacionit Civil, kur kërkohet nga organizata trajnuese; dhe

c) brenda 12 muajve para aplikimit, të kenë përfunduar me sukses një kurs teknikash praktike udhëzuese, gjatë të cilit njohuritë e kërkuara dhe aftësitë pedagogjike janë mësuar dhe janë vlerësuar në mënyrë të përshtatshme.

ATCO.C.020 Vlefshmëria e miratimit të instruktorit të trajnimit në vendin e punës

a) Miratimi ITVP do të jetë i vlefshëm për një periudhë 3-vjeçare.

b) Miratimi ITVP mund të rivlefshmërohet pas përfundimit me sukses të trajnimit rifreskues mbi aftësitë praktike udhëzuese gjatë periudhës së vlefshmërisë së tij, me kusht që të plotësohet kërkesa e pikës ATCO.C.015(a).

c) Nëse miratimi ITVP ka skaduar, me kusht që të plotësohet kërkesa e pikës ATCO.C.015(a), ai mund të rinovohet nëse, brenda 12 muajve para aplikimit për rinovim, mbajtësi i miratimit OJTI ka:

1) marrë trajnim rifreskues për aftësitë praktike udhëzuese; dhe

2) kaluar me sukses një vlerësim praktik të kompetencës së instruktorit.

d) Në rastin e lëshimit të parë dhe rinovimit, periudha e vlefshmërisë së miratimit të ITVP do të fillojë jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën është përfunduar vlerësimi me sukses.

e) Nëse kërkesat e pikës ATCO.C.015(a) nuk përmbushen, miratimi ITVP mund të shkëmbetet me një miratim STDI, me kusht që të sigurohet përputhshmëria me kërkesat e pikës ATCO.C.040 (b) dhe (c).



ATCO.C.025 Autorizimi i përkohshëm i ITVP-së

a) Kur përputhshmëria me kërkesat e parashikuara në ATCO.C.010(b)(2) nuk është e mundur, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të japë autorizim të përkohshëm të OJTI bazuar në një analizë të sigurisë në operim (*Safety*) të paraqitur nga ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror.

b) Autorizimi i përkohshëm i OJTI/ITVP i referuar në shkronjën (a) mund të lëshohet për mbajtësit e një miratimi të vlefshëm OJTI/ITVP të lëshuar në përputhje me ATCO.C.015.

c) Autorizimi i përkohshëm i OJTI/ITVP i referuar në shkronjën (a) do të kufizohet në instruksionin e nevojshëm për të mbuluar situata të veçanta dhe vlefshmëria e tij nuk do të tejkalojë një vit ose skadencën e vlefshmërisë së miratimit të OJTI/ITVP, të lëshuar në përputhje me ATCO.C.015, cilado të ndodhë më shpejt.

ATCO.C.030 Privilegjet e instruktorit të pajisjes sintetike trajnuese (STDI)

a) Mbajtësit e një miratimi STDI janë të autorizuar të ofrojnë trajnim praktik në pajisjet trajnuese sintetike:

1) për subjekte të natyrës praktike gjatë trajnimit fillestar;

2) për trajnimin e njësive përveç OJT; dhe

3) për trajnimin e vazhdueshëm.

Kur STDI ofron pre-OJT (para trajnim në vendin e punës), ai ose ajo duhet të mbajë ose të ketë miratimin e njësive përkatëse.

b) Mbajtësit e një miratimi STDI do të ushtrojnë privilegjet e miratimit vetëm nëse kanë:

1) së paku 2 vjet eksperiencë në kategorinë për të cilin do të instruktojnë;

2) njohuri të treguara në praktikat aktuale operationale;

3) praktikuar teknikat udhëzuese në ato procedura në të cilat mendohet të ofrojnë instruksion.

c) Si përjashtim nga shkronja (b) (1):

1) periudha prej 2 vjetësh mund të shkurtohet në jo më pak se 1 vit nga Autoriteti i Aviacionit Civil, kur kërkohet nga organizata e trajnimit;

2) për qëllime të trajnimit bazik, çdo vlerësim i mbajtur është i përshtatshëm;

3) për qëllime të trajnimit të kategorisë, trajnimi mund të ofrohet për detyra operationale specifike dhe të zgjedhura nga një STDI që mban një kategori

që është e përshtatshme për atë detyrë specifike operationale dhe të zgjedhur.

ATCO.C.035 Aplikimi për miratimin e instruktorit të trajnimit me pajisje sintetike

Aplikantët për lëshimin e një miratimi STDI duhet:

a) të kenë ushtruar privilegjet e një licence të kontrollorëve të trafikut ajror në çdo kategori për të paktën 2 vjet; kjo periudhë mund të shkurtohet në jo më pak se 1 vit nga autoriteti kompetent, kur kërkohet nga organizata e trajnimit; dhe

b) brenda 12 muajve para aplikimit, të kenë përfunduar me sukses një kurs teknikash udhëzuese praktike, gjatë të cilit mësohen njohuritë e kërkuara dhe aftësitë pedagogjike të jenë mësuar, duke përdorur metodat teorike dhe praktike dhe të jenë vlerësuar në mënyrë të përshtatshme.

ATCO.C.040 Vlefshmëria e miratimit të instruktorit të trajnimit me pajisje sintetike

a) Miratimi i STDI do të jetë i vlefshëm për një periudhë 3-vjeçare.

b) Miratimi i STDI mund të rivlefshmërohet, duke përfunduar me sukses trajnimin rifreskues mbi aftësitë udhëzuese praktike dhe mbi praktikat operationale aktuale gjatë periudhës së tij të vlefshmërisë.

c) Nëse miratimi i STDI-së ka skaduar, ai mund të rinovohet nëse, brenda 12 muajve para aplikimit për rinovim, mbajtësi i miratimit të STDI ka:

1) marrë trajnim rifreskues mbi aftësitë praktike udhëzuese dhe mbi praktikat operationale aktuale; dhe

2) kaluar me sukses një vlerësim të kompetencës së instruktorit praktik.

d) Në rastin e lëshimit të parë dhe rinovimit, periudha e vlefshmërisë së miratimit të STDI-së do të fillojë jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën vlerësimi është përfunduar me sukses.

SEKSIONI 2

VLERËSUESIT

ATCO.C.045 Privilegjet e vlerësuesit

a) Një person do të kryejë vlerësimet vetëm kur ai/ajo mban një miratim vlerësuesi.

b) Mbajtësit e një miratimi vlerësuesi autorizohen për të kryer vlerësimet:

1) gjatë trajnimit fillestar për lëshimin e një licence të student-kontrollorëve të trafikut ajror ose



për lëshimin e një kategorie të re dhe/ose miratim kategorie, nëse aplikohet;

2) e kompetencës së mëparshme, për qëllimet e pikave ATCO.B.001(d), ATCO.B.005(e) dhe ATCO.B.010(b);

3) e student-kontrollorëve të trafikut ajror për lëshimin e një miratimi të njësisë dhe miratimet e kategorisë, nëse aplikohet;

4) e kontrollorëve të trafikut ajror për lëshimin e një miratimi të njësisë dhe miratimet e kategorisë, nëse aplikohet, si dhe për rivlefshmërinë dhe rinovimin e miratimit të njësisë;

5) e aplikantit për instruktor praktik ose të aplikantit për vlerësues, kur sigurohet përputhshmëria me kërkesat e zbatueshme të pikave (d) (2) deri në (4).

c) Mbajtësit e një miratimi vlerësues do të ushtrojnë privilegjet e miratimit vetëm nëse ata kanë:

1) së paku 2 vjet eksperiencë në kategorinë dhe në miratimin e kategorisë që do të vlerësojnë; dhe

2) treguar njohuri të praktikave operacionale aktuale.

d) Përveç kërkesave të përcaktuara në shkronjën (c), mbajtësit e një miratimi për vlerësues do të ushtrojnë privilegjet e miratimit vetëm:

1) për vlerësimet që çojnë në lëshimin, rivlefshmërinë dhe rinovimin e një miratimi të njësisë, nëse ata mbajnë, gjithashtu, miratimin e njësisë të lidhur me vlerësimin për një periudhë të menjëhershme pararendëse prej së paku 1 viti;

2) për vlerësimin e kompetencës së një aplikanti për lëshimin ose rinovimin e një miratimi STDI, nëse ai ka një miratim STDI ose OJTI dhe ka ushtruar privilegjet e atij miratimi për të paktën 3 vjet;

3) për vlerësimin e kompetencës së një aplikanti për lëshimin ose rinovimin e një miratimi OJTI nëse ai ka një miratim OJTI dhe ka ushtruar privilegjet e atij miratimi për të paktën 3 vjet;

4) për vlerësimin e kompetencës së një aplikanti për lëshimin ose rinovimin e një miratimi për vlerësues, nëse ai ka ushtruar privilegjet e miratimit të vlerësuesit për të paktën 3 vjet.

e) Gjatë vlerësimit për qëllimin e lëshimit dhe rinovimit të miratimit të njësisë dhe për sigurimin e mbikëqyrjes në pozicionin operacional të punës, vlerësuesi do të mbajë, gjithashtu, një miratim OJTI, ose një OJTI që mban miratimin e vlefshëm të njësisë të lidhur me vlerësimin duhet të jetë prezent.

ATCO.C.050 Interesa personale

Vlerësuesit nuk duhet të kryejnë vlerësime sa herë që mund të preket objektiviteti i tyre.

ATCO.C.055 Aplikimi për miratimin e vlerësuesit

Aplikantët për lëshimin e një miratimi për vlerësues duhet të:

a) kenë ushtruar privilegjet e një licence të kontrollorëve të trafikut ajror për së paku 2 vjet; dhe

b) brenda 12 muajve para aplikimit të kenë përfunduar me sukses një kurs vlerësuesi, gjatë të cilit njohuritë dhe aftësitë e kërkuara mësohen, duke përdorur metoda teorike dhe praktike, dhe të jenë vlerësuar në mënyrë të përshtatshme.

ATCO.C.060 Vlefshmëria e miratimit të vlerësuesit:

a) Miratimi i vlerësuesit do të jetë i vlefshëm për një periudhë 3-vjeçare.

b) Miratimi i vlerësuesit mund të rivlerësohet, duke përfunduar me sukses trajnimin rifreskues mbi aftësitë e vlerësimit dhe mbi praktikatat aktuale operacionale gjatë periudhës së vlefshmërisë së tij.

c) Nëse miratimi i vlerësuesit ka skaduar, ai mund të rinovohet nëse, brenda 12 muajve para aplikimit për rinovim, mbajtësi i miratimit të vlerësuesit ka:

1) marrë trajnim rifreskues mbi aftësitë e vlerësimit dhe mbi praktikatat aktuale operative; dhe

2) kaluar me sukses një vlerësim të kompetencës së vlerësuesit.

d) Në rastin e lëshimit të parë dhe rinovimit, periudha e vlefshmërisë së miratimit të vlerësuesit do të fillojë jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën vlerësimi është përfunduar me sukses.

ATCO.C.065 Autorizimi i përkohshëm për vlerësuesin:

a) Kur kërkesa e parashikuar në ATCO.C.045(d)(1) nuk mund të përmbushet, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të autorizojë mbajtësit e një miratimi të vlerësuesit të lëshuar, në përputhje me ATCO.C.055, për të kryer vlerësimet e referuara në ATCO.C.045 (b)(3) dhe (4), për të mbuluar situatat të veçanta ose për të siguruar pavarësinë e vlerësimit, me kusht që kërkesat e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c” të jenë përmbushur.

b) Për qëllimin e mbulimit të situatave të veçanta mbajtësi i miratimit të vlerësuesit do të mbajë, gjithashtu, një miratim njësie me kategorinë përkatëse dhe nëse aplikohet, miratimin e kategorisë, të lidhur me vlerësimin për një periudhë të



menjëhershme paraprirëse prej së paku një viti. Autorizimi do të kufizohet për vlerësimet e nevojshme për të mbuluar situatat e veçanta dhe nuk do të tejkalojë një vit ose vlefshmërinë e miratimit të kategorisë së lëshuar, në përputhje me ATCO.C.055, cilado të ndodhë më shpejt.

c) Për qëllimin e sigurimit të pavarësisë së vlerësimit, për arsye të natyrës së përsëritur, mbajtësi i miratimit të vlerësuesit do të mbajë, gjithashtu, një miratim njësie me kategorinë përkatëse dhe, nëse aplikohet, një miratim kategorie, që lidhet me vlerësimin për një periudhë të menjëhershme paraprirëse, prej së paku një viti. Vlefshmëria e autorizimit do të përcaktohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil, por nuk duhet të tejkalojë vlefshmërinë e miratimit të vlerësuesit të lëshuar në përputhje me ATCO.C.055.

d) Për lëshimin e një autorizimi të përkohshëm për arsyet e referuara në shkronjat (b) dhe (c), Autoriteti i Aviacionit Civil mund të kërkojë një analizë të sigurisë në operim për t'u paraqitur nga ofruesi i shërbimit të lundrimit ajror.

NËNPJESA D TRAJNIMI I KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT AJROR

SEKSIONI I KËRKESAT E PËRGJITHSHME

ATCO.D.001 Objektivat e trajnimit të kontrollorit të trafikut ajror

Trajnimi i kontrollorit të trafikut ajror do të mbulojë tërësinë e kurseve teorike, ushtrimeve praktike, duke përfshirë simulimin, dhe trajnimin në vendin e punës të kërkuar, me qëllim për të fituar dhe ruajtur aftësitë për të ofruar shërbime të sigurt, të rregullta dhe të shpejta të trafikut ajror.

ATCO.D.005 Llojet e trajnimit të kontrollorëve të trafikut ajror

a) Trajnimi i kontrollorëve të trafikut ajror do të konsistojë në hapat e mëposhtëm:

1) trajnimi fillestar, që çon në lëshimin e një licence të student-kontrollorëve të trafikut ajror ose në lëshimin e një kategorie shtesë dhe, nëse aplikohet, miratim kategorie, që ofron:

- i. “trajnim bazik”: trajnimi teorik dhe praktik i hartuar për të dhënë njohuritë themelore dhe aftësitë praktike të lidhura me procedurat bazë operacionale;
- ii. “trajnimi i kategorisë”: trajnimi teorik dhe

praktik i hartuar për të dhënë njohuritë dhe aftësitë praktike të lidhura me një kategori specifike dhe, nëse aplikohet, me miratimin e kategorisë;

2) trajnimi i njësisë, që çon në lëshimin e një licence të kontrollorëve të trafikut ajror, lëshimin e një miratimi kategorie, vlefshmërinë e kategorive ose miratimeve të kategorive dhe/ose lëshimin ose rinovimin e një miratimi njësie; ai përfshin fazat e mëposhtme:

i. faza trajnuese tranzitore, e hartuar kryesisht për të dhënë njohuri dhe të kuptuarit e procedurave operacionale specifike për vendin dhe aspektet specifike të detyrës; dhe

ii. faza e trajnimit në vendin e punës, që është faza përfundimtare e trajnimit të njësisë gjatë së cilës rutinat dhe aftësitë e lidhura me punën të fituara integrohen në praktikë nën mbikëqyrjen e një instruktori të kualifikuar për trajnimin në vendin e punës, në një situatë trafiku të drejtpërdrejtë.

iii. përveç pikave (i) dhe (ii), për miratimet e njësisë që kërkojnë trajtimin e situatave komplekse dhe të dendura të trafikut, kërkohet një fazë para trajnimit në vendin e punës (pre-OJT) për të rritur rutinat dhe aftësitë e kategorisë të fituara më parë dhe për t'u përgatitur për situatat reale të trafikut që mund të ndeshen në atë njësi;

3) trajnimi i vazhdueshëm, i hartuar për të ruajtur vlefshmërinë e miratimeve të licencës, që konsiston në:

i. trajnimin rifreskues;

ii. trajnimin konvertues, kur është i nevojshëm.

b) Përveç llojeve të trajnimit të referuara në shkronjën (a), kontrollorët e trafikut ajror mund të ndërmarrin trajnimet e mëposhtme:

1) trajnimin praktik për instruktorë, që çon në lëshimin, rivlefshmërinë ose rinovimin e një miratimi OJT/ITVP ose STDI;

2) trajnimin për vlerësues, që çon në lëshimin, rivlefshmërinë ose rinovimin e një miratimi të vlerësuesit.

SEKSIONI 2 KËRKESAT E TRAJNIMIT FILLESTAR

ATCO.D.010 Përbërja e trajnimit fillestar

a) Trajnimi fillestar, i menduar për një aplikant për një licencë të student-kontrollorëve të trafikut ajror ose për lëshimin e një kategorie shtesë dhe, nëse aplikohet, miratimin e kategorisë, do të konsistojë në:



1) trajnimin bazik, që përfshin të gjitha subjektet, temat dhe nëntemat e përfshira në shtojcën 2 të aneksit I; dhe

2) trajnimin e kategorisë, që përfshin të gjitha subjektet, temat dhe nëntemat, prej së paku një prej pikave të mëposhtme:

i. Kategoria e Kontrollit të Aerodromit – ADC, e përcaktuar në shtojcën 3 të aneksit I;

ii. Kategoria e Kontrollit Procedural të Afrimit – APP, e përcaktuar në shtojcën 4 të aneksit I;

iii. Kategoria e Kontrollit Procedural të Hapsirës – ACP, e përcaktuar në shtojcën 5 të aneksit I;

iv. Kategoria e Kontrollit të Afrimit me Survejim – APS, e përcaktuar në shtojcën 6 të aneksit I;

v. Kategoria e Kontrollit të Hapësirës me Survejim – ACS, e përcaktuar në shtojcën 7 të aneksit I.

b) Trajnimi i menduar për një kategori shtesë do të konsistojë në subjektet, temat dhe nëntemat e aplikueshme, për së paku një prej kategorive të përcaktuara në shkronjën (a) (2).

c) Trajnimi i menduar për riaktivizimin e një kategorie pas një vlerësimi të mëparshëm jo të suksesshëm të kompetencës sipas ATCO.B.010(b) do të përshtatet sipas rezultatit të atij vlerësimi.

d) Trajnimi i menduar për një miratim kategorie do të konsistojë në subjekte, tema dhe nëntema të zhvilluara nga organizata e trajnimit dhe të miratuara si pjesë e kursit trajnues.

e) Trajnimi bazë dhe/ose i kategorisë mund të plotësohet me subjektet, temat dhe nëntemat, që janë shtesë ose specifike për Bllokun e Hapësirës Ajrore Funktionale (FAB) ose për mjedisin kombëtar.

ATCO.D.015 Plani i trajnimit fillestar

Një plan i trajnimit fillestar do të krijohet nga organizata trajnimit dhe do të miratohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Ai do të përmbajë së paku:

a) përbërjen e kursit të trajnimit fillestar të parashikuar sipas ATCO.D.010;

b) strukturën e trajnimit fillestar të parashikuar sipas ATCO.D.020(b);

c) procesin për kryerjen e kursit të trajnimit fillestar;

d) metodat e trajnimit;

e) kohëzgjatjen minimale dhe maksimale të kursit të trajnimit fillestar;

f) në lidhje me ATCO.D.010(b), procesin për përshtatjen e kurseve të trajnimit fillestar që të marrë

parasysh kursin bazik të trajnimit të përfunduar me sukses;

g) proceset për ekzaminimet dhe vlerësimet sipas ATCO.D.025 dhe ATCO.D.035, si dhe objektivat e performancës sipas ATCO.D.030 dhe ATCO.D.040;

h) kualifikimet, rolet dhe përgjegjësitë e personelit të trajnimit;

i) procesin për përfundimin më herët të trajnimit;

j) procesin e apelimit;

k) ruajtjen e rekordeve specifike për trajnimin fillestar;

l) procesin dhe arsyet për rishikimin dhe ndryshimin e planit fillestar të trajnimit dhe dorëzimin e tij pranë Autoritetit të Aviacionit Civil; rishikimi i planit të trajnimit fillestar do të bëhet së paku një herë në tre vjet.

ATCO.D.020 Kurset e trajnimit bazik dhe të kategorive:

a) Trajnimi bazik dhe i kategorive do të ofrohet si kurs i ndarë ose i integruar.

b) Kurset e trajnimit bazik dhe të kategorive ose një kurs i trajnimit fillestar të integruar do të zhvillohen dhe ofrohen nga organizatat trajnimit dhe miratohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

c) Kur trajnimi fillestar ofrohet si një kurs i integruar, duhet të bëhet një dallim i qartë ndërmjet ekzaminimeve dhe vlerësimeve, për:

1) trajnimin bazik; dhe

2) secilin trajnim të kategorisë.

d) Përfundimi me sukses i trajnimit fillestar ose i trajnimit të kategorisë për lëshimin e një kategorie shtesë do të tregohet nga një certifikatë e lëshuar nga organizata trajnimit.

e) Përfundimi me sukses i trajnimit bazik do të tregohet nga një certifikatë e lëshuar nga organizata trajnimit.

ATCO.D.025 Ekzaminimet dhe vlerësimet e trajnimit bazik:

a) Kurset e trajnimit bazik do të përfshijnë ekzaminimet teorike dhe vlerësimet praktike.

b) Kalimi me sukses i provimit/eve teorik/e do t'i jepet një aplikanti që ka arritur një minimum prej 75% të pikëve të caktuara për atë provim;

c) Vlerësimi/et i objektivave të performancës siç listohen në ATCO.D.030 do të kryhet nga një trajnues me detyrë të pjesshme me ose një simulator;

d) Kalimi me sukses i vlerësimit/eve do t'i jepet një aplikanti që tregon në mënyrë të vazhdueshme performancën e kërkuar, siç listohet në pikën



ATCO.D.030 dhe tregon sjelljen e kërkuar për ofrimin e sigurt të shërbimit të kontrollit të trafikut ajror.

ATCO.D.030 Objektivat e performancës së trajnimit bazik

Vlerësimi/et do të përfshijë vlerësimin e objektivave të mëposhtëm të performancës:

- a) kontrollin dhe përdorimin e pajisjeve të pozicionit të punës;
- b) zhvillimi dhe mbajtja në vëmendje e situatave të ndryshme duke monitoruar trafikun dhe duke identifikuar avionin, kur është e nevojshme;
- c) monitorimin dhe përditësimin e të dhënave të fluturimit;
- d) ruajtjen e të dëgjuarit të vazhdueshëm në frekuencën e përcaktuar;
- e) lëshimin e lejeve, udhëzimeve dhe informacioneve të përshtatshme të trafikut;
- f) përdorimin e frazeologjisë së miratuar;
- g) komunikimin në mënyrë efektive;
- h) zbatimin e ndarjes;
- i) zbatimin e koordinimit sipas nevojës;
- j) zbatimin e procedurave të përcaktuara për hapësirën ajrore të simuluar;
- k) zbulimin e konflikteve të mundshme midis avionëve;
- l) vlerësimin e prioritetit të veprimeve;
- m) zgjedhjen e metodave më të përshtatshme të ndarjes.

ATCO.D.035 Ekzaminimet dhe vlerësimi i trajnimit të kategorisë:

- a) Kurset e trajnimit të kategorisë do të përfshijnë ekzaminimet teorike dhe vlerësimet praktike.
- b) Kalimi në ekzaminimet teorike do t'i jepet një aplikanti që arrin një minimum prej 75% të atij ekzaminimi.
- c) Vlerësimi/et do të bazohet në objektivat e performancës së trajnimit të kategorisë të përshkruara në ATCO.D.040.
- d) Vlerësimi/et kryhet në një simulator.
- e) Kalimi me sukses i vlerësimit/eve do t'i jepet një aplikanti i cili demonstroi vazhdimisht performancën e kërkuar të përshkruar në pikën ATCO.D.040 dhe tregon sjelljen e përshtatshme për ofrimin e sigurt të shërbimit të kontrollit të trafikut ajror.

ATCO.D.040 Objektivat e performancës së trajnimit të kategorisë

a) Objektivat e performancës së trajnimit të kategorisë dhe detyrat e objektivave të performancës do të përcaktohen për secilin kurs të trajnimit të kategorive.

b) Objektivat e performancës së trajnimit të kategorisë do t'i kërkojnë aplikantit të:

1) tregojë aftësinë për të menaxhuar trafikun ajror në një mënyrë që garanton shërbime të sigurta, të rregullta dhe të shpejta; dhe

2) trajtojë situata komplekse dhe të dendura të trafikut.

c) Përveç shkronjës (b), objektivat e performancës së trajnimit të kategorisë për kategorinë e Kontrollit të Aerodromit (ADC) duhet të sigurojnë që aplikantët të:

1) menaxhojnë ngarkesën e punës dhe të ofrojnë shërbime të trafikut ajror brenda një zone të caktuar përgjegjësie të aerodromit; dhe

2) zbatojnë teknikat e kontrollit të aerodromit dhe procedurat operacionale për trafikun e aerodromit.

d) Përveç shkronjës (b), objektivat e performancës së trajnimit të kategorisë së Kontrollit Procedural të afrimit (APP) do të sigurojnë që aplikantët të:

1) menaxhojnë ngarkesën e punës dhe ofrojnë shërbime të trafikut ajror brenda një zone të përcaktuar të kontrollit të afrimit nën përgjegjësi; dhe

2) zbatojnë kontrollin procedural të afrimit, teknikat e planifikimit dhe procedurat operacionale për trafikun e mbërritjes, mbajtjes, nisjes dhe e trafikut tranzit.

e) Përveç shkronjës (b), objektivat e vlerësimit të performancës së trajnimit të kategorisë së Kontrollit të Afrimit me Survejim (APS) duhet të sigurojnë që aplikantët të:

1) menaxhojnë ngarkesën e punës dhe të ofrojnë shërbime të trafikut ajror brenda një zone të përcaktuar të kontrollit të afrimit nën përgjegjësi; dhe

2) zbatojnë kontrollin e mbikëqyrjes së afrimit, teknikat e planifikimit dhe procedurat operacionale për trafikun e mbërritjes, mbajtjes, nisjes dhe trafikut tranzit.

f) Përveç shkronjës (b), objektivat e vlerësimit të performancës së Kontrollit Procedural të Hapësirës (ACP) duhet të sigurojnë që aplikantët të:

1) menaxhojnë ngarkesën e punës dhe të ofrojnë shërbime të trafikut ajror brenda një hapësire të



përcaktuar të kontrollit të hapësirës nën përgjegjësi; dhe

2) zbatojnë kontrollin procedural të hapësirës, teknikat e planifikimit dhe procedurat operationale në trafikun e zonës.

g) Përveç shkronjës (b), objektivat e performancës së trajnimit të kategorisë së Kontrollit të Hapësirës me Survejim (ACS) duhet të sigurojnë që aplikantët të:

1) menaxhojnë ngarkesën e punës dhe të ofrojnë shërbime të trafikut ajror brenda një hapësire të përcaktuar të kontrollit të hapësirës nën përgjegjësi; dhe

2) zbatojnë kontrollin e mbikëqyrjes së hapësirës, teknikat e planifikimit dhe procedurat operative për trafikun e zonës.

SEKSIONI 3

KËRKESAT E TRAJNIMIT TË NJËSISË

ATCO.D.045 Përbërja e trajnimit të njësies

a) Trajnimi i njësies do të konsistojë në kurset e trajnimit për çdo miratim të njësies të krijuar në njësine ATC, siç përcaktohet në planin e trajnimit të njësies.

b) Kurset e miratimit të njësies do të zhvillohen dhe ofrohen nga organizata trajnimi, sipas ATCO.D.060 dhe miratohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

c) Trajnimi i njësies do të përfshijë trajnimin në:

- 1) procedurat operationale;
- 2) aspektet e specifikave të detyrës;
- 3) situatat jonormale dhe të emergjencës; dhe
- 4) faktorët njerëzorë.

ATCO.D.050 Parakushtet për trajnimin e njësies

Me kusht që të plotësohen kërkesat e përcaktuara në pikat ATCO.B.001(d), ATCO.B.005(e) dhe ATCO.B.010(b):

a) trajnimi i njësies mund të fillojë vetëm nga personat që kanë përfunduar me sukses trajnimin fillestar që lidhet me kategorinë dhe, nëse është e aplikueshme, miratimin e kategorisë;

b) faza e trajnimit në punë e trajnimit të njësies mund të fillojë vetëm nga personat që janë mbajtës një licence të student-kontrollorëve të trafikut ajror ose një licencë të kontrollorëve të trafikut ajror me kategorinë përkatëse dhe, nëse aplikohet, miratimin e kategorisë.

ATCO.D.055 Plani i trajnimit të njësies

a) Plani i trajnimit të njësies do të krijohet nga organizata e trajnimit për secilën njësi ATC dhe do të miratohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Plani i trajnimit të njësies do të përmbajë së paku:

- 1) kategoritë dhe miratimet për të cilat trajnimi kryhet;
- 2) strukturën e trajnimit të njësies;
- 3) listën e kurseve për miratimin e njësies sipas ATCO.D.060;
- 4) procesin për kryerjen e një kursi të miratimit të njësies;
- 5) metodat e trajnimit;
- 6) kohëzgjatjen minimale të kursit të miratimit të njësies;

7) procesin për përshtatjen e kurseve të miratimit të njësies duke marrë parasysh kategoritë, miratimet e kategorive dhe eksperiencën e aplikantëve, kur është e përshtatshme;

8) proceset për demonstrimin e njohurive teorike dhe të kuptuarit sipas ATCO.D.065, duke përfshirë numrin, frekuencën dhe llojin, si dhe notat e kalimit për ekzaminimet, që do të jenë një minimum prej 75% i notave që u janë caktuar këtyre ekzaminimeve;

9) proceset për vlerësimin sipas ATCO.D.070, duke përfshirë numrin dhe frekuencën e vlerësimeve;

10) kualifikimet, rolet dhe përgjegjësitë e personelit trajnues;

11) procesi për përfundimin më herët të trajnimit;

12) procesi i apelimit;

13) mbajtja e rekordeve specifike për trajnimin e njësies;

14) një listë e situatave jonormale dhe të emergjencës specifike për secilin miratim të njësies;

15) procesi dhe arsyet për rishikimin dhe ndryshimin e planit të trajnimit të njësies dhe dorëzimi i tij tek Autoriteti i Aviacionit Civil; rishikimi i planit të trajnimit të njësies do të bëhet së paku një herë në tre vjet.

ATCO.D.060 Kursi i miratimit të njësies

a) Kursi i miratimit të njësies do të jetë kombinimi i fazave përkatëse të trajnimit të njësies për lëshimin ose rinovimin e një miratimi njësie në licencë. Secili kurs do të përmbajë:

- 1) një fazë trajnimi tranzicionale;



2) një fazë trajnimi në vendin e punës;

Faza e paratrajnimit në vendin e punës (pre-OJT) do të përfshihet, nëse kërkohet, sipas ATCO.D.005(a)(2).

b) Fazat e trajnimit të njësive të referuara në paragrafin (a) do të ofrohen ndarazi ose në një mënyrë të integruar.

c) Kurset e trajnimit të njësive do të përcaktojnë planin dhe objektivat e performancës, në përputhje me ATCO.D.045(c) dhe do të kryhen në përputhje me planin e trajnimit të njësive.

d) Kurset e miratimit të njësive që përfshijnë trajnimin për miratimin e kategorisë sipas ATCO.B.015 do të plotësohen me trajnim shtesë, që lejon përfitimin e aftësive të lidhura me miratimin e kategorisë.

e) Trajnimi i menduar për një miratim kategorie do të konsistojë në subjektet, objektivat e subjektivit, temat dhe nëntemat e zhvilluara nga organizata e trajnimit dhe të miratuara si pjesë e kursit të trajnimit.

f) Kurset e miratimit të njësive të ndërmarra nga student-kontrollorët e trafikut ajror ose kontrollorët e trafikut ajror në një Shtet të BE-së për të cilin autoriteti kompetent është i ndryshëm nga ai që ka lëshuar licencën (AAC), do të përshtaten për të përfshirë elementet e trajnimit fillestar që janë specifike për Bllokun e Hapësirës Ajrore Funksionale (FAB) ose për mjedisin kombëtar. E njëjta kërkesë zbatohet për rastet kur aplikanti për licencën e studentit ka përfunduar trajnimin fillestar në një Shtet të BE-së dhe licenca do të lëshohet nga AAC-ja.

ATCO.D.065 Demonstrimi i njohurive teorike dhe të kuptuarit

Njohuritë teorike dhe të kuptuarit do të demonstrohen nga ekzaminimet.

ATCO.D.070 Vlerësimet gjatë kurseve të trajnimit të njësive

a) Vlerësimi i aplikantit do të kryhet në mjedisin operacional nën kushte normale operationale, së paku një herë në fund të trajnimit në vendin e punës.

b) Kur kursi i miratimit të njësive përmban një fazë para trajnimi në vendin e punës (pre-OJT), aftësitë e aplikantit do të vlerësohen në një pajisje trajnuese sintetike së paku në fund të kësaj faze.

c) Pavarësisht pikës (a), një pajisje trajnuese sintetike mund të përdoret gjatë një vlerësimi të miratimit të njësive për të treguar aplikimin e procedurave të trajnuara jo të ndeshura në mjedisin operacional gjatë vlerësimit.

SEKSIONI 4

KËRKESAT E TRAJNIMIT TË VAZHDUESHËM

ATCO.D.075 Trajnimi i vazhdueshëm

Trajnimi i vazhdueshëm do të konsistojë në kurset e trajnimit rifreskues sipas ATCO.D.005 dhe të konvertimit dhe do të ofrohet sipas kërkesave të përmbajtura në skemën e kompetencës së njësive sipas ATCO.B.025.

ATCO.D.080 Trajnimi rifreskues:

a) Kursi i trajnimit rifreskues do të zhvillohet dhe ofrohet nga organizatat e trajnimit dhe miratohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Trajnimi rifreskues do të hartohet për të rishikuar, për të përforcuar ose për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë ekzistuese të kontrollorëve të trafikut ajror për të ofruar një lëvizje të sigurt, të rregullt dhe të shpejtë të trafikut ajror dhe do të përmbajë, së paku:

1) trajnimin e praktikave dhe procedurave standarde, duke përdorur frazeologjinë e miratuar dhe komunikimin efektiv;

2) trajnimin e situatave jonormale dhe të emergjencës, duke përdorur frazeologjinë e miratuar dhe komunikimin efektiv; dhe

3) trajnimin e faktorëve njerëzorë.

c) Plani për kursin e trajnimit rifreskues do të përcaktohet dhe kur një subjekt përditëson aftësitë e kontrollorëve të trafikut ajror, do të zhvillohen, gjithashtu, objektivat e performancës.

ATCO.D.085 Trajnimi i konvertimit:

a) Kurset e trajnimit të konvertimit do të zhvillohen dhe do të ofrohen nga organizatat e trajnimit dhe miratohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Trajnimi i konvertimit do të hartohet për të ofruar njohuritë dhe aftësitë e përshtatshme, në lidhje me një ndryshim në mjedisin operacional dhe do të ofrohet nga organizatat e trajnimit, kur vlerësimi i sigurisë në operim (*safety assessment*) të ndryshimit arrin në përfundimin e nevojës për një trajnim të tillë.

c) Kurset e trajnimit të konvertimit do të përfshijnë përcaktimin e:

1) metodës së përshtatshme të trajnimit dhe kohëzgjatjen e kursit, duke marrë parasysh natyrën dhe masën e ndryshimit; dhe

2) metodat e ekzaminimit dhe/ose vlerësimit për trajnimin e konvertimit.



d) Trajnimi i konvertimit do të ofrohet para se kontrollorët e trafikut ajror të ushtrojnë privilegjet e licencës së tyre në mjedisin operacional të ndryshuar.

SEKSIONI 5 TRAJNIMI I INSTRUKTORËVE DHE I VLERËSUESVE

ATCO.D.090 Trajnimi i instruktorëve praktikë:

a) Trajnimi i instruktorëve praktikë do të zhvillohet dhe do të ofrohet nga organizatat e trajnimit dhe do të konsistojë në:

1) një kurs të teknikave praktike udhëzuese për OJTI/ITVP dhe/ose STDI, duke përfshirë edhe një vlerësim;

2) një kurs trajnimi rifreskues mbi aftësitë udhëzuese praktike;

3) një metodë për vlerësimin e kompetencës së instruktorëve praktikë.

b) Kurset e trajnimit dhe metodat e vlerësimit të referuara në shkronjën (a) do të miratohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

ATCO.D.095 Trajnimi i vlerësuesve:

a) Trajnimi i vlerësuesve do të zhvillohet dhe ofrohet nga organizatat e trajnimit dhe do të konsistojë në:

1) një kurs trajnimi të vlerësuesit, duke përfshirë edhe një vlerësim;

2) një trajnim rifreskues mbi aftësitë e vlerësimit;

3) një metodë për vlerësimin e kompetencës së vlerësuesve.

b) Kurset e trajnimit dhe metodat e vlerësimit të referuara në shkronjën (a) do të miratohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

SHTOJCA 1 E ANEKSIT I SHKALLA E VLERËSIMIT TË AFTËSISË GJUHËSORE – KËRKESAT PËR AFTËSINË GJUHËSORE

Shkalla e vlerësimit të aftësisë gjuhësore: nivelet ekspert, të zgjeruara dhe operationale

Niveli	Shqiptimi: përdor një dialekt dhe/ose theks të kuptueshëm për komunitetin aeronautik	Struktura gramatike relevante dhe modelet e fjalisë përcaktohen nga funksionet e gjuhës së përshtatshme për detyrën	Fjalori	Rrjedhshmëria	Të kuptuarit	Ndërveprimet
Ekspert 6	Shqiptimi, theksi, ritmi dhe intonacioni, edhe pse influencohen nga gjuha e parë ose ndryshimi rajonal, thuajse kurrë nuk ndërhyjnë në lehtësinë e të kuptuarit.	Strukturat gramatike bazë dhe komplekse dhe modelet e fjalisë kontrollohen mirë në mënyrë të vazhdueshme.	Gama dhe saktësia e fjalorit janë të mjaftueshme për të komunikuar në mënyrë efektive në një varietet të gjerë të temave të njohura dhe të panjohura. Fjalori është idiomatik, me nuancë dhe sensitiv për t'u regjistruar	I aftë për të folur gjatë me një rrjedhë natyrale, pa përpjekje. Rrjedhë të foluri e ndryshme për efektin stilistik, p.sh. për të theksuar një pikë. Përdor lidhëset dhe shënuesit e diskursit spontanisht	Të kuptuarit është në mënyrë të vazhdueshme i saktë në thuajse të gjitha kontekstet dhe përfshin të kuptuarit e hollësive linguistike dhe kulturore.	Ndërvepron me lehtësi në thuajse të gjitha situatat. Është sensitiv ndaj sugjerimeve verbale dhe joverbale dhe u përgjigjet atyre siç duhet.
I zgjeruar 5	Shqiptimi, theksi, ritmi dhe intonacioni, edhe pse	Strukturat gramatike bazë dhe modelet e fjalisë kontrollohen	Gama dhe saktësia e fjalorit janë të mjaftueshme për të	I aftë për të folur gjatë me një lehtësi relative mbi temat e njohura por nuk	Të kuptuarit është i saktë në tema të zakonshme, konkrete dhe	Përgjigjet janë të menjëhershme, të përshtatshme dhe informative. Menaxhon



	influencohen nga gjuha e parë ose ndryshimi rajonal, rrallë ndërhyjnë në lehtësinë e të kuptuarit.	mirë në mënyrë të vazhdueshme. Strukturat komplekse përpiqen por me gabime që ndonjëherë ndërhyjnë me kuptimin.	komunikuar në mënyrë efektive në tema të zakonshme, konkrete dhe të lidhura me punën. Parafrazimet në mënyrë të vazhdueshme dhe të suksesshme. Fjalori është ndonjëherë idiomatik.	varion rrjedha e të folurit si një pajisje stilistike. Mund të përdorë lidhëset dhe shënuesit e diskursit të përshtatshëm.	të lidhura me punën dhe më së shumti i saktë kur folësi konfrontohet me një komplikim gjuhësor ose situacional ose një ndërrim të papritur të ngjarjeve. Është i aftë të kuptojë një game të varieteteve të të folurit (dialekt dhe/ose theks) ose regjistra.	marrëdhënien folës/dëgjues në mënyrë efektive.
Operacional 4	Shqiptimi, theksi, ritmi dhe intonacioni, influencohen nga gjuha e parë ose ndryshimi rajonal, por vetëm ndonjëherë ndërhyjnë në lehtësinë e të kuptuarit.	Strukturat gramatike bazë dhe modelet e fjalisë përdoren në mënyrë kreative dhe zakonisht kontrollohen mirë. Gabime mund të ndodhin veçanërisht në rrethana të pazakonshme ose të papritura, por rrallë ndërhyjnë me kuptimin.	Gama dhe saktësia e fjalorit janë të mjaftueshme për të komunikuar në mënyrë efektive në tema të zakonshme, konkrete dhe të lidhura me punën. Mund të parafrazojë në mënyrë të suksesshme kur ka mungesë fjalori në rrethana të pazakonshme ose të papritura.	Prodhon tensione të gjuhës në një kohë të përshtatshme. Mund të ketë humbje të rastësishme të rrjedhshmërisë në kalimin nga i foluri i tregimit në formulim për ndërveprimin spontan, por kjo nuk parandalon (pengon) komunikimin efektiv. Mund të përdorë në mënyrë të kufizuar lidhëzat dhe treguesit e ligjërit. Plotësimet nuk përdoren.	Të kuptuarit është më së shumti i saktë në tema të zakonshme, konkrete dhe të lidhura me punën kur theksi ose varieteti është mjaftueshëm i kuptueshëm për një komunitet ndërkombëtar përdoruesish. Kur folësi konfrontohet me një komplikim gjuhësor ose situacional ose një ndërrim të papritur të ngjarjeve, të kuptuarit mund të jetë i ngadaltë ose kërkon strategji qartësimi.	Përgjigjet janë zakonisht të menjëhershme, të përshtatshme dhe informative. Fillon dhe mban shkëmbime edhe kur ka të bëjë me një ndërrim të ngjarjeve. Merret me saktësi me keqkuptimet e dukshme nëpërmjet kontrollit, konfirmimit ose qartësimit.



Shkalla e vlerësimit të aftësisë gjuhësore: nivelet paraoperacionale, elementare dhe paraelementare

Niveli	Shqiptimi: përdor një dialekt dhe/ose theks të kuptueshëm për komunitetin aeronautik	Struktura: struktura gramatike relevante dhe modelet e fjalisë përcaktohen nga funksionet e gjuhës së përshtatshme për detyrën	Fjalori	Rrjedhshmëria	Të kuptuarit	Ndërveprimet
Para-operacional 3	Shqiptimi, theksi, ritmi dhe intonacioni, influencohen nga gjuha e parë ose ndryshimi rajonal, dhe ndërhyjnë shpesh në lehtësinë e të kuptuarit.	Strukturat gramatike bazë dhe komplekse dhe modelet e fjalisë të lidhura me situatat e paparashikuara nuk kontrollohen gjithmonë mirë. Gabimet shpesh ndërhyjnë me të kuptuarit.	Gama dhe saktësia e fjalorit janë shpesh të mjaftueshme për të komunikuar mbi tema të zakonshme, konkrete dhe të lidhura me punën, por gama është e kufizuar dhe zgjedhja e fjalës shpesh e papërshtatshme. Shpesh nuk është në gjendje të parafranojë me sukses kur mungon fjalori.	Prodhon tensione gjuhe, por frazimi dhe pushimi janë shpesh të papërshtatshëm. Hezitimet ose ngadalësitë në përpunimin e gjuhës mund të ndalojnë komunikimin efektiv. Plotësimet shpeshherë tërheqin vëmendjen.	Të kuptuarit është shpesh i saktë në temat e zakonshme, konkrete dhe të lidhura me punën, kur theksi ose varieteti i përdorur është mjaftueshëm i kuptueshëm për një komunitet ndërkombëtar përdoruesish. Mund të dështojë së kuptuari një komplikim gjuhësor ose situacional ose për një ndërrim të papritur të ngjarjeve.	Përgjigjet janë zakonisht të menjëhershme, të përshtatshme dhe informative. Mund të fillojë dhe mbajë shkëmbime me lehtësi të arsyeshme mbi temat e njohura dhe në situatat e parashikueshme. Përgjithësisht i paaftë kur merret me një ndërrim të papritur të ngjarjeve.
Elementare 2	Shqiptimi, theksi, ritmi dhe intonacioni, influencohen shumë nga gjuha e parë ose ndryshimi rajonal, dhe zakonisht ndërhyjnë në lehtësinë e të kuptuarit.	Tregon vetëm kontroll të kufizuar të pak strukturave të memorizuara gramatikore dhe modeleve të fjalisë.	Gamë e kufizuar, fjalori që konsiston vetëm në fjalë të izoluara dhe fraza të memorizuara.	Mund të prodhojë thënie shumë të shkurtra, të izoluara, të memorizuara me pushim të shpeshtë dhe një përdorim të plotësuesve, që tërheqin vëmendjen për të kërkuar për shprehje dhe për të artikuluar më pak fjalë të njohura.	Të kuptuarit është i kufizuar për frazat e izoluara, të memorizuara kur artikulohen me kujdes dhe ngadalë.	Koha e përgjigjes është e ngadaltë dhe shpesh e papërshtatshme. Ndërveprimi është i kufizuar për shkëmbimet e thjeshta rutinë.
Para-elementare 1	Performon në një nivel poshtë nivelit elementar.	Performon në një nivel poshtë nivelit elementar.	Performon në një nivel poshtë nivelit elementar.	Performon në një nivel poshtë nivelit elementar.	Performon në një nivel poshtë nivelit elementar.	Performon në një nivel poshtë nivelit elementar.



SHTOJCA 2 E ANEKSIT I TRAJNIMI BAZIK

(Referenca: aneksi I (pjesa ATCO), nënpjesa D, seksioni 2, pika ATCO.D.010(a)(1))

TABELA E PËRMBAJTJES

SUBJEKTI 1: Hyrje në kurs

SUBJEKTI 2: Ligji i aviacionit

SUBJEKTI 3: Menaxhimi i trafikut ajror

SUBJEKTI 4: Meteorologjia

SUBJEKTI 5: Lundrimi

SUBJEKTI 6: Avioni

SUBJEKTI 7: Faktorët njerëzorë

SUBJEKTI 8: Pajisjet dhe sistemet

SUBJEKTI 9: Mjedisi profesional

SUBJEKTI 1: Hyrje në kurs

TEMA INTRB 1 – MENAXHIMI I KURSIT

Nëntema INTRB 1.1 – Hyrje në kurs

Nëntema INTRB 1.2 – Administrimi i kursit

Nëntema INTRB 1.3 – Materiale të studimit dhe dokumentacioni i trajnimit

TEMA INTRB 2 – HYRJE NË KURSIN E TRAJNIMIT ATC

Nëntema INTRB 2.1 – Përmbajtja, metodologjia dhe organizimi i kursit

Nëntema INTRB 2.2 – Karakteri i trajnimit

Nëntema INTRB 2.3 – Procesi i vlerësimit

TEMA INTRB 3 – HYRJE NË TË ARDHMEN E ATCO-s

Nëntema INTRB 3.1 – Perspektivat e punës

SUBJEKTI 2: LIGJI I AVIACIONIT

TEMA LAWB 1 – HYRJE NË LIGJIN E AVIACIONIT

Nëntema LAWB 1.1 – Rëndësia e ligjit të aviacionit

TEMA LAWB 2 – ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Nëntema LAWB 2.1 – ICAO

Nëntema LAWB 2.2 – Agjencitë evropiane dhe të tjera

Nëntema LAWB 2.3 – Shoqatat e aviacionit

TEMA LAWB 3 – ORGANIZATAT KOMBËTARE

Nëntema LAWB 3.1 – Autoritetet kombëtare

Nëntema LAWB 3.2 – Procedurat legjislative kombëtare

Nëntema LAWB 3.3 – Autoriteti kompetent

Nëntema LAWB 3.4 – Shoqatat kombëtare të aviacionit

TEMA LAWB 4 – MENAXHIMI I SIGURISË NË OPERIM NË ATS

Nëntema LAWB 4.1 – Rregullorja e Sigurisë në Operim

Nëntema LAWB 4.2 – Sistemi i menaxhimit të Sigurisë në Operim

TEMA LAWB 5 – RREGULLAT DHE RREGULLORET

Nëntema LAWB 5.1 – Njësitë e matjes

Nëntema LAWB 5.2 – Licencimi/certifikimi ATCO

Nëntema LAWB 5.3 – Pamje e përgjithshme e ANS-së

Nëntema LAWB 5.4 – Pamje e përgjithshme e ATS-së

Nëntema LAWB 5.5 – Pamje e përgjithshme e menaxhimit të informacionit aeronautik (AIM)

Nëntema LAWB 5.6 – Rregullat e ajrit

Nëntema LAWB 5.7 – Hapësira ajrore dhe rrugët ATS

Nëntema LAWB 5.8 – Plani i fluturimit

Nëntema LAWB 5.9 – Aerodromet

Nëntema LAWB 5.10 – Procedurat e mbajtjes (Holding) për fluturimet IFR

Nëntema LAWB 5.11 – Procedurat e mbajtjes (Holding) për fluturimet VFR

SUBJEKTI 3: MENAXHIMI I TRAFIKUT AJROR

TEMA ATMB 1 – MENAXHIMI I TRAFIKUT AJROR

Nëntema ATMB 1.1 – Aplikimi i njësive të matjes

Nëntema ATMB 1.2 – Shërbimi i kontrollit të trafikut ajror (ATC)

Nëntema ATMB 1.3 – Shërbimi i informacionit të fluturimit (FIS)

Nëntema ATMB 1.4 – Shërbimet paralajmëruese

Nëntema ATMB 1.5 – Shërbimi këshillues i trafikut ajror

Nëntema ATMB 1.6 – Kapaciteti i sistemeve ATS dhe menaxhimi i rrjedhës së trafikut ajror

Nëntema ATMB 1.7 – Menaxhimi i hapësirës ajrore (ASM)

TEMA ATMB 2 – ALTIMETRI DHE CAKTIMI I NIVELIT

Nëntema ATMB 2.1 – Altimetri

Nëntema ATMB 2.2 – Niveli tranzitor

Nëntema ATMB 2.3 – Caktimi i nivelit

TEMA ATMB 3 – RADIOTELEFONIA (RTF)



Nëntema ATMB 3.1 – Procedurat e operimit të përgjithshëm RTF

TEMA ATMB 4 – LEJET DHE INSTRUKSIONET ATC

Nëntema ATMB 4.1 – Lloji dhe përmbajtja e lejeve ATC

Nëntema ATMB 4.2 – Instruksionet ATC

TEMA ATMB 5 – KOORDINIMI

Nëntema ATMB 5.1 – Parimet, llojet dhe përmbajtja e koordinimit

Nëntema ATMB 5.2 – Nevoja për koordinim

Nëntema ATMB 5.3 – Mjetet e koordinimit

TEMA ATMB 6 – SHFAQJA E TË DHËNAVE

Nëntema ATMB 6.1 – Nxjerrja e të dhënave

Nëntema ATMB 6.2 – Menaxhimi i të dhënave

TEMA ATMB 7 – NDARJET

Nëntema ATMB 7.1 – Ndarja vertikale dhe procedurat

Nëntema ATMB 7.2 – Ndarja horizontale dhe procedurat

Nëntema ATMB 7.3 – Ndarja vizuale

Nëntema ATMB 7.4 – Ndarja në aerodrom dhe procedurat

Nëntema ATMB 7.5 – Ndarja e bazuar në sistemet e mbikëqyrjes ATS

Nëntema ATMB 7.6 – Ndarja e turbulencës

TEMA ATMB 8 – RRJETET E SIGURISË TË BAZUARA NË TOKË DHE NË FLUTURIM

Nëntema ATMB 8.1 – Rrjetet e sigurisë në fluturim

b) Personeli i autorizuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për të kryer detyra të certifikimit ose të mbikëqyrjes, ose të dyja, do të autorizohet për të kryer të paktën detyrat e mëposhtme:

1) të ekzaminojë dokumentet, duke përfshirë licencat, certifikatat, regjistrimet, të dhënat, procedurat dhe çdo material tjetër që lidhet me ekzekutimin e detyrës së kërkuar;

2) të marrë kopje ose ekstrakte nga këto regjistrime, të dhëna, procedura dhe materiale të tjera;

3) të kërkojë shpjegim;

4) të hyjë në ambientet përkatëse dhe vendet e operimit;

5) të kryejë auditimet dhe inspektimet, duke përfshirë inspektimet pa njoftim paraprak;

6) të marrë ose fillojë masat shtrënguese përkatëse sipas rastit.

ATCO.AR.A.010 Detyrat e Autoritetit të Aviacionit Civil:

Detyrat e Autoritetit të Aviacionit Civil duhet të përfshijnë:

a) lëshimin, pezullimin dhe revokimin e licencave, kategorive, miratimeve dhe certifikatave mjekësore;

b) lëshimin e autorizimeve të përkohshme OJTI sipas pikës ATCO.C.025;

c) lëshimin e autorizimeve të përkohshme të vlerësuesit sipas pikës ATCO.C.065;

d) rivlefshmërinë dhe rinovimin e miratimeve;

e) rivlerësimin, rinovimin dhe kufizimin e certifikatave mjekësore pas referimit nga ekzaminuesi aeromjekësor (AME) ose qendra aeromjekësore (AeMC);

f) lëshimin, rivlefshmërinë, rinovimin, pezullimin, revokimin, kufizimin dhe ndryshimin e certifikatave të ekzaminuesit aeromjekësor;

g) lëshimin, pezullimin, revokimin dhe kufizimin e certifikatave të organizatave të trajnimit dhe të certifikatave të qendrave aeromjekësore;

h) miratimin e kurseve të trajnimit, planeve të trajnimit dhe skemave të kompetencës së njësishë, si dhe metodave të vlerësimit;

i) miratimin e metodës së vlerësimit për demonstrimin e aftësive gjuhësore dhe vendosjen e kërkesave të zbatueshme për organet e vlerësimit të gjuhësor sipas pikës ATCO.B.040;

j) miratimin e nevojës për aftësi gjuhësore me nivel të zgjeruar (niveli pesë) në përputhje me pikën ATCO.B.030(d);

k) mbikëqyrjen e organizatave trajnuese, duke përfshirë kurset dhe planet e tyre të trajnimit;

l) miratimin dhe monitorimin e skemave të kompetencës së njësishë;

m) krijimin e procedurave të përshtatshme apeluese dhe mekanizmave të njoftimit;

n) fasilitimin e njohjes dhe shkëmbimit të licencave, duke përfshirë transferimin e rekordeve të kontrollorëve të trafikut ajror dhe kthimin e licencës së vjetër tek Autoriteti i Aviacionit Civil që e ka lëshuar sipas pikës ATCO.AR.D.003;

o) fasilitimin e njohjes së certifikatave të organizatës trajnuese dhe aprovimet e kurseve, si dhe miratimin e metodës së vlerësimit për demonstrimin e aftësisë gjuhësore.

ATCO.AR.A.015 Mjetet e përputhshmërisë

a) Autoriteti i Aviacionit Civil pranon Mjetet e Pranueshme të Përputhshmërisë ("AMC"), që mund të përdoren për të vendosur përputhshmërinë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Autoriteti i Aviacionit Civil mund të pranojë dhe publikojë për përdorim Mjetet e Pranueshme të Përputhshmërisë ("AMC"), të zhvilluara nga Agjencia për të vendosur përputhshmërinë me Rregulloren (BE) 2018/1139



të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe aktet e saj të deleguara dhe zbatuese.

b) Mjetet alternative të përputhshmërisë mund të përdoren për të vendosur përputhshmërinë me aktet e deleguara dhe zbatuese.

c) Kur është e zbatueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil do të informojë Agjencinë për çdo mjet alternativ përputhshmërie të përdorur nga organizatat nën mbikëqyrjen e tij ose nga vetë ata për të përcaktuar përputhshmërinë me këtë Rregullore.

ATCO.AR.A.020 Informacionet për Agjencinë

a) Sipas rastit, kur është e zbatueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil do të njoftojë Agjencinë në rast të çdo problemi të rëndësishëm që lidhet me zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij brenda 30 ditëve nga koha kur Autoriteti i Aviacionit Civil është vënë në dijeni për problemet.

b) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, kur të jetë e zbatueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil do t'i sigurojë Agjencisë të gjitha informacionet e rëndësishme mbi sigurinë në operim që rrjedhin nga raportet e ngjarjeve të ruajtura në bazën e të dhënave të tij kombëtare në përputhje me nenin 6(6) të urdhrin të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, sa më shpejt të jetë e mundur.

c) Kur të jetë e zbatueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil do t'i ofrojë Agjencisë sa më shpejt të jetë e mundur informacione të rëndësishme për sigurinë që rrjedhin nga raportet e sigurisë së informacionit që ai ka marrë në përputhje me pikën IS.I.OR.230 të aneksit II (pjesa-IS.I.OR) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2023/203 e datës 27 tetor 2022 që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit për organizatat e mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 1321/2014, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 1178/2011, (BE) 2015/340,

Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664, dhe për autoritetet kompetente të mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 748/2012, (BE) nr. 1321/2014, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 1178/2011, (BE) 2015/340 dhe (BE) Nr. 139/2014, Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664 dhe që ndryshojnë Rregulloret e Komisionit (BE) Nr. 1178/2011, (BE) Nr. 748/2012, (BE) Nr. 965/2012, (BE) Nr. 139/2014, (BE) Nr. 1321/2014, (BE) 2015/340, dhe Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664.

ATCO.AR.A.025 Reagimi i menjëhershëm mbi një problem të sigurisë në operim

a) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, Autoriteti i Aviacionit Civil do të zbatojë një sistem për të mbledhur, analizuar dhe përhapur në mënyrë të përshtatshme informacionet e sigurisë në operim.

b) Agjencia, zbaton një sistem për të analizuar siç duhet çdo informacion mbi sigurinë në operim të rëndësishëm të marrë dhe pa asnjë vonesë të papërshtatshme t'i sigurojë Shteteve Anëtare dhe Komisionit çdo informacion, duke përfshirë rekomandimet ose veprimet korrigjuese të nevojshme për t'u marrë nga ato me qëllim që të reagojnë në kohë për një problem të sigurisë në operim që përfshin produkte, pjesë, pajisje, persona ose organizata që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2018/1139 dhe akteve të deleguara të saj zbatuese.

c) Pas marrjes së informacioneve të referuara në shkronjat (a) dhe (b), Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masat e përshtatshme për të adresuar problemin e sigurisë në operim.

d) Masat e marra në përputhje me shkronjën (c) do t'u njoftohen menjëherë të gjithë personave ose organizatave që duhet t'i respektojnë ato sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Autoriteti i Aviacionit Civil do t'ia njoftojë, gjithashtu, këto masa, kur të jetë e zbatueshme Agjencisë dhe, kur kërkohet veprim i kombinuar, shteteve të tjera anëtare të interesuara.

ATCO.AR.A.025A Reagimi i menjëhershëm ndaj një incidenti ose cënueshmërie të sigurisë së informacionit me ndikim në sigurinë në operim.



a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të zbatojë një sistem për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e duhur të informacionit në lidhje me incidentet dhe cenueshmëritë e sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim që raportohen nga organizatat. Kjo do të bëhet në koordinim me çdo autoritet tjetër përkatës përgjegjës për sigurinë e informacionit ose sigurinë kibernetike brenda vendit për të rritur koordinimin dhe përputhshmërinë e skemave të raportimit.

b) Agjencia zbaton një sistem për të analizuar në mënyrë të përshtatshme çdo informacion të rëndësishëm për sigurinë, të marrë në përputhje me pikën ATCO.ARA.020, dhe pa vonesë të panevojshme u siguron Shteteve Anëtare dhe Komisionit çdo informacion, duke përfshirë rekomandimet ose veprimet korrigjuese që duhen ndërmarrë, të nevojshme që ata të reagojnë në kohën e duhur ndaj një incidenti të sigurisë së informacionit ose cenueshmërisë me një ndikim të mundshëm në produkte, pjesë apo pajisje të pa instaluar, subjekte ose organizata që i nënshtrohen Rregullores (BE) 2018/1139 dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të tij.

c) Me marrjen e informacionit të përmendur në shkronjat (a) dhe (b), Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masat e duhura për të adresuar ndikimin e mundshëm në sigurinë në operim të incidentit ose cenueshmërisë së sigurisë së informacionit.

d) Masat e marra në përputhje me shkronjën (c) do t'u njoftohen menjëherë të gjithë personave ose organizatave që duhet t'i respektojnë ato sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Kur të jetë e zbatueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil do t'i njoftojë gjithashtu këto masa Agjencisë dhe, kur kërkohet veprim i kombinuar, autoriteteve kompetente të Shteteve të tjera të interesuara.

NËNPJESA B MENAXHIMI

ATCO.AR.B.001 Sistemi i menaxhimit

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të krijojë dhe mirëmbajë një sistem menaxhimi, duke përfshirë të paktën:

1) politikat dhe procedurat e dokumentuara për të përshkruar organizimin, mjetet dhe metodat e tij

për të arritur përputhshmërinë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Procedurat do të përditësohen dhe do të shërbejnë si dokumente bazë pune në Autoritetin e Aviacionit Civil për të gjitha detyrat përkatëse;

2) një numër të mjaftueshëm personeli, duke përfshirë inspektorët e licencimit dhe certifikimit, për të kryer detyrat e tij dhe për të përmbushur përgjegjësitë e tij. Ky personel do të jetë i kualifikuar për të kryer detyrat e caktuara dhe të ketë njohuritë e nevojshme, eksperiencën, trajnimin fillestar, në vendin e punës dhe të vazhdueshëm për të siguruar kompetencën e vazhdueshme. Do të krijohet një sistem për të planifikuar disponueshmërinë e personelit, me qëllim për të siguruar përfundimin e duhur të të gjitha detyrave përkatëse;

3) facilitete të përshtatshme dhe akomodim zyre për të kryer detyrat e caktuara;

4) një funksion për të monitoruar përputhshmërinë e sistemit të menaxhimit me kërkesat përkatëse dhe përshtatshmërinë e procedurave, duke përfshirë krijimin e një procesi të auditit të brendshëm dhe një procesi të menaxhimit të riskut për sigurinë në operim. Monitorimi i përputhshmërisë do të përfshijë një sistem për mbledhje informacioni të gjetjeve të auditit që ka lidhje me menaxhimin e lartë të Autoritetit të Aviacionit Civil për të siguruar zbatimin e veprimeve korrigjuese sipas nevojës; dhe

5) një person ose grup personash përgjegjës për menaxhimin e lartë të Autoritetit të Aviacionit Civil për funksionin e monitorimit të përputhshmërisë.

b) Autoriteti i Aviacionit Civil, për secilën fushë të aktivitetit të përfshirë në sistemin e menaxhimit, do të caktojë një ose më shumë persona me përgjegjësi të përgjithshme për menaxhimin e detyrave përkatëse.

c) Autoriteti i Aviacionit Civil, do të krijojë procedura për pjesëmarrjen në shkëmbimin e të gjitha informacioneve të nevojshme dhe asistencën me autoritetet e tjera kompetente të interesuara, qoftë nga brenda Shtetit apo me Shtetet e tjera, duke përfshirë shkëmbimin e mëposhtëm të informacionit mbi:

1) gjetjet përkatëse të ngritura dhe veprimet vijuese të marra si rezultat i mbikëqyrjes së personave dhe organizatave që ushtrojnë aktivitete



në territorin e Republikës së Shqipërisë, por të certifikuar nga autoriteti kompetent i një Shteti tjetër ose Agjencia, kur të jetë e zbatueshme; dhe

2) informacionin që rrjedh nga raportimi i detyrueshëm dhe vullnetar i ngjarjeve siç kërkohet nga pika ATCO.OR.B.040.

d) Një kopje e procedurave të lidhura me sistemin e menaxhimit dhe ndryshimet e tjera do t'i vihen në dispozicion Agjencisë për qëllim standardizimi.

e) Përveç kërkesave të përfshira në shkronjën (a), sistemi i menaxhimit i krijuar dhe i mirëmbajtur nga Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të jetë në përputhje me aneksin I (pjesa-IS.AR) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2023/203 e datës 27 tetor 2022 që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit për organizatat e mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 1321/2014, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 1178/2011, (BE) 2015/340, Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664, dhe për autoritetet kompetente të mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 748/2012, (BE) nr. 1321/2014, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 1178/2011, (BE) 2015/340 dhe (BE) Nr. 139/2014, Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664 dhe që ndryshojnë Rregulloret e Komisionit (BE) Nr. 1178/2011, (BE) Nr. 748/2012, (BE) Nr. 965/2012, (BE) Nr. 139/2014, (BE) Nr. 1321/2014, (BE) 2015/340, dhe Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664 për të siguruar menaxhimin e duhur të rreziqeve të sigurisë së informacionit që mund të kenë ndikim në sigurinë në operim.

ATCO.AR.B.005 Ndarja e detyrave

a) Nëse Autoriteti i Aviacionit Civil cakton detyra në lidhje me certifikimin fillestar ose mbikëqyrjen e vazhdueshme të personave ose organizatave që i nënshtrohen vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ato do t'u caktohen vetëm entiteteve të kualifikuara. Kur cakton detyrat, autoriteti kompetent do të sigurojë që ai:

1) ka një sistem për të vlerësuar fillimisht dhe në mënyrë të vazhdueshme që entiteti i kualifikuar pajtohet me aneksin VI të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar.

Ky sistem dhe rezultatet e vlerësimeve do të dokumentohen;

2) ka krijuar një marrëveshje të dokumentuar me një entitet të kualifikuar, të miratuar nga të dyja palët në nivelin e përshtatshëm të menaxhimit, që përcakton qartësisht:

i. detyrat që do të kryhen;

ii. deklaratat, raportet dhe rekordet që nevojiten;

iii. kushtet teknike për t'u përmbushur në kryerjen e detyrave të tilla;

iv. mbulimin e përgjegjësisë përkatëse; dhe

v. mbrojtjen që i jepet informacionit të marrë gjatë kryerjes së këtyre detyrave.

b) Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë që procesi i auditit të brendshëm dhe një proces i menaxhimit të riskut të sigurisë në operim, i kërkuar nga ATCO.AR.B.001(a)(4) mbulojnë të gjitha detyrat e certifikimit ose mbikëqyrjes të kryera në emër të tij.

c) Në lidhje me certifikimin dhe mbikëqyrjen e përputhshmërisë së organizatës me pikën ATCO.OR.C.001A, Autoriteti i Aviacionit Civil mund t'i ndajë detyra subjekteve të kualifikuara në përputhje me shkronjën (a), ose çdo autoriteti përkatës përgjegjës për sigurinë e informacionit ose sigurinë kibernetike brenda Republikës së Shqipërisë. Gjatë ndarjes së detyrave, autoriteti kompetent siguron që:

1) të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë e aviacionit koordinohen dhe merren parasysh nga subjekti i kualifikuar ose autoriteti përkatës;

2) rezultatet e aktiviteteve të certifikimit dhe mbikëqyrjes të kryera nga subjekti i kualifikuar ose autoriteti përkatës janë integruar në dosjet e përgjithshme të certifikimit dhe mbikëqyrjes të organizatës;

3) sistemi i tij i menaxhimit të sigurisë së informacionit i krijuar në përputhje me pikën ATCO.AR.B.001(e) mbulon të gjitha detyrat e certifikimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të kryera në emër të tij.



ATCO.AR.B.010 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të ketë një sistem për të identifikuar ndryshimet që ndikojnë në kapacitetin e tij për të kryer detyrat dhe për të përmbushur përgjegjësitë e tij siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Ky sistem duhet t'i mundësojë autoritetit të ndërmarrë veprimet e nevojshme, sipas rastit, për të siguruar që sistemi i menaxhimit të mbetet i përshtatshëm dhe efektiv.

b) Autoriteti i Aviacionit Civil do të përditësojë sistemin e tij të menaxhimit për të reflektuar në kohë çdo ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, me qëllim për të garantuar zbatimin sa më efektiv të sistemit të tij të menaxhimit.

c) Autoriteti i Aviacionit Civil, kur të jetë e zbatueshme, do të njoftojë Agjencinë për ndryshimet që prekin aftësinë e tij për të kryer detyrat dhe përmbushur përgjegjësitë e tij siç përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

ATCO.AR.B.015 Ruajtja e të dhënave

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të mbajë një listë të të gjitha certifikatave të organizatës dhe licencave dhe certifikatave të personelit që ai lëshon.

b) Autoriteti i Aviacionit Civil do të krijojë një sistem të mbajtjes së të dhënave duke siguruar ruajtjen e duhur, aksesueshmërinë dhe gjurmueshmërinë e besueshme të:

1) politikave dhe procedurave të dokumentuara të sistemit të menaxhimit;

2) trajnimit, kualifikimit dhe autorizimit të personelit të tij;

3) caktimit të detyrave, që mbulojnë elementet e kërkuara nga pika ATCO.AR.B.005, si dhe detajet e detyrave të caktuara;

4) proceseve të certifikimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të organizatave të certifikuara;

5) detajeve të kurseve të ofruara nga organizatat trajnuese;

6) proceseve për lëshimin e licencave, kategorive, miratimeve dhe certifikatave, dhe të mbikëqyrjes së

vazhdueshme të mbajtësve të këtyre licencave, vlerësimeve, miratimeve dhe certifikatave;

7) mbikëqyrjes së vazhdueshme të personave dhe organizatave që ushtrojnë aktivitete brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por të certifikuar nga autoriteti kompetent i një Shteti tjetër, siç është rënë dakord ndërmjet këtyre autoriteteve;

8) gjetjeve, veprimeve korrigjuese dhe datës së mbylljes së veprimi;

9) masave shtrënguese që janë marrë;

10) informacioneve mbi sigurinë në operim dhe masave që janë marrë;

11) përdorimit të dispozitave të fleksibilitetit në përputhje me nenin 71 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar; dhe

12) vlerësimit dhe njoftimit për Agjencinë të mjeteve alternative të përputhshmërisë të propozuara nga organizatat dhe vlerësimit të mjeteve alternative të përputhshmërisë të përdorura nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

c) Rekordet do të mbahen për një periudhë minimale prej 5 vjetësh dhe në lidhje me licencat e personelit për një periudhë minimale prej 10 vjetësh pas skadimit të miratimit të fundit mbi licencë, që i nënshtrohet ligjit në fuqi të mbrojtjes së të dhënave.

NËNPJESA C MBIKËQYRJA DHE MASAT SHTRËNGUESE

ATCO.AR.C.001 Mbikëqyrja

a) Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të verifikojë:

1) përputhshmërinë me kërkesat e zbatueshme për organizatat ose personat para lëshimit të një certifikatë të organizatës ose licencë të personelit, certifikatë, kategorie ose miratimi, sipas aplikimit;

2) përputhshmërinë e vazhdueshme me kërkesat e zbatueshme dhe kushtet që i bashkëngjiten certifikatës së organizatës trajnuese, si dhe kërkesat e zbatueshme për kurset e trajnimit, planet dhe skemat e kompetencës së njësisë që ai ka miratuar, dhe kërkesat e zbatueshme për personelin;

3) zbatimin e masave të përshtatshme të sigurisë në operim të autorizuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil siç përcaktohet në pikën ATCO.AR.A.025 (c) dhe (d).

b) Ky verifikim:

1) do të mbështetet nga dokumentacioni për të



ofruar udhëzim për personelin përgjegjës për mbikëqyrjen sigurisë në operim, me qëllim kryerjen e funksionit të tyre;

2) do të tregojë personat dhe organizatat e interesuara që lidhen me rezultatet e aktivitetit të mbikëqyrjes së sigurisë në operim;

3) do të bazohet në audite dhe inspektime, duke përfshirë, sipas rastit, inspektimet pa njoftime paraprake; dhe

4) do të sigurojë për Autoritetin e Aviacionit Civil provat e nevojshme në rast se kërkohet ndonjë veprim i mëtijshëm, duke përfshirë masat e parashikuara në ATCO.AR.C.010 dhe ATCO.AR.E.015.

c) Qëllimi i mbikëqyrjes do të përcaktohet mbi bazën e qëllimit dhe rezultateve të aktiviteteve të kaluara të mbikëqyrjes dhe prioritetet e sigurisë në operim.

d) Pa cenuar kompetencat e shteteve të tjera, qëllimi dhe rezultatet e mbikëqyrjes së aktiviteteve të kryera në territorin e një vendi tjetër nga persona ose organizata të krijuara ose me banim në një vend tjetër do të përcaktohen mbi bazën e prioriteteve të sigurisë në operim, si dhe aktivitetet e kaluara të mbikëqyrjes.

e) Kur aktiviteti i një personi ose organizate përfshin më shumë se një shtet, Autoriteti i Aviacionit Civil, kur është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen sipas shkronjave (a) në (c) mund të bjerë dakord në marrëveshje alternative specifike të mbikëqyrjes me autoritetet e tjera kompetente. Çdo person ose organizatë që i nënshtrohet një marrëveshjeje të tillë do të informohet për ekzistencën dhe qëllimin e saj.

f) Në lidhje me certifikimin dhe mbikëqyrjen e përputhshmërisë së organizatës me pikën ATCO.OR.C.001A, përveç përputhshmërisë me shkronjat (a) deri (e), Autoriteti i Aviacionit Civil do të shqyrtojë çdo miratim të dhënë sipas pikës IS.I.OR.200(e) të kësaj Rregulloreje ose pikës IS.D.OR.200(e) të Rregullores së Deleguar e Komisionit (BE) 2022/1645 e datës 14 korrik 2022 që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit për organizatat e mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 748/2012 dhe (BE) nr. 139/2014 dhe që ndryshon Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 748/2012 dhe

(BE) nr. 139/2014, ciklin e zbatueshëm të auditimit të mbikëqyrjes dhe sa herë që zbatohen ndryshime në fushën e punës së organizatës.

ATCO.AR.C.005 Programi i mbikëqyrjes

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të krijojë dhe mbajë një program mbikëqyrjeje që mbulon aktivitetet e mbikëqyrjes të kërkuara nga ATCO.AR.C.001.

b) Për organizatat e certifikuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil programi i mbikëqyrjes do të zhvillohet duke marrë parasysh natyrën specifike të organizatës, kompleksitetin e aktiviteteve të tij dhe certifikimin e kaluar dhe/ose aktivitetet e mbikëqyrjes. Ai do të përfshijë brenda secilit cikël të planifikimit të mbikëqyrjes:

1) auditet dhe inspektimet, nëse nevojiten, duke përfshirë inspektimet pa njoftime paraprake; dhe

2) takimet e mbledhura ndërmjet menaxhimit të organizatës trajnuese dhe Autoritetit të Aviacionit Civil për të siguruar që të dyja mbesin të informuara mbi çështjet e rëndësishme.

c) Për organizatat e certifikuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil, një cikël planifikimi i mbikëqyrjes që nuk kalon 24 muaj do të aplikohet.

Cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të reduktohet nëse ka prova që performanca e sigurisë së organizatës është ulur.

Cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të zgjatet me një maksimum prej 36 muajsh nëse Autoriteti i Aviacionit Civil ka vendosur që gjatë 24 muajve të mëparshëm:

1) organizata ka treguar një trajtim efektiv të situatave të rrezikut në aviacion në lidhje me sigurinë në operim dhe menaxhim të rreziqeve të lidhura me to; dhe

2) organizata ka treguar në mënyrë të vazhdueshme sipas ATCO.OR.B.015 që ka kontroll të plotë mbi të gjitha ndryshimet; dhe

3) nuk janë lëshuar gjetje të nivelit 1; dhe

4) të gjitha veprimet korrigjuese janë zbatuar brenda periudhës kohore të pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil siç përcaktohet në ATCO.AR.E.015;

5) cikli i planifikimit të mbikëqyrjes mund të zgjatet më tej në një maksimum prej 48 muajsh, nëse, përveç sa më sipër, organizata ka krijuar dhe Autoriteti i Aviacionit Civil ka miratuar një sistem efektiv raportimi për Autoritetin e Aviacionit Civil mbi performacën e sigurisë dhe përputhshmërinë rregullore të vetë organizatës.



d) Programi i mbikëqyrjes për organizatat trajnuese do të përfshijë monitorimin e standardeve trajnuese duke përfshirë vëzhgimin e ofrimit të trajnimit nëse është e përshtatshme.

e) Për personat që mbajnë një licencë, kategori ose miratim të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil programi i mbikëqyrjes do të përfshijë inspektimet, duke përfshirë inspektimet e pa njoftuara, nëse është e përshtatshme.

ATCO.AR.C.010 Gjetjet dhe masat shtrënguese për personelin

a) Nëse gjatë mbikëqyrjes, nga Autoriteti i Aviacionit Civil, si autoriteti kompetent përgjegjës për mbikëqyrjen në përputhje me ATCO.AR.C.001, gjenden evidenca, që tregon papajtueshmëri me kërkesat e aplikueshme, nga një person që mban një licencë të lëshuar në përputhje me këtë rregullore, Autoriteti i Aviacionit Civil do të ngrejë një gjetje, do t'ia regjistrojë atë dhe do t'ia komunikojë atë me shkrim mbajtësit të licencës, si dhe do t'ia komunikojë gjetjen organizatës së angazhuar, nëse është e zbatueshme.

b) Kur Autoriteti i Aviacionit Civil që ngriti gjetjen është autoriteti kompetent përgjegjës për lëshimin e licencës:

1) Ai mund të pezullojë ose revokojë licencën, kategorinë ose miratimin, kur identifikohet një çështje e sigurisë në operim (*safety*); dhe

2) Ai do të marrë çdo masë zbatuese të nevojshme për të parandaluar vazhdimin e papajtueshmërisë.

c) Kur Autoriteti i Aviacionit Civil që ngriti gjetjen nuk është autoriteti kompetent përgjegjës për lëshimin e licencës, ai do të informojë autoritetin kompetent që ka lëshuar licencën. Në këtë rast, autoriteti kompetent që ka lëshuar licencën do të veprojë në përputhje me legjislacionin e tij dhe do të informojë Autoritetin e Aviacionit Civil që ngriti gjetjen.

NËNPJESA D

LËSHIMI, RIVLEFSHMËRIA, RINOVIMI, PEZULLIMI DHE REVOKIMI I LICENCEVE, KATEGORIVE DHE MIRATIMEVE

ATCO.AR.D.001 Procedura për lëshimin, rivlefshmërinë dhe rinovimin e licencave, kategorive, miratimeve dhe autorizimeve

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të krijojë procedura për aplikimin, lëshimin dhe shkëmbimin

e licencave, lëshimin e kategorive dhe miratimeve, si dhe rivlefshmërinë dhe rinovimin e miratimeve. Këto procedura mund të përfshijnë:

1) lëshimin e autorizimit të përkohshëm OJTI/ITVP dhe autorizimin e përkohshëm të vlerësuesit; dhe

2) nëse aplikohet, autorizimin për vlerësuesit për të rivlefshmuar dhe rinovuar miratimet e njësisë, rast në të cilin, vlerësuesit do të paraqesin të gjithë rekordet, raportet dhe çdo informacion tjetër për Autoritetin e Aviacionit Civil siç përcaktohet në procedura të tilla.

b) Pas marrjes së një aplikimi dhe, kur është e nevojshme, çdo dokumentacioni mbështetës, Autoriteti i Aviacionit Civil do të verifikojë tërësinë e aplikimit dhe nëse aplikanti përmbush kërkesat e përcaktuara në aneksin I.

c) Nëse aplikanti përmbush kërkesat e zbatueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil do të lëshojë, rivlefshmojë ose rinovojë, sipas rastit, licencën përkatëse, kategorinë dhe miratimin duke përdorur formatin për licencat e krijuara në Shtojcën 1 të Aneksit II. Autorizimi i përkohshëm OJTI/ITVP i referuar në ATCO.C.025 dhe autorizimi i përkohshëm i vlerësuesit i referuar në ATCO.C.065 do të lëshohen si një dokument i ndarë ku privilegjet e mbajtësit, si dhe vlefshmëria e autorizimit do të specifikohen.

d) Për qëllim të reduktimit të barrës së panevojshme administrative, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të krijojë procedura për krijimin e një date unike të vlefshmërisë për miratimet e ndryshme. Në çdo rast, periudhat e vlefshmërisë së miratimeve në fjalë nuk do të zgjaten.

e) Autoriteti i Aviacionit Civil do të zëvendësojë licencën e kontrollorëve të trafikut ajror nëse është e nevojshme për arsye administrative dhe kur pika (XIIa) e licencës përfundohet dhe nuk mbetet më hapësirë. Data e lëshimit të parë të kategorive dhe miratimet e kategorive do të transferohen në licencën e re.

ATCO.AR.D.003 Ndryshimi i autoritetit kompetent

a) Pas pranimit të kërkesës së mbajtësit të licencës për ndryshimin e autoritetit kompetent, Autoriteti i Aviacionit Civil, si autoriteti pritës, pa vonesë të panevojshme, do t'i kërkojë autoritetit kompetent të mbajtësit të licencës të transferojë, pa vonesë të panevojshme, të gjitha sa vijon:

1) verifikimin e licencës;



2) kopjet e të dhënave mjekësore të mbajtësit të licencës të mbajtura nga ai autoritet kompetent. Të dhënat mjekësore do të transferohen në mënyrë konfidenciale në përputhje me pikën ATCO.MED.A.015 të aneksit IV (pjesa-ATCO.MED) dhe do të përfshijnë një përmbledhje të historikut përkatës mjekësore të aplikantit, të verifikuar dhe të nënshkruar ose të vërtetuar në mënyrë elektronike nga vlerësuesi mjekësor.

b) Autoriteti kompetent transferues do të mbajë të dhënat origjinale të licencimit dhe ato mjekësore të mbajtësit të licencës.

c) Autoriteti i Aviacionit Civil, si autoriteti pritës, pa vonesa të panevojshme, do të shkëmbejë licencën dhe certifikatën mjekësore me kusht që të ketë marrë dhe përpunuar të gjitha dokumentet e përcaktuara në shkronjën (a). Me shkëmbimin e licencës dhe certifikatës mjekësore, Autoriteti i Aviacionit Civil, si autoriteti pritës do t'i kërkojë menjëherë mbajtësit të licencës që t'i dorëzojë atij licencën e lëshuar nga autoriteti kompetent transferues dhe certifikatën mjekësore përkatëse.

d) Licenca e re do të përfshijë kategoritë, miratimet e kategorisë, miratimet e licencës dhe të gjitha miratimet e njësisë të vlefshme në licencë, duke përfshirë datën e lëshimit të tyre të parë dhe skadimit, nëse është e aplikueshme.

e) Autoriteti i Aviacionit Civil, si autoriteti pritës do të njoftojë menjëherë autoritetin kompetent transferues pasi të ketë shkëmbyer licencën dhe certifikatën mjekësore dhe mbajtësi i licencës të ketë dorëzuar licencën dhe certifikatën mjekësore në përputhje me shkronjën (c). Derisa të merret një njoftim i tillë, autoriteti kompetent transferues mbetet përgjegjës për licencën dhe certifikatën mjekësore të lëshuar fillimisht për atë mbajtës të licencës.

ATCO.AR.D.005 Revokimi dhe pezullimi i licencave, kategorive dhe miratimeve

a) Për qëllim të pikës ATCO.A.020, Autoriteti i Aviacionit Civil do të krijojë procedura administrative për revokimin dhe pezullimin e licencave, kategorive dhe miratimeve.

b) Autoriteti i Aviacionit Civil mund të pezullojë licencën në rast të paaftësisë së përkohshme që nuk përfundon sipas procedurave të referuara në pikën ATCO.A.015(e).

c) Autoriteti i Aviacionit Civil do të pezullojë ose revokojë një licencë, kategori ose miratim në

përputhje me pikën ATCO.AR.C.010 veçanërisht në rrethanat e mëposhtme:

1) kur mbajtësi i licencës që ushtron privilegjet e licencës nuk pajtohet më me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregulloreje;

2) kur merr një licencë të student-kontrollorëve të trafikut ajror ose kontrollorëve të trafikut ajror, kategori, miratim ose certifikatë përmes falsifikimit të dokumenteve të paraqitura;

3) në rastet e falsifikimit të të dhënave të licencës ose certifikatës;

4) kur ushtron privilegjet e licencës, kategorive ose miratimeve nën ndikimin e substancave psikoaktive.

d) Në rastet e pezullimit ose revokimit të licencave, kategorive dhe miratimeve, Autoriteti i Aviacionit Civil do të njoftojë me shkrim mbajtësin e licencës dhe ofruesin përkatës të shërbimit të lundrimit ajror për këtë vendim dhe do të informojë mbajtësin e licencës për të drejtën e tij të apelit në përputhje me procedurat e përcaktuara në pikën ATCO.AR.A.010(m).

e) Gjithashtu, Autoriteti i Aviacionit Civil do të pezullojë ose revokojë një licencë, kategori ose miratim edhe me një kërkesë me shkrim të mbajtësit të licencës.

NËNPJESA E

PROCEDURA E CERTIFIKIMIT PËR ORGANIZATAT E TRAJNIMIT PËR KONTROLLORËT E TRAFIKUT AJROR DHE MIRATIMIT TË KURSEVE TË TRAJNIMIT

ATCO.AR.E.001 Procedura e certifikimit për organizatat e trajnimit dhe lëshimi i certifikatës

a) Pas marrjes së një aplikimi për lëshimin e certifikatës së organizatës së trajnimit, Autoriteti i Aviacionit Civil do të verifikojë përputhshmërinë e organizatës trajnuese me kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje.

b) Autoriteti i Aviacionit Civil mund të kërkojë çdo auditim, inspektim ose vlerësim të organizatës trajnuese që e sheh të nevojshëm përpara se të lëshojë certifikatën.

c) Nëse organizata e trajnimit që aplikon i përmbush kërkesat, Autoriteti i Aviacionit Civil do të lëshojë një certifikatë duke përdorur formatin e përcaktuar në shtojcën 2 të aneksit II.



d) Certifikata do të lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Aktivitetet që organizata trajnuese është miratuar të kryejë do të specifikohen në bashkëngjitjen e certifikatës.

e) Certifikata nuk do të lëshohet kur një gjetje e nivelit 1 mbetet e hapur. Në rrethana të jashtëzakonshme, gjetjet, të ndryshme nga niveli 1, do të vlerësohen dhe adresohen sipas nevojës nga organizata e trajnimit dhe një plan veprimi korrigjues për mbylljen e gjetjeve do të miratohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil përpara lëshimit të certifikatës.

f) Për t'i mundësuar një organizatë të zbatojë ndryshimet pa miratimin paraprak të autoritetit kompetent në përputhje me pikat ATCO.OR.B.015 dhe ATCO.AR.E.010(c), Autoriteti i Aviacionit Civil do të miratojë procedurën e paraqitur nga organizata trajnuese duke përcaktuar qëllimin e këtyre ndryshimeve dhe duke përshkruar se si këto ndryshime do të menaxhohen dhe njoftohen.

ATCO.AR.E.005 Miratimi i kurseve të trajnimit dhe planeve të trajnimit:

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të miratojë kurset e trajnimit dhe planet e trajnimit të zhvilluara në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ATCO.OR.D.001.

b) Për qëllime të ndryshimit të autoritetit kompetent sipas pikës ATCO.A.010, Autoriteti i Aviacionit Civil do të miratojë ose refuzojë kursin e miratimit të njësisë të krijuar në përputhje me pikën ATCO.B.020 (b) dhe (e) jo më vonë se 6 javë pas paraqitjes së kërkesës për miratimin e kursit, dhe do të sigurojë që parimet e mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit respektohen.

ATCO.AR.E.010 Ndryshimet për organizatat e trajnimit

a) Pas marrjes së një aplikimi për një ndryshim që kërkon miratimin paraprak në përputhje me ATCO.OR.B.015, Autoriteti i Aviacionit Civil do të verifikojë përputhshmërinë e organizatës trajnuese me kërkesat e përcaktuara në Aneksin III para lëshimit të miratimit.

Autoriteti i Aviacionit Civil do të miratojë kushtet nën të cilat organizata mund të operojë gjatë ndryshimit, përveç nëse Autoriteti i Aviacionit Civil vendos që ndryshimi nuk mund të zbatohet.

Pasi ka verifikuar që organizata e trajnimit pajtohet me kërkesat e aplikueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil do të miratojë ndryshimin.

b) Pa cenuar çdo masë zbatuese shtesë në

përputhje me ATCO.AR.E.015, kur organizata zbaton ndryshime që kërkojnë miratimin paraprak pa marrë miratimin e Autoritetit të Aviacionit Civil siç përcaktohet në shkronjën “a”, Autoriteti i Aviacionit Civil do të ndërmarrë veprim të menjëhershëm dhe të përshtatshëm.

c) Për ndryshime që nuk kërkojnë miratimin paraprak, Autoriteti i Aviacionit Civil do të miratojë një procedurë të zhvilluar nga organizata trajnuese në përputhje me ATCO.OR.B.015 që përcakton qëllimin e ndryshimeve të tilla dhe menaxhimin e saj, si edhe mekanizmin e njoftimit. Në procesin e vazhdueshëm të mbikëqyrjes Autoriteti i Aviacionit Civil do të vlerësojë informacionet e ofruara në njoftim për të verifikuar nëse veprimet e marra pajtohen me procedurat e miratuara dhe kërkesat e aplikueshme.

ATCO.AR.E.010A Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit

a) Në lidhje me ndryshimet e menaxhuara dhe të njoftuara tek Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën IS.I.OR.255(a) të aneksit II (pjesa-IS.I.OR) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2023/203 e datës 27 tetor 2022 që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit për organizatat e mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 1321/2014, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 1178/2011, (BE) 2015/340, Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664, dhe për autoritetet kompetente të mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 748/2012, (BE) nr. 1321/2014, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 1178/2011, (BE) 2015/340 dhe (BE) Nr. 139/2014, Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664 dhe që ndryshojnë Rregulloret e Komisionit (BE) Nr. 1178/2011, (BE) Nr. 748/2012, (BE) Nr. 965/2012, (BE) Nr. 139/2014, (BE) Nr. 1321/2014, (BE) 2015/340, dhe Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të përfshijë shqyrtimin e këtyre ndryshimeve në mbikëqyrjen e tij të vazhdueshme në përputhje me parimet e përcaktuara në pikën ATCO.AR.C.001. Nëse konstatohet ndonjë papajtueshmëri Autoriteti i Aviacionit Civil njofton organizatën për këtë,



kërkon ndryshime të mëtejshme dhe vepron në përputhje me pikën ATCO.AR.C.010.

b) Në lidhje me ndryshimet e tjera që kërkojnë një aplikim për miratim në përputhje me pikën IS.I.OR.255(b) të aneksit II (pjesa-IS.I.OR) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2023/203 e datës 27 tetor 2022 që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit për organizatat e mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 1321/2014, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 1178/2011, (BE) 2015/340, Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664, dhe për autoritetet kompetente të mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 748/2012, (BE) nr. 1321/2014, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 1178/2011, (BE) 2015/340 dhe (BE) Nr. 139/2014, Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664 dhe që ndryshojnë Rregulloret e Komisionit (BE) Nr. 1178/2011, (BE) Nr. 748/2012, (BE) Nr. 965/2012, (BE) Nr. 139/2014, (BE) Nr. 1321/2014, (BE) 2015/340, dhe Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664:

1) pas marrjes së kërkesës për ndryshim, Autoriteti i Aviacionit Civil do të kontrollojë përputhshmërinë e organizatës me kërkesat e zbatueshme përpara se të lëshojë miratimin;

2) Autoriteti i Aviacionit Civil do të përcaktojë kushtet në të cilat organizata mund të operojë gjatë zbatimit të ndryshimit;

3) nëse është i kënaqur që organizata përmbush kërkesat e zbatueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil do të miratojë ndryshimin.

ATCO.AR.E.015 Gjetjet, veprimet korrigjuese dhe masat zbatuese

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të ketë një sistem për të analizuar gjetjet për rëndësinë e sigurisë së tyre dhe për të vendosur mbi masat e zbatimit në bazë të rrezikut të paraqitur nga papajtueshmëria e organizatës trajnuese.

b) Gjetja e nivelit 1 do të lëshohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil kur zbulohet një papajtueshmëri e rëndësishme me kërkesat e zbatueshme të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, si dhe të kësaj Rregulloreje, me certifikatën dhe/ose kushtet e

miratimit dhe privilegjet e saj, e cila paraqet një rrezik të konsiderueshëm për sigurinë e fluturimit dhe/ose përndryshe vë në pikëpyetje aftësinë e organizatës trajnuese për të vazhduar trajnimin.

Një gjetje e nivelit 1 do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në:

1) ofrimin e trajnimit në një mënyrë që paraqet një rrezik të konsiderueshëm për sigurinë e fluturimit;

2) mosdhënien Autoritetit të Aviacionit Civil të aksesit në facilitetet e organizatës trajnuese siç përcaktohet në pikën ATCO.OR.B.025 gjatë orëve normale të punës dhe pas dy kërkesave me shkrim;

3) marrjen ose ruajtjen e vlefshmërisë së certifikatës së organizatës trajnuese përmes falsifikimit të provës dokumentare të paraqitur;

4) provën e shpërdorimit ose përdorimit mashtrues të certifikatës së organizatës trajnuese; dhe

5) mungesën e një menaxheri përgjegjës.

c) Një gjetje e nivelit 2 do të lëshohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil kur zbulohet çdo papajtueshmëri me kërkesat e aplikueshme të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe të kësaj Rregulloreje, me procedurat dhe manualet e organizatës trajnuese ose me llojin/et e trajnimit të ofruar ose certifikatën/at.

d) Kur një gjetje zbulohet gjatë mbikëqyrjes ose me çdo mjet tjetër, Autoriteti i Aviacionit Civil, pa cenuar çdo veprim shtesë të kërkuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe kjo Rregullore, do t’ia komunikojë gjetjen organizatës trajnuese me shkrim dhe do të kërkojë veprime korrigjuese për të adresuar papajtueshmërinë e identifikuar.

1) Në rastin e gjetjeve të nivelit 1, Autoriteti i Aviacionit Civil do të ndërmarrë veprimet apo masat e menjëhershme dhe të përshtatshme për të ndaluar ose kufizuar aktivitetet, dhe nëse është e përshtatshme, do të ndërmarrë veprim për të revokuar certifikatën ose për ta kufizuar ose pezulluar atë plotësisht ose pjesërisht, në varësi të shtrirjes së gjetjes, derisa të ndërmerren veprime korrigjuese të suksesshme nga organizata e trajnimit.

2) Në rastin e gjetjeve të nivelit 2, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet:



i. t'i japë organizatës së trajnimit një periudhë të zbatimit të veprimit korigjues të përfshirë në një plan veprimi të përshtatshëm për natyrën e gjetjes; dhe

ii. të vlerësojë veprimet korigjuese dhe planin e zbatimit të propozuar nga organizata e trajnimit dhe, nëse vlerësimi arrin në përfundimin se ato janë të mjaftueshme për të adresuar papajtueshmëritë i pranon ato.

3) Kur një organizatë trajnimi dështon së paraqituri një plan të pranueshëm të veprimit korigjues ose së kryeri veprimit korigjues brenda periudhës kohore të pranuar ose të zgjatur nga Autoriteti i Aviacionit Civil, gjetja do të ngrihet në një gjetje niveli 1 dhe veprimi do të ndërmerret siç përcaktohet në shkronjën (d)(1).

e) Autoriteti i Aviacionit Civil do të regjistrojë të gjitha gjetjet që ai ka ngritur dhe, sipas rastit, masat zbatuese që ai ka aplikuar, si dhe të gjitha veprimet korigjuese dhe datën e mbylljes së veprimit për gjetjet.

f) Për rastet që nuk kërkojnë nxjerrjen e gjetjeve të nivelit 1 dhe 2, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të nxjerrë observacione.

NËNPJESA F

KËRKESAT SPECIFIKE NË LIDHJE ME CERTIFIKIMIN AEROMJEKËSOR

SEKSIONI 1

KËRKESAT E PËRGJITHSHME

ATCO.AR.F.001 Qendrat aeromjekësore dhe certifikimi aeromjekësor

Përmes derogimit nga nënpjesët A, B dhe C, në lidhje me qendrat aeromjekësore (AeMCs) dhe certifikimin aeromjekësor, Autoriteti i Aviacionit Civil do të zbatojë dispozitat e mëposhtme të aneksit VI të urdhrat të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar, me përjashtim të të gjitha referencave për praktikuesit mjekësor të përgjithshëm (GMPs):

- Nënpjesa ARA.GEN;
- Nënpjesa ARA.AeMC;
- ARA.MED.120 Vlerësuesit mjekësorë;
- ARA.MED.125 Referimi në autoritetin licencues;
- ARA.MED.150 Mbajtja e rekordeve;

- ARA.MED.200 Procedura për lëshimin, rivlefshmërinë, rinovimin ose ndryshimin e një certifikatë AME;

- ARA.MED.245 Mbikëqyrja e vazhdueshme;

- ARA.MED.250 Kufizimi, pezullimi ose revokimi i një certifikate AME;

- ARA.MED.255 Masat shtrënguese;

- ARA.MED.315 Rishikimi i raporteve të ekzaminimit; dhe

- ARA.MED.325 Procedura e rishikimit.

SEKSIONI 2

DOKUMENTACIONI

ATCO.AR.F.005 Certifikata mjekësore

Certifikata mjekësore do të jetë në pajtim me specifikimet e mëposhtme:

a) përmbajtja:

1) shtetin në të cilin licenca ATCO është lëshuar ose aplikuar te pika “T”;

2) klasën e certifikatës mjekësore te pika “II”;

3) numrin e certifikatës që fillon me kodin e shtetit UN/OKB të shtetit në të cilin licenca ATCO është lëshuar ose aplikuar dhe ndiqet nga një kod numrash dhe/ose shkronjash në numra arabikë dhe shkrim latin te “III”;

4) emrin e mbajtësit “IV”;

5) kombësinë e mbajtësit “VI”;

6) datën e lindjes së mbajtësit “XIV”;

7) nënshkrimin e mbajtësit “VII”;

8) kufizimet “XIII”;

9) datën e skadencës së klasës 3 të certifikatës mjekësore “IX”;

10) datën e ekzaminimit;

11) datën e elektrokardiogramës së fundit;

12) datën e audiogramës së fundit;

13) datën e lëshimit dhe nënshkrimit të AME-së ose vlerësuesit mjekësorë që ka lëshuar certifikatën mjekësore “X”;

14) stampa ose vula.

b) Materiali: letra ose materiali tjetër i përdorur do të parandalojë ose të tregojë çdo ndryshim ose fshirje. Çdo shënim ose fshirje në formë do të autorizohet qartësisht nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

c) Gjuha: certifikatat mjekësore do të shkruhen në gjuhën kombëtare dhe në gjuhën angleze dhe në një gjuhë të tillë që Autoriteti i Aviacionit Civil e mendon të përshtatshme.



d) Të gjitha datat në certifikatën mjekësore do të shkruhen në formatin dd.mm.yyyy.

ATCO.AR.F.010 Certifikata e AME

Pasi ka verifikuar që AME-ja është në pajtim me kërkesat e aplikueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil do të lëshojë, ë rivlerësojë, rinovojë ose ndryshojë certifikatën AME, duke përdorur formën e vendosur në shtojcën 3 të aneksit II.

ATCO.AR.F.015 Certifikata e AeMC

Pasi ka verifikuar që AeMC është në pajtim me kërkesat e aplikueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil do të lëshojë ose ndryshojë certifikatën AeMC, duke përdorur formën e vendosur në shtojcën 4 të aneksit II.

ATCO.AR.F.020 Format aeromjekësore

Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë AME dhe AeMC me format për t'u përdorur, për:

- a) formën e aplikimit për një certifikatë mjekësore; dhe
- b) raportin e ekzaminimit për aplikantët e klasës 3.

SHTOJCA 1 E ANEKSIT II FORMATI PËR LICENCËN LICENCA E KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT AJROR (STUDENT)

Licenca e kontrollorëve të trafikut ajror (student) e lëshuar në përputhje me këtë rregullore duhet të jetë në përputhje me specifikimet e mëposhtme:

a) Përmbajtja. Numri i njësisë do të printohet gjithmonë në lidhje me titullin e njësisë. Njësitë I deri në XI janë njësi “të përhershme”, dhe njësitë XII deri në XIV janë njësi “të ndryshueshme” që mund të shfaqen në një pjesë të ndarë ose të ndashme të formës kryesore, siç përshkruhet më poshtë. Çdo pjesë e ndarë ose e ndashme do të identifikohet qartësisht si pjesë e licencës.

1. Njësitë e përhershme:

I. Shteti që lëshon licencën;

II. Titulli i licencës;

III. Numri serial i licencës me kodin e vendit të Kombeve të Bashkuara (KB) të Shtetit të lëshimit të licencës dhe e ndjekur nga “Licencë ATCO (student)” dhe një kod numrash dhe/ose shkronjash në numra Arabik dhe në shkrim latin;

IV. Emri i mbajtësit i plotë (në shkrim latin, edhe nëse shkrimi i gjuhës kombëtare është i ndryshëm nga ai latin);

IVa. Data e lindjes;

V. Adresa e mbajtësit, nëse kërkohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

VI. Kombësia e mbajtësit;

VII. Nënshkrimi i mbajtësit;

VIII. Autoriteti i Aviacionit Civil;

IX. Certifikata e vlefshmërisë dhe autorizimi për privilegjet e dhëna, duke përfshirë datat kur ato janë lëshuar së pari;

X. Nënshkrimi i nëpunësit që lëshon licencën dhe data e këtij lëshimi;

XI. Vula ose pulla e Autoriteti i Aviacionit Civil.

2. Njësitë e ndryshueshme:

XII. Kategoritë dhe miratimet me datat e skadencës;

XIII. Shënimet: miratimet e aftësisë gjuhësore; dhe

XIV. Çdo detaj tjetër i kërkuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Licenca do të shoqërohet nga një certifikatë e vlefshme mjekësore, me përjashtim të rasteve kur privilegjet e instruktorit ose vlerësuesit ushtrohen në një mjedis pajisjeje trajnimi sintetik.

c) Materiali. Letër e cilësisë së parë dhe/ose material tjetër i përshtatshëm, duke përfshirë kartat plastike, do të përdoren për të parandaluar ose treguar çdo ndryshim ose fshirje. Çdo hyrje ose fshirje në formë do të autorizohet qartësisht nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

d) Gjuha. Licencat do të shkruhen në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe.



Emri dhe logoja e Autoritetit të Aviacionit Civil (anglisht dhe shqip) Republika e Shqipërisë LICENCA E (STUDENT) KONTROLLOREVE TË TRAFIKUT AJROR [anglisht dhe çdo gjuhë e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil] E lëshuar në përputhje me urdhrin e ministrit nr..., datë.... Kjo licencë është në përputhje me standardet ICAO [anglisht dhe shqip] Forma 152 e Republikës së Shqipërisë sipas Modelit të EASA – lëshimi 2	Kërkesat ² Madhësia e çdo faqeje do të jetë një e teta e A4.
---	---

I	Shteti që e lëshon:	Kërkesat:
II	Titulli i licencës:	
III	Numri serial i licencës:	Numri serial i licencës do të fillojë gjithmonë me kodin shtetit të Kombeve të Bashkuara të Shtetit të lëshimit të licencës të ndjekur nga “Licencë ATCO (Student)”.
IV	Emri i plotë mbajtësit:	
IVa	Data e lindjes:	Formati standard i datës duhet të përdoret, d.m.th. dita.muaji.viti i plotë (p.sh. 31.1.2010).
XIV	Vendi i lindjes:	
V	Adresa e mbajtësit, nëse kërkohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil Rruga, qyteti, zona, kodi postar	
VI	Kombësia e mbajtësit:	Tregohet nga kodi i vendit të Kombeve të Bashkuara të Shtetit
VII	Nënshkrimi i mbajtësit:	
VIII	Autoriteti Kompetent:	
X	Nënshkrimi i nëpunësit që lëshon licencën dhe data e lëshimit	
XI	Vula ose pulla e autoritetit kompetent lëshues	

IX	Vlefshmëria e privilegjeve: <i>Mbajtësi ka të drejtën të ushtrojë privilegjet e kategorisë/ve dhe miratimit/ve të mëposhtëm, kur vlefësohet:</i>	Kërkesat: Anglisht dhe shqip.								
	<table><tr><td><i>Vlerësimi/et</i></td><td><i>Data e lëshimit të parë</i></td></tr><tr><td></td><td></td></tr><tr><td></td><td></td></tr><tr><td></td><td></td></tr></table>	<i>Vlerësimi/et</i>	<i>Data e lëshimit të parë</i>							Data e lëshimit të parë të një vlerësimi dhe/ose miratimi vlerësimi do të jetë data e përfundimit me sukses të trajnimit në lidhje me atë vlerësim dhe/ose miratim vlerësimi.
	<i>Vlerësimi/et</i>	<i>Data e lëshimit të parë</i>								
<table><tr><td>Miratimi/et i kategorive</td><td>Data e parë e lëshimit</td></tr><tr><td></td><td></td></tr><tr><td></td><td></td></tr><tr><td></td><td></td></tr></table>	Miratimi/et i kategorive	Data e parë e lëshimit								
Miratimi/et i kategorive	Data e parë e lëshimit									

² Kërkesat:

Faqet e referuara në udhëzimet se si licenca ATCO (Student) duhet të plotësohet janë menduar për përdorim nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose vlerësuesi i autorizuar në mënyrë specifike për të rivlerësuar ose rinovuar miratimet e njësisë. Lëshimet fillestare të kategorive, miratimet e kategorive, miratimet e gjuhës, miratimin e instruktorit dhe vlerësuesit, do të vendosen gjithmonë nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Rivlerësimi ose rinovimi i miratimeve të njësisë do të vendoset nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose nga vlerësuesit e autorizuar.

**XIIa Vlerësimet dhe miratimet me datat e skadencës**

Mbajtësi ka të drejtën të ushtrojë privilegjet e vlerësimit/ve të mëposhtëm dhe miratimit/ve të vlerësimit në njësinë/ të e shërbimit të trafikut ajror për të cilën miratimi i njësisë aktuale mbahet siç detajohet më poshtë, vetëm nëse mbajtësi ka një certifikatë mjekësore të vlefshme:

Njësia (treguesi ICAO) (*)	Spektori/ Pozicioni (*)	Vlerësimi/miratimi	Data e skadencës (*)	Nënshkrimi/vula e autoritetit ose numri i licencës dhe nënshkrimi i vlerësuesit

(*) Nuk zbatohet për licencën ATCO të studentit

XIIb	Miratime të tjera:	Kërkesat: N/A								
	Mbajtësi ka të drejtën të ushtrojë privilegjet e miratimit/ve të mëposhtëm									
	<table><tr><td>OJTI/ITVP/STDI/Miratimi i vlerësuesit</td><td>Data e skadencës</td></tr><tr><td></td><td></td></tr><tr><td></td><td></td></tr><tr><td></td><td></td></tr></table>		OJTI/ITVP/STDI/Miratimi i vlerësuesit	Data e skadencës						
	OJTI/ITVP/STDI/Miratimi i vlerësuesit		Data e skadencës							

XIII	Shënime: Miratimi i aftësisë gjuhësore: gjuha/niveli/data e skadencës]	Miratimi i aftësisë gjuhësore, niveli dhe data e skadencës do të përfshihen. Të gjitha informacionet shtesë të licencimit për t'u përfshirë këtu.
-------------	--	--

Shkurtimet

Kategoritë e kontrollorëve të trafikut ajror		Kërkesa: N/A
ADV	Kontrolli vizual i aerodromit	
ADC	Kontrolli i aerodromit	
APP	Kontrolli procedural i afrimit	
APS	Kontrolli afrimit meurvejim	
ACP	Kontrolli procedural i zonës	
ACS	Kontrolli i zonës meurvejim	
Miratimet e kategorive		
SUR	Mbikëqyrja e Kontrollit të Aerodromit	
PAR	Radari i afrimit me precizion	
SRA	Survejimi i afrimit me radar	
OCN	Kontrolli oqeanik	
Miratimet e licencës		
OJTI	Instruktori i trajnimit në vendin e punës	
STDI	Instruktori i pajisjes trajnuese sintetike	
ASSESSOR	Vlerësuesi	



SHTOJCA 2 E ANEKSIT II
CERTIFIKATA PËR ORGANIZATAT E TRAJNIMIT TË KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT
AJROR (ATCO TO)

Shteti³
Autoriteti i Aviacionit Civil

**CERTIFIKATA E ORGANIZATAVE TË TRAJNIMIT TË KONTROLLORËVE TË
TRAFIKUT AJROR**

[NUMËR/REFERENCË E CERTIFIKATËS]

Sipas kësaj rregulloreje dhe sipas kushteve të specifikuara më poshtë [Autoriteti i Aviacionit Civil] vërteton përmes kësaj që:

[EMRI I ORGANIZATËS SË TRAJNIMIT]
[ADRESA E ORGANIZATËS SË TRAJNIMIT]

Si një pjesë ATCO.OR certifikon organizatën e trajnimit me privilegjin për të ofruar trajnimin e pjesës ATCO, siç listohet në miratimin e trajnimit bashkëngjitur.

Termat e miratimit dhe privilegjet:

Kjo certifikatë kufizohet në privilegjet dhe qëllimin e ofrimit të trajnimit siç listohet në miratimin e trajnimit bashkëngjitur.

Kjo certifikatë është e vlefshme për sa kohë organizata e certifikuar qëndron në përputhje me pjesën ATCO.OR, pjesën ATCO dhe rregullore të tjera të aplikueshme.

Në përputhje me termat e mësipërm të miratimit dhe privilegjet, kjo certifikatë do të jetë e vlefshme, përveç kur certifikata dorëzohet, zëvendësohet, kufizohet, pezullohet ose revokohet.

Data e lëshimit

Nënshkruar:

[Autoriteti i Aviacionit Civil]

Forma 153 e RSH-së sipas modelit të EASA– lëshimi 1, faqe 1/2

**CERTIFIKATA PËR ORGANIZATËN E TRAJNIMIT TË KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT
AJROR
MIRATIMI I TRAJNIMIT**

Bashkëngjitur numri i certifikatës ATCO TO:

[NUMËR/REFERENCË E CERTIFIKATËS]
[EMRI I ORGANIZATËS SË TRAJNIMIT]

ka marrë privilegjet për të ofruar dhe kryer trajnimin e mëposhtëm në përputhje me pjesën ATCO

LLOJI/ET I TRAJNIMIT			
Lloji i trajnimit	Kursi	Miratimet e vlerësimit ⁽²⁾	Shënime ⁽³⁾
☐ Trajnimi fillestar ATCO	☐ Trajnimi bazë	Nuk aplikohet	
	☐ Trajnimi i kategorisë ⁽⁴⁾		
☐ Trajnimi i njësisë ATCO	 ⁽⁵⁾		
☐ Trajnimi i vazhdueshëm ATCO	☐ Trajnimi rifreskues për ATCO-në	Nuk aplikohet	
	☐ Trajnimi i konvertimit ATCO ⁽⁶⁾	Nuk aplikohet	
☐ Trajnimi i instruktorit praktik	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	
☐ Trajnimi i vlerësuesit	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	

Miratimi i kursit të trajnimit është i vlefshëm për sa kohë që:

a) certifikata ATCO TO nuk është dorëzuar, zëvendësuar, kufizuar, pezulluar ose revokuar; dhe



b) të gjitha operimet janë kryer në pajtim me pjesën ATCO.OR, pjesën ATCO, rregullore të tjera të aplikueshme dhe, sipas rastit, me procedurat në dokumentacionin e organizatës siç kërkohet nga pjesa ATCO.OR.

Data e lëshimit:

Nënshkruar: [Autoriteti i Aviacionit Civil]

Forma 153 e RSH-së sipas modelit të EASA – lëshimi 1, faqe 2/2

SHTOJCA 3 E ANEKSIT II
CERTIFIKATA PËR EKZAMINUESIT AEROMJEKËSORË (AME)¹

Autoriteti i Aviacionit Civil
CERTIFIKATA E EKZAMINUESIT AEROMJEKËSOR

CERTIFIKATË [NUMËR/REFERENCË]

Sipas kësaj rregulloreje dhe sipas kushteve të specifikuara më poshtë [Autoriteti i Aviacionit Civil] vërteton se

[EMRI I EKZAMINUESIT AEROMJEKËSOR]
[ADRESA E EKZAMINUESIT AEROMJEKËSOR]
Është ekzaminues aeromjekësor

KUSHTET

1. Kjo certifikatë kufizohet në privilegjet e specifikuara në dokumentin bashkëngjitur kësaj certifikate AME.
2. Kjo certifikatë kërkon përputhje me rregullat dhe procedurat zbatuese të specifikuara në pjesën MED dhe/ose ATCO.MED sipas rastit.
3. Kjo certifikatë do të jetë e vlefshme për një periudhë trevjeçare deri me [xx.yy.zzzz]⁴, sipas përputhshmërisë me kërkesat e pjesës MED dhe/ose pjesës ATCO.MED sipas rastit përveç nëse ajo dorëzohet, zëvendësohet, kufizohet, pezullohet ose revokohet.

Data e lëshimit

Nënshkrimi: [Autoriteti i Aviacionit Civil]

CERTIFIKATA PËR EKZAMINUESIT AEROMJEKËSORË (AME)

Bashkëngjitur numri i certifikatës AME:

PRIVILEGJET DHE QËLLIMI

[Emri dhe titulli akademik i ekzaminuesit aeromjekësor] ka marrë privilegjin për të ndërmarrë ekzaminimet dhe vlerësimet aeromjekësore për lëshimin e certifikatave mjekësore siç përcaktohet në tabelën më poshtë dhe për të lëshuar këto certifikata mjekësore për:

LAPL	[po/data]
Klasa 2	[po/data]
Klasa 1 rivlerësim/rinovim	[po/data]/ [jo]
Klasa 3 rivlerësim/rinovim	[po/data]/ [jo]

Data e lëshimit

Nënshkrimi: [Autoriteti i Aviacionit Civil]

⁴ Data e skadencës: dita.muaji.viti.



SHTOJCA 4 E ANEKSIT II
CERTIFIKATA PËR QENDRAT AEROMJEKËSORE (AeMC)¹

Autoriteti i Aviacionit Civil

CERTIFIKATA E QENDRËS AEROMJEKËSORE

REFERENCË

Sipas kësaj Rregulloreje dhe sipas kushteve të specifikuara më poshtë [Autoriteti i Aviacionit Civil]
vërteton që:

[EMRI I ORGANIZATËS]
[ADRESA E ORGANIZATËS]

si një pjesë e ORA certifikon Qendrën aeromjekësore me privilegjet dhe objektin e aktiviteteve, siç listohen
në termat bashkëngjitur miratimit.

KUSHTET

1. Kjo certifikatë kufizohet në fushëveprimtarinë sipas seksionit të miratimit të manualit të organizatës së miratuar.
2. Kjo certifikatë kërkon përputhje me procedurat e specifikuara në dokumentacionin e organizatës siç kërkohet nga pjesa ORA.
3. Kjo certifikatë do të jetë e vlefshme sipas përputhshmërisë me kërkesat e Pjesës ORA përveç nëse ajo dorëzohet, zëvendësohet, kufizohet, pezullohet ose revokohet.

Data e lëshimit

Nënshkrimi: [Autoriteti i Aviacionit Civil]

ANEKSI III

PJESA ATCO.OR
KËRKESAT PËR ORGANIZATAT E
TRAJNIMIT TË KONTROLLORËVE TË
TRAFIKUT AJROR DHE QENDRAT
AEROMJEKËSORE

NËNPJESA A
KËRKESAT E PËRGJITHSHME

ATCO.OR.A.001 Qëllimi

Kjo pjesë, e përcaktuar në këtë aneks, përcakton kërkesat e aplikueshme për organizatat e trajnimit të kontrollorëve të trafikut ajror dhe qendrat aeromjekësore, me qëllim për të marrë dhe mbajtur një certifikatë në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe këtë Rregullore.

NËNPJESA B

KËRKESAT PËR ORGANIZATAT E
TRAJNIMIT TË KONTROLLORËVE TË
TRAFIKUT AJROR

ATCO.OR.B.001 Aplikimi për certifikatë të
organizatës së trajnimit

a) Aplikimet për një certifikatë të organizatës trajnuese duhet t'i dorëzohen Autoritetit të Aviacionit Civil në kohën e duhur për të lejuar që autoriteti kompetent të vlerësojë aplikimin. Aplikimi do të paraqitet në përputhje me procedurën e vendosur nga ky autoritet.

b) Aplikantët për një certifikatë fillestare duhet t'i tregojnë Autoritetit të Aviacionit Civil se si ata i përmbushin kërkesat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, dhe në këtë Rregullore.

c) Një aplikim për një certifikatë të organizatës së trajnimit duhet të përfshijë informacionet e mëposhtme:

- 1) emrin dhe adresën e aplikantit;



2) adresën/at e vendit/eve të operimit (duke përfshirë, sipas rastit, listën e njësive ATC) nëse është e ndryshme nga adresa e aplikantit në pikën (1);

3) emrat dhe detajet e kontaktit të:

i. menaxherit përgjegjës;

ii. drejtuesit të organizatës së trajnimit, nëse është i ndryshëm nga pika (i);

iii. personave të caktuar nga organizata e trajnimit si pika kryesore për komunikimin me Autoritetin e Aviacionit Civil;

4) datën e menduar të fillimit të aktivitetit ose ndryshimit;

5) një listë të llojeve të trajnimit për t'u ofruar dhe së paku një kurs trajnimi nga secili lloj i trajnimit që mendohet të ofrohet;

6) deklaratën e përputhshmërisë me kërkesat e aplikueshme, e cila duhet të nënshkruhet nga menaxheri drejtues, duke deklaruar përputhshmërinë e organizatës trajnuese me kërkesat në çdo kohë;

7) proceset e sistemit të menaxhimit; dhe

8) datën e aplikimit.

ATCO.OR.B.005 Mjetet e përputhshmërisë

a) Një organizatë mund të përdorë çdo mjet alternativ përputhshmërie për të përcaktuar pajtueshmërinë me këtë rregullore.

b) Nëse një organizatë dëshiron të përdorë një mjet alternativ përputhshmërie, para se ta përdorë atë, duhet t'i japë Autoritetit të Aviacionit Civil një përshkrim të plotë. Përshkrimi duhet të përfshijë çdo rishikim të manualeve ose procedurave që mund të jenë relevante, si dhe një shpjegim që tregon se si arrihet pajtueshmëria me këtë Rregullore.

Organizata mund të përdorë këto mjete alternative të përputhshmërisë, që i nënshtrohet miratimit paraprak nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

ATCO.OR.B.010 Kushtet e miratimit dhe privilegjet e një certifikatë të organizatës së trajnimit

a) Organizatat e trajnimit do të përputhen me objektin dhe privilegjet e përcaktuara në kushtet e miratimit bashkëngjitur certifikatës së organizatës.

b) Për të siguruar që kërkesat e zbatueshme në nënpjesën D të aneksit I (pjesa ATCO) janë përmbushur, privilegji për të ofruar trajnimin e njësive dhe/ose të vazhdimësisë do t'i jepet vetëm organizatave trajnuese të cilat:

1) mbajnë një certifikatë për ofrimin e shërbimit të kontrollit të trafikut ajror; ose

2) kanë lidhur një marrëveshje specifike me ofruesin e ATC-së.

ATCO.OR.B.015 Ndryshimet në organizatën e trajnimit

a) Ndryshimet e mëposhtme do të kërkojnë miratim paraprak përpara zbatimit të tyre, përveç rastit kur ndryshime të tilla njoftohen dhe menaxhohen në përputhje me një procedurë të miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil siç përcaktohet në pikën ATCO.AR.E.010(c):

1) një ndryshim që prek objektin e certifikatës ose kushtet e miratimit të organizatës trajnuese; ose

2) një ndryshim që prek çdo element përkatës të sistemeve të menaxhimit të organizatës trajnuese.

b) Për çdo ndryshim që kërkon miratim paraprak në përputhje me shkronjën (a), organizata e trajnimit do të aplikojë dhe do të marrë një miratim të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Aplikimi do të paraqitet para se ndryshimi të ndodhë me qëllim për t'i mundësuar Autoriteti i Aviacionit Civil përcaktimin e përputhshmërisë së vazhdueshme me këtë Rregullore dhe për të ndryshuar, nëse është e nevojshme, certifikatën e organizatës trajnuese dhe kushtet përkatëse të miratimit bashkëngjitur saj. Organizatat trajnuese duhet t'i ofrojnë Autoritetit të Aviacionit Civil të gjithë dokumentacionin përkatës. Ndryshimi do të zbatohet vetëm pas marrjes së miratimit formal nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me pikën ATCO.AR.E.010. Organizatat e trajnimit do të operojnë sipas kushteve të përcaktuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil gjatë këtyre ndryshimeve, sipas rastit.

c) Ndryshimet në elementet e përmendura në shkronjën (a), për shkak të rrethanave të paparashikuara do t'i njoftohen Autoritetit të Aviacionit Civil pa vonesë me qëllim për të marrë miratimin sipas nevojës.

d) Organizatat trajnuese do të njoftojnë Autoritetin e Aviacionit Civil kur ata pushojnë aktivitetet e tyre.

ATCO.OR.B.020 Vlefshmëria e vazhdueshme

a) Një certifikatë e organizatës trajnuese do të mbetet e vlefshme me kusht që certifikata nuk dorëzohet ose revokohet dhe me kusht që organizata trajnuese mbetet në përputhje me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave



thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe kësaj Rregulloreje, duke marrë parasysh dispozitat që lidhen me trajtimin e gjetjeve në përputhje me pikën ATCO.OR.B.030.

b) Certifikata do t’i kthehet Autoritetit të Aviacionit Civil pa vonesë pas revokimit të saj ose pushimit të të gjitha aktiviteteve.

ATCO.OR.B.025 Aksesit në facilitetet dhe të dhënat e organizatës trajnuese

Organizatrat trajnuese dhe aplikantët për certifikatat e organizatave trajnuese do të lejojnë aksesin e çdo personi të autorizuar nga ose që vepron në emër të Autoritetit të Aviacionit Civil në ambientet përkatëse me qëllim për të ekzaminuar rekordet e kërkuara, të dhënat, procedurat dhe çdo material tjetër që lidhet me ekzekutimin e detyrave të Autoritetit të Aviacionit Civil.

ATCO.OR.B.030 Gjetjet

Pas marrjes së njoftimit për gjetjet e lëshuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me pikën ATCO.AR.E.015, organizata e trajnimit do të:

- a) identifikojë shkaku rrënjësor të gjetjes;
- b) përcaktojë një plan veprimi korrigjues që plotëson kërkesat e pranimit të Autoritetit të Aviacionit Civil; dhe
- c) tregojë zbatimin e veprimit korrigjues për të plotësuar kërkesat e Autoritetit të Aviacionit Civil brenda periudhës së rënë dakord me këtë autoritet, siç përcaktohet në pikën ATCO.AR.E.015.

ATCO.OR.B.035 Reagimi i menjëhershëm për një problem në sigurinë në operim

Organizata trajnuese do të zbatojë çdo masë mbi sigurinë në operim të urdhëruar nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me pikën ATCO.AR.A.025 (c) dhe (d) për aktivitetet e organizatës trajnuese.

ATCO.OR.B.040 Raportimi i ngjarjeve

a) Si pjesë e sistemit të tyre të menaxhimit, organizatat trajnuese që ofrojnë trajnime në vendin e punës do të krijojnë dhe mbajnë një sistem të raportimit të ngjarjeve, duke përfshirë raportimin e detyrueshëm dhe vullnetar. Organizatat e trajnimit të krijuara në Republikën e Shqipërisë dhe që ofrojnë trajnime në vendin e punës në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të sigurojnë që sistemi të jetë në përputhje me kërkesat e urdhrit të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë

24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

b) Organizatat e trajnimit që ofrojnë trajnime në vendin e punës duhet t’i raportojnë Autoritetit të Aviacionit Civil dhe çdo organizatë tjetër të kërkuar nga Shteti ku organizata e trajnimit ofron trajnim në vendin e punës, çdo ngjarje ose gjendje të lidhur me sigurinë që rezulton nga aktiviteti i tyre i trajnimit që rrezikon ose, nëse nuk korrigjohet ose adresohet, mund të rrezikojë një avion, pasagjerët e tij ose çdo person tjetër, dhe në veçanti çdo aksident ose incident serioz.

c) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, raportet në përputhje me shkronjën (b) më sipër duhet të:

1) bëhen sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast brenda 72 orëve nga momenti në të cilin organizata ka marrë dijeni për ngjarjen ose gjendjen me të cilën raporti lidhet, përveç rasteve kur rrethanat e jashtëzakonshme e pengojnë këtë;

2) bëhen në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

3) përmbajnë të gjithë informacionin përkatës në lidhje me gjendjen e njohur për organizatën.

d) Kur të jetë e zbatueshme, për organizatat e trajnimit që nuk janë themeluar në Shqipëri dhe që ofrojnë trajnime në vendin e punës në territorin ku zbatohen Traktatet e BE-së, raportet fillestare të detyrueshme duhet të:

1) ruajnë siç duhet konfidencialitetin e identitetit të raportuesit dhe të personave të përmendur në raport;

2) bëhen sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast brenda 72 orëve nga momenti në të cilin organizata ka marrë dijeni për ngjarjen, përveç rasteve kur rrethanat e jashtëzakonshme e pengojnë këtë;

3) bëhen në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil; dhe

4) përmbajnë të gjithë informacionin përkatës në lidhje me gjendjen e njohur për organizatën.

e) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, aty ku është e nevojshme, një raport pasues që ofron detaje të veprimeve që organizata synon të ndërmarrë për të



parandaluar ngjarje të ngjashme në të ardhmen do të bëhet sapo të identifikohen këto veprime; këto raporte pasuese:

- 1) do t'u dërgohen subjekteve përkatëse të raportuara fillimisht sipas shkronjave (b) dhe (c); dhe
- 2) do të bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

NËNPJESA C MENAXHIMI I ORGANIZATAVE TË TRAJNIMIT TË KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT AJROR

ATCO.OR.C.001 Sistemi i menaxhimit të organizatave të trajnimit

Organizatave të trajnimit do të krijojnë, zbatojnë dhe ruajnë një sistem menaxhimi që përfshin:

a) linjat e përgjegjësisë dhe llogaridhënies të përcaktuara qartë në të gjithë organizatën, duke përfshirë përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të sigurisë në operim së menaxherit përgjegjës;

b) një përshkrim të parimeve të përgjithshme të organizatës në lidhje me sigurinë në operim, të referuara si politika e sigurisë në operim;

c) identifikimin e risqeve të sigurisë në operim të shkaktuara nga aktivitetet e organizatës trajnuese, vlerësimin e tyre dhe menaxhimin e rreziqeve përkatëse, duke përfshirë veprimet për të lehtësuar rrezikun dhe për të verifikuar efektivitetin e tyre;

d) mbajtjen e personelit të trajnuar dhe kompetent për të kryer detyrat e tyre;

e) dokumentacionin e të gjithë proceseve kyçe të sistemit të menaxhimit, duke përfshirë një proces për ndërgjegjësimin e personelit për përgjegjësitë e tyre dhe procedurën për ndryshimin e këtij dokumentacioni;

f) një funksion për të monitoruar përputhshmërinë e organizatës me kërkesat përkatëse. Monitorimi i përputhshmërisë do të përfshijë një sistem mbledhje informacioni për menaxherin përgjegjës për gjetjet, për të siguruar zbatimin efektiv të veprimeve korrigjuese sipas nevojës;

g) sistemi i menaxhimit do të jetë proporcional me madhësinë e organizatës dhe aktivitetet e saj, duke marrë parasysh rreziqet dhe kërcënimet që lidhen me këto aktivitete.

ATCO.OR.C.001A Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit

Përveç sistemit të menaxhimit të përmendur në pikën ATCO.OR.C.001, organizata e trajnimit

duhet të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit në përputhje me rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2023/203, të datës 27 tetor 2022, që përcakton rregullat për zbatimin e rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit për organizatat e mbuluara nga rregulloret e Komisionit (BE) nr. 1321/2014, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 1178/2011, (BE) 2015/340, Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664, dhe për autoritetet kompetente të mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 748/2012, (BE) nr. 1321/2014, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 1178/2011, (BE) 2015/340 dhe (BE) Nr. 139/2014, Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664 dhe që ndryshojnë Rregulloret e Komisionit (BE) Nr. 1178/2011, (BE) Nr. 748/2012, (BE) Nr. 965/2012, (BE) Nr. 139/2014, (BE) Nr. 1321/2014, (BE) 2015/340, dhe Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664.

ATCO.OR.C.005 Aktivitetet e kontraktuara

a) Organizatat trajnuese do të sigurojnë që kur kontratojnë ose blejnë pjesë të aktiviteteve të tyre, aktiviteti i kontraktuar ose i blerë ose pjesë e aktivitetit është në përputhje me kërkesat e aplikueshme.

b) Kur një organizatë trajnuese kontraktton një pjesë të aktivitetit të saj për një organizatë që nuk është certifikuar në përputhje me këtë Rregullore për të kryer një aktivitet të tillë, organizata e kontraktuar do të punojë nën kushtet e miratimit që përmbahet në certifikatën e lëshuar për organizatën trajnuese kontraktuese. Organizata trajnuese kontraktuese do të sigurojë që Autoritetit të Aviacionit Civil t'i jepet akses në organizatën e kontraktuar për të vendosur përputhshmërinë e vazhdueshme me kërkesat e aplikueshme.

ATCO.OR.C.010 Kërkesat për personelin:

a) Organizatat trajnuese do të caktojnë një menaxher përgjegjës.

b) Një person ose disa persona do të caktohen nga organizata trajnuese me përgjegjësinë e trajnimit. Këta persona do të jenë përgjegjës në emër të menaxherit përgjegjës.

c) Organizatat trajnuese do të kenë personel të mjaftueshëm të kualifikuar për detyrat dhe aktivitetet e planifikuara për t'u kryer në përputhje me kërkesat e zbatueshme.



d) Organizatat trajnuese duhet të mbajnë një regjistër të instruktorëve teorikë me kualifikimet e tyre përkatëse profesionale, duke përfshirë demonstrimin e njohurive dhe eksperiencën e përshtatshme, vlerësimin e teknikave mësimore dhe lëndët që ata kanë të drejtë të japin mësim.

e) Organizatat trajnuese do të vendosin një procedurë për të ruajtur kompetencën e instruktorëve teorik.

f) Organizatat trajnuese do të sigurojnë që instruktorët praktikë dhe vlerësuesit të përfundojnë me sukses trajnimin rifreskues me qëllim për të rivlefshmëruar miratimin përkatës.

g) Organizatat trajnuese do të ruajnë rekordet e personave të kualifikuar për vlerësimin e kompetencës së instruktorëve praktikë dhe kompetencës së vlerësuesve, në përputhje me ATCO.C.045, me miratimet e tyre përkatëse.

ATCO.OR.C.015 Facilitetet dhe pajisjet

a) Organizatat trajnuese do të kenë facilitete që lejojnë kryerjen dhe menaxhimin e të gjitha detyrave të planifikuara dhe aktiviteteve në përputhje me këtë Rregullore.

b) Organizata trajnuese do të sigurojë që pajisjet e trajnimit sintetik përputhen me specifikimet e aplikueshme dhe kërkesat e përshtatshme për detyrën.

c) Gjatë instruksionit të trajnimit në vendin e punës, organizata trajnuese do të sigurojë që instruktori ka ekzaktësisht të njëjtat informacione si personi që ndërmerr OJT-në dhe mjetet për të ndërhyrë menjëherë.

ATCO.OR.C.020 Mbajtja e rekordeve

a) Organizatat trajnuese do të mbajnë të gjitha rekordet e detajuara të personave që marrin përsipër ose kanë marrë përsipër trajnimin për të treguar që të gjitha kërkesat e kurseve të trajnimit janë përmbushur.

b) Organizatat trajnuese do të krijojnë dhe mbajnë një sistem për regjistrimin e kualifikimeve profesionale dhe vlerësimeve të teknikave udhëzuese të instruktorëve dhe vlerësuesve, si dhe subjektet që ata kanë të drejtën të mësojnë, sipas rastit.

c) Rekordet e kërkuara në shkronjat (a) dhe (b) do të mbahen për një periudhë minimale prej pesë vjetësh duke iu nënshtruar ligjit kombëtar të zbatueshëm të mbrojtjes së të dhënave:

1) pasi personi që ka ndërmarrë trajnimin të ketë përfunduar kursin; dhe

2) pasi instruktori ose vlerësuesi heq dorë së kryeri një funksion për organizatën trajnuese, siç aplikohet.

d) Procesi i arkivimit duke përfshirë formatin e rekordeve do të specifikohet në sistemin e menaxhimit të organizatës trajnuese.

e) Rekordet do të ruhen në një mënyrë të sigurt.

ATCO.OR.C.025 Financimi dhe sigurimet

Organizatat trajnuese do të tregojnë që kanë financim të mjaftueshëm në dispozicion të trajnimit sipas kësaj Rregulloreje dhe që aktivitetet kanë mbulim sigurimi të mjaftueshëm në përputhje me natyrën e trajnimit të ofruar dhe të gjitha aktivitetet janë kryer në përputhje me këtë Rregullore.

NËNPJESA D

KËRKESAT PËR KURSET E TRAJNIMIT DHE PLANET E TRAJNIMIT

ATCO.OR.D.001 Kërkesat për kurset e trajnimit dhe planet e trajnimit

Organizatat trajnuese do të zhvillojnë:

a) planet e trajnimit dhe kurset e trajnimit të lidhura me llojin e trajnimit të ofruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aneksin 1 (pjesa ATCO), nënpjesa D;

b) subjektet, temat dhe nëntemat për miratimet e kategorive në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aneksin I (pjesa ATCO);

c) metodat e vlerësimeve në përputhje me ATCO.D.090 (a) (3) dhe ATCO.D.095 (a)(3).

ATCO.OR.D.005 Rezultatet e ekzaminimit, vlerësimit dhe certifikatat:

a) Organizata trajnuese do të vërë në dispozicion të aplikantit rezultatet e tij të ekzaminimeve dhe vlerësimeve dhe, pas kërkesës së aplikantit, do të lëshojë një certifikatë me rezultatin e tij të ekzaminimeve dhe vlerësimeve.

b) Pas përfundimit me sukses të trajnimit fillestar ose të trajnimit të kategorisë për lëshimin e një vlerësimi shtesë, organizata trajnuese do të lëshojë një certifikatë.

c) një certifikatë e përfundimit të trajnimit bazik do të lëshohet vetëm me kërkesë të aplikantit nëse të gjitha subjektet, temat dhe nëntemat e përmbajtura në shtojcën 2 të aneksit I janë përfunduar dhe aplikanti ka kaluar me sukses ekzaminimet dhe vlerësimet përkatëse.



NËNPJESA E
KËRKESAT PËR QENDRAT
AEROMJEKËSORE

ATCO.OR.E.001 Qendrat aeromjekësore

Qendrat aeromjekësore (AeMCs) do të zbatojnë dispozitat e nënpjesëve ORA.GEN dhe ORA.AeMC të aneksit VII të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, të ndryshuar, me:

- a) të gjitha referencat e klasës 1 për t’u zëvendësuar me klasën 3; dhe
- b) të gjitha referencat e pjesës MED për t’u zëvendësuar me pjesën ATCO.MED.

ANEKSI IV

PJESA ATCO.MED
KËRKESAT MJEKËSORE PËR
KONTROLLORËT E TRAFIKUT AJROR
NËNPJESA A
KËRKESAT E PËRGJITHSHME

SEKSIONI 1
TË PËRGJITHSHME

ATCO.MED.A.001 Autoriteti kompetent

Për qëllim të kësaj pjese, Autoriteti Kompetent do të jetë:

- a) Për qendrat aeromjekësore (AeMC):
 - 1) Autoriteti i Aviacionit Civil kur AeMC ka vendin e tij kryesor të biznesit në Shqipëri;
 - 2) Autoriteti i Aviacionit Civil, kur AeMC ndodhet në një vend të tretë;
 - 3) AeMC e certifikuar nga EASA apo autoriteti kompetent i ndonjë shteti anëtar të BE-së do të njihen nga Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar pa kërkesa apo vlerësime të mëtejshme.
- b) Për ekzaminuesit aeromjekësor (AME):
 - 1) Autoriteti i Aviacionit Civil, kur AME kanë vendin e tyre kryesor të praktikës në Shqipëri;
 - 2) nëse vendi kryesor i praktikës së një AME ndodhet në një vend të tretë, Autoriteti i Aviacionit Civil, kur AME aplikon për lëshimin e certifikatës në Shqipëri;
 - 3) AME e certifikuar nga EASA apo autoriteti kompetent i ndonjë shteti anëtar të BE-së do të njihen nga Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar pa kërkesa apo vlerësime të mëtejshme.

ATCO.MED.A.005 Qëllimi

Kjo pjesë, e përcaktuar në këtë aneks, vendos kërkesat për:

a) lëshimin, vlefshmërinë, rivlefshmërinë dhe rinovimin e certifikatës mjekësore të kërkuar për ushtrimin e privilegjeve të një licence të kontrollorëve të trafikut ajror ose një licencë të student-kontrollorëve të trafikut ajror; dhe

b) certifikimin e AME për të lëshuar certifikatat mjekësore të klasës 3.

ATCO.MED.A.010 Përkufizimet

a) “Konkluzion mjekësor i akredituar” nënkupton konkluzionin e arritur nga një ose më shumë ekspertë mjekësorë të pranueshëm për Autoritetin e Aviacionit Civil, mbi bazën e kriterëve objektive dhe jodiskriminuese, në konsultim me ekspertët operacional ose ekspertë të tjerë sipas nevojës dhe duke përfshirë një vlerësim të rrezikut operacional.

b) “Vlerësim aeromjekësor” nënkupton konkluzionin mbi përshtatshmërinë mjekësore të një aplikanti bazuar mbi vlerësimin e historisë mjekësore të aplikantit dhe ekzaminimeve aeromjekësore siç kërkohet në këtë pjesë dhe ekzaminimet dhe testet mjekësore të mëtejshme sipas nevojës.

c) “Ekzaminimi aeromjekësor” nënkupton inspektimin, prekjen, perkusionin, dëgjimin dhe çdo mjet tjetër të investigimit veçanërisht për vendosjen e përshtatshmërisë mjekësore për të ushtruar privilegjet e licencës.

d) “Specialisti i syrit” nënkupton një okulist ose një specialist të kujdesit të syrit të kualifikuar në optometri dhe të trajnuar për të njohur gjendjet patologjike.

e) “Investigim” nënkupton vlerësimin e një gjendje patologjike të dyshuar të një aplikanti me anë të ekzaminimeve dhe testeve për të verifikuar praninë ose mungesën e një gjendjeje mjekësore;

f) “Autoriteti licencues” nënkupton autoritetin kompetent që ka lëshuar licencën, ose tek i cili personi aplikon për lëshimin e një licence, ose, kur një person nuk ka aplikuar ende për lëshimin e një licence, autoriteti kompetent në përputhje me këtë pjesë.

g) “Kufizimi” nënkupton një kusht të vendosur në certifikatën mjekësore që duhet të përmbushet ndërsa ushtrohen privilegjet e licencës.

h) “Gabimi refraktiv” nënkupton devijimin nga emetropia e matur në dioptri në pjesën e meridianit



më ametropik, të matur nga metodat standarde.

i) “Domethënës” nënkupton një shkallë të gjendjes mjekësore, efekti i së cilës do të ndalonte ushtrimin e sigurt të privilegjeve të licencës.

ATCOMED.A.015 Konfidencialiteti mjekësor

Të gjithë personat e përfshirë në ekzaminimin aeromjekësor, vlerësimin aeromjekësor dhe certifikimin do të sigurojnë që konfidencialiteti mjekësor respektohet në çdo kohë.

ATCO.MED.A.020 Rënie e gjendjes shëndetësore

a) Mbajtësit e licencës nuk do të ushtrojnë privilegjet e licencës së tyre në çdo kohë kur ata:

1) janë të vetëdijshëm për çdo reduktim të gjendjes së tyre mjekësore, që mund të bëjë që ato të mos jenë në gjendje të ushtrojnë ato privilegje;

2) marrin ose përdorin çdo mjekim të parashikuar ose jo që ka gjasa të ndërhyjë në ushtrimin e sigurt të privilegjeve të licencës;

3) marrin çdo trajtim mjekësor, kirurgjik ose tjetër që ka gjasa të ndërhyjë në ushtrimin e sigurt të privilegjeve të licencës.

b) Përveç kërkesave të përcaktuara në shkronjën (a), mbajtësit e një certifikate mjekësore të klasës 3, pa asnjë vonesë dhe para ushtrimit të privilegjeve të licencës së tyre, do të kërkojnë këshillim aeromjekësor, kur ata:

1) i janë nënshtruar një operacioni kirurgjik ose një procedure invazive;

2) kanë filluar përdorimin e rregullt të çdo mjekimi;

3) kanë vuajtur nga çdo dëmtim personal i konsiderueshëm që përfshin çdo paaftësi për të ushtuar privilegjet e licencës;

4) kanë vuajtur nga çdo sëmundje e konsiderueshme që përfshin çdo paaftësi për të ushtuar privilegjet e licencës;

5) janë shtatzënë;

6) janë shtruar në spital ose në klinikë mjekësore;

7) kërkojnë për herë të parë lente korrigjuese.

Në këto raste, AeMC ose AME do të vlerësojë gjendjen mjekësore të mbajtësit të licencës ose student-kontrollorëve të trafikut ajror dhe do të vendosë nëse ata janë të përshtatshëm për të rimarrë ushtrimin e privilegjeve të tyre.

ATCO.MED.A.025 Detyrimet e AeMC-së dhe AME-së

a) Kur kryen ekzaminimet dhe vlerësimet aeromjekësore siç kërkohet në këtë pjesë, AeMC ose

AME do të:

1) sigurojë që komunikimi me aplikantin mund të vendoset pa barrierë gjuhësore;

2) ndërgjegjësojë aplikantin për pasojat e kryerjes së deklaratave të paplota, të pasakta ose të rreme mbi historinë e tij mjekësore;

3) njoftojë autoritetin licencues nëse aplikanti ofron deklaratë të paplota, të pasakta ose të rreme mbi historinë e tij mjekësore;

4) njoftojë autoritetin licencues nëse aplikanti tërheq aplikimin për një certifikatë mjekësore në çdo fazë të procesit.

b) Pas përfundimit të ekzaminimeve dhe vlerësimeve aeromjekësore, AeMC dhe AME do të:

1) njoftojë aplikantin nëse është i përshtatshëm ose i papërshtatshëm ose do t’ia referojë autoritetit licencues;

2) informojë aplikantin mbi çdo kufizim të vendosur në certifikatën mjekësore; dhe

3) nëse aplikanti është vlerësuar si i papërshtatshëm, ta informojë mbi të drejtën e tij/saj për një rishikim të vendimit; dhe

4) t’i paraqesë pa vonesë autoritetit licencues një raport të nënshkruar ose elektronikisht të autentifikuar që përmban rezultatet e detajuara të ekzaminimit dhe vlerësimit aeromjekësor për certifikatën mjekësore dhe një kopje të formës së aplikimit, formës së ekzaminimit dhe certifikatës mjekësore; dhe

5) informojë aplikantin mbi përgjegjësinë e tij në rast të reduktimit të përshtatshmërisë mjekësore siç specifikohet në ATCO.MED.A.020.

c) AeMC dhe AME do të mbajnë rekordet me detajet e ekzaminimeve dhe vlerësimeve aeromjekësore të kryera në përputhje me këtë pjesë dhe rezultatet e tyre për një periudhë minimale prej 10 vjetësh ose për një periudhë siç vendoset nga legjislacioni kombëtar nëse është më e gjatë.

d) AeMC dhe AME do t’i dorëzojnë Autoritetit të Aviacionit Civil, pas kërkesës, të gjitha rekordet dhe raportet aeromjekësore dhe çdo informacion përkatës kur kërkohen për:

1) certifikatën mjekësore; dhe

2) funksionet e mbikëqyrjes.



SEKSIONI 2
KËRKESAT PËR CERTIFIKATAT
MJEKËSORE

ATCO.MED.A.030 Certifikatat mjekësore

a) Aplikantët dhe mbajtësit e një licence të kontrollorëve të trafikut ajror ose licencës së student-kontrollorëve të trafikut ajror, duhet të kenë një certifikatë mjekësore të klasës 3, përveç rasteve kur privilegjet ushtrohen në një mjedis pajisjeje trajnimi sintetik.

b) Një mbajtës licence në çdo kohë nuk do të mbajë më shumë se një certifikatë mjekësore të lëshuar në përputhje me këtë pjesë.

ATCO.MED.A.035 Aplikimi për një certifikatë mjekësore

a) Aplikimet për një certifikatë mjekësore do të bëhen në një format të vendosur nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Aplikantët për një certifikatë mjekësore duhet t'i tregojnë AeMC ose AME-së:

- 1) dëshminë e identitetit të tyre;
- 2) një deklaratë të nënshkruar:

i. të fakteve mjekësore që kanë të bëjnë me historinë e tyre mjekësore;

ii. nëse kanë aplikuar më parë për një certifikatë mjekësore ose kanë kryer një ekzaminim aeromjekësor për një certifikatë mjekësore dhe nëse është kështu nga kush dhe me çfarë rezultati;

iii. nëse janë vlerësuar ndonjëherë si të papërshtatshëm ose kanë një certifikatë mjekësore të pezulluar ose revokuar.

c) Kur aplikojnë për një rivlefshmëri ose rinovim të certifikatës mjekësore, aplikantët do të paraqesin certifikatën mjekësore më të fundit për AeMC ose AME para ekzaminimeve përkatëse aeromjekësore.

ATCO.MED.A.040 Lëshimi, rivlefshmëria dhe rinovimi i certifikatave mjekësore:

a) Një certifikatë mjekësore do të lëshohet, rivlerësohet ose rinovohet vetëm pasi ekzaminimet dhe vlerësimet aeromjekësore janë përfunduar dhe aplikanti është vlerësuar si i shëndetshëm.

b) Lëshimi fillestar:

Certifikatat mjekësore fillestare të klasës 3 do të lëshohen nga një AeMC.

c) Rivlerësimi dhe rinovimi:

Certifikatat mjekësore të klasës 3 do të rivlerësohen ose rinovohen nga një AeMC ose një AME.

d) AeMC ose AME do të lëshojë, rivlerësojë ose rinovojë një certifikatë mjekësore nëse:

1) aplikanti i ka ofruar atyre një histori mjekësore të plotë dhe, nëse kërkohet nga AeMC ose AME, rezultatet e ekzaminimeve dhe testeve aeromjekësore të kryera nga mjeku i aplikantit ose çdo specialist mjekësor; dhe

2) AeMC ose AME ka kryer vlerësimin aeromjekësor bazuar në ekzaminimet dhe testet aeromjekësore siç kërkohet për të verifikuar që aplikanti pajtohet me të gjitha kërkesat përkatëse të kësaj pjese.

e) AME, AeMC ose, në rastin e referimit, autoriteti licencues mund të kërkojë që aplikanti të kalojë ekzaminimet dhe investigimet mjekësore shtesë në rast të indikacioneve klinike para se certifikata të jetë lëshuar, rivlerësuar ose rinovuar.

f) Autoriteti licencues mund të lëshojë ose rilëshojë një certifikatë mjekësore, siç aplikohet, nëse:

1) rasti është referuar;

2) është identifikuar që korrigjimet e informacioneve në certifikatë janë të nevojshme, dhe në këtë rast certifikata mjekësore jo korrekte do të revokohet.

ATCO.MED.A.045 Vlefshmëria, rivlerësimi dhe rinovimi i certifikatave

a) Vlefshmëria:

1) Certifikatat mjekësore të klasës 3 do të jenë të vlefshme për një periudhë prej 24 muajsh.

2) Periudha e vlefshmërisë e certifikatave mjekësore të klasës 3 do të reduktohen në 12 muaj për mbajtësit e licencës që kanë arritur moshën 40-vjeçare. një certifikatë mjekësore e lëshuar para arritjes së moshës 40-vjeçare do të pushojë së qenuri e vlefshme kur mbajtësi i licencës arrin moshën 41-vjeçare.

3) Periudha e vlefshmërisë së një certifikatë mjekësore, duke përfshirë çdo ekzaminim përkatës ose investigim të veçantë, do të jetë:

i. e përcaktuar nga moshë e aplikantit në datën kur bëhet ekzaminimi aeromjekësor; dhe

ii. e përllogaritur nga data e ekzaminimit aeromjekësor në rastin e lëshimit fillestar dhe rinovimit dhe nga data e skadencës së certifikatës mjekësore të mëparshme në rastin e rivlerësimit.

b) Rivlefshmëria:

Ekzaminimet dhe vlerësimet aeromjekësore për rivlerësimit e një certifikatë mjekësore mund të ndërmerren deri në 45 ditë para datës së skadencës së certifikatës mjekësore.

**c) Rinovimi:**

1) Nëse mbajtësi i një certifikatë mjekësore nuk përputhet me shkronjën “b”, një ekzaminim dhe vlerësim aeromjekësor do të kërkohet.

2) Nëse certifikata mjekësore ka skaduar për:

i. më pak se 2 vjet, do të kryhet një ekzaminim aeromjekësor i rivlerësimit rutinë;

ii. më shumë se 2 vjet, AeMC ose AME do të kryejnë vetëm ekzaminimin aeromjekësor të rinovimit pas vlerësimit të rekordeve aeromjekësore të aplikantit;

iii. më shumë se 5 vjet, do të aplikohen kërkesat e ekzaminimit aeromjekësor për lëshimin fillestar dhe vlerësimi do të bazohet në kërkesat e rivlerësimit.

ATCO.MED.A.046 Pezullimi ose Revokimi i një certifikatë mjekësore:

a) Pas revokimit të certifikatës mjekësore, mbajtësi do t’ja kthejë menjëherë certifikatën mjekësore autoritetit licencues.

b) Pas pezullimit të një certifikatë mjekësore, mbajtësi do t’ja kthejë certifikatën mjekësore autoritetit licencues me kërkesë të autoritetit.

ATCO.MED.A.050 Referimi

Nëse një aplikant për një certifikatë mjekësore të klasës 3 i referohet autoritetit licencues në përputhje me ATCO.MED.B.001, AeMC ose AME do të transferojë dokumentacionin mjekësor përkatës tek autoriteti licencues.

NËNPJESA B**KËRKESAT PËR CERTIFIKATAT
MJEKËSORE TË KONTROLLORËVE TË
TRAFIKUT AJROR****SEKSIONI 1
TË PËRGJITHSHME****ATCO.MED.B.001 Kufizimet e certifikatave
mjekësore**

a) Kufizimet e certifikatave mjekësore të klasës 3:

1) Nëse aplikanti nuk është plotësisht në përputhje me kërkesat për një certifikatë mjekësore 3, por konsiderohet se nuk ka gjasa të rrezikojë ushtrimin e sigurt të privilegjeve të licencës, AeMC ose AME do të:

i. referojë vendimin mbi gjendjen e aplikantit tek autoriteti licencues siç përcaktohet në këtë nënpjesë; ose

ii. në rastet kur një referim tek autoriteti licencues

nuk përcaktohet në këtë nënpjesë, do të vlerësojë nëse aplikanti është në gjendje të kryejë detyrat e tij në mënyrë të sigurt, në përputhje me një ose me më shumë kufizime të miratuara në një certifikatë mjekësore dhe do të lëshojë certifikatën mjekësore me kufizimet e nevojshme.

2) AeMC ose AME mund të rivlefshmërojë ose rinovojë një certifikatë mjekësore me të njëjtin kufizim pa e referuar aplikantin tek autoriteti licencues.

b) Kur vlerëson nëse një kufizim është i nevojshëm, konsideratë e veçantë duhet t’i jepet:

1) nëse konkluzioni i akredituar mjekësor tregon që në rrethana të veçanta dështimi i aplikantit për të përmbushur çdo kërkesë, qoftë numerike ose tjetër, është i tillë saqë ushtrimi i privilegjeve të licencës nuk ka gjasa të rrezikojë ushtrimin e sigurt të privilegjeve të licencës;

2) eksperiencës së aplikantit e rëndësishme për operimin që do të kryhet.

c) Kufizimet operacionale

1) Autoriteti i Aviacionit Civil, së bashku me ofruesin e shërbimit të lundrimit ajror, do të vendosë kufizimet operacionale të aplikueshme në mjedisin operacional specifik në fjalë.

2) Kufizimet operacionale do të vendosen vetëm në certifikatën mjekësore nga autoriteti licencues.

d) Çdo kufizim tjetër mund të imponohet mbi mbajtësin e një certifikatë mjekësore nëse kjo kërkohet për të siguruar ushtrimin e sigurt të privilegjeve të licencës.

e) Çdo kufizim mbi mbajtësin e një certifikatë mjekësore do të specifikohet këtu.

SEKSIONI 2**KËRKESAT MJEKËSORE PËR
CERTIFIKATAT MJEKËSORE TË KLASËS 3****ATCO.MED.B.005 Të përgjithshme**

Aplikantët duhet të jenë pa prani të cildo çrregullimi si më poshtë që do të tregonte shkallën e paaftësisë funksionale që ka gjasa të ndërhyjë në kryerjen e sigurt të detyrave ose mund të bëjë që aplikanti të ketë gjasa që të bëhet papritmas i paaftë për të ushtruar privilegjet e licencës në mënyrë të sigurt:

1) anomali, e lindur ose e fituar;

2) sëmundje ose paaftësi aktive, e fshehur, akute ose kronike;



3) plagë, dëmtim ose ndryshimi të përhershëm nga operacioni;

4) efekt ose efekt anësor nga mjekimi terapeutik i marrë ose jo, qoftë ky mjekim diagnostikues ose parandalues i parashikuar.

ATCO.MED.B.010 Sistemi kardiovaskular

a) Ekzaminimi:

1) Një elektrokardiogramë standarde 12-kanalëshe në gjendje qetësie(EKG) me raportin që duhet të përfundohet në ekzaminimin për lëshimin fillestar të një certifikatë mjekësore dhe pastaj:

i. çdo 4 vjet deri në moshën 30-vjeçare;

ii. në të gjitha rivlerësimet ose ekzaminimet e më pas; dhe

iii. kur duket klinikisht.

2) Një vlerësim kardiovaskular i zgjeruar duhet të kryhet:

i. në ekzaminimin e rivlefshmërimin ose rinovimit të parë pas moshës 65-vjeçare;

ii. çdo 4 vjet më pas; dhe

iii. kur ka indikacion klinik.

3. Vlerësimi i lipideve në serum, duke përfshirë kolesterolin, do të kërkohet në ekzaminimin për lëshimin fillestar të një certifikatë mjekësore, në ekzaminimin e parë pasi ka arritur moshën 40-vjeçare dhe kur ka indikacion klinik .

b) Sistemi kardiovaskular – të përgjithshme:

1) Aplikantët të cilët kane një prej gjendjeve të mëposhtme do të vlerësohen si të papërshtatshëm nga ana shëndetësore :

i. aneurizma e aortës së krahavorit ose s aortës abdominale suprarenale para operacionit;

ii. anomali e rëndësishme funksionale ose simptomatike e secilës valvul të zemrës;

iii. transplant zemre ose transplant të dyfishtë zemre/mushkërie.

2) Aplikantët me një histori ose diagnozë të secilës prej gjendjeve të mëposhtme do t'i referohen autoritetit licencues para se të konsiderohet i shëndetshëm:

i. sëmundje arteriale periferike para ose pas operacionit;

ii. aneurizma e aortës së krahavorit ose s aortës abdominale suprarenale pas operacionit;

iii. aneurizma e aortës infrarenale abdominale para ose pas operacionit;

iv. anomali valvulare kardiake të rëndësishme nga ana funksionale;

v. pas operacionit të valvulës kardiake;

vi. anomali e perikardit, miokardit ose endokardit;

vii. anomali e lindur e zemrës, para ose pas ndërhyrjes kirurgjike korigjuese;

viii. sinkopë vazovagale e përsëritur;

ix. trombozë arteriale ose venoze;

x. emboli pulmonare;

xi. gjendje kardiovaskulare që kërkon terapi antikoagulante sistemike.

c) Presioni i gjakut:

1) Presioni i gjakut duhet të matet në çdo ekzaminim.

2) Presioni i gjakut i aplikantit duhet të jetë brenda limiteve normale.

3) Aplikantët do të vlerësohen si të pashëndetshëm kur:

i. ata kanë hipotensionsimptomatik; ose

ii. kur presioni i tyre i gjakut në ekzaminim tejkalon në mënyrë të vazhdueshme 160 mmHg të shtypjes sistolike dhe 95 mmHg të shtypjes diastolike, me ose pa trajtim.

4) Fillimi i mjekimit për kontrollin e presionit të gjakut do të kërkojë fillimisht një vlerësim mjekësor për një periudhë të papërshtatshmërisë së përkohshme shëndetësore për të parë mungesën e efekteve anësore të rëndësishme pas marrjes së terapisë antihipertenzive.

d) Sëmundja e arteries koronare:

1) Aplikantët që kanë një prej gjendjeve të mëposhtme do të vlerësohen si të papërshtatshëm nga gjendja shëndetësore:

i. sëmundja simptomatike e arteries koronare;

ii. simptoma të sëmundjes së arteries koronare të kontrolluara nga mjekimi.

2) Aplikantët me secilën prej gjendjeve të mëposhtme do t'i referohet autoritetit licencues dhe do të kalojnë vlerësimin kardiologjik për të përjashtuar isheminë miokardiake para se një vlerësim i gjendjes së përshtatshme shëndetësore të merret në konsideratë:

i. dyshim për ishemi miokardiake;

ii. sëmundje asimptomatike e arterieve të vogla koronare që nuk kërkon trajtim antianginoz.

3) Aplikantët me një histori ose diagnozë të secilës prej gjendjeve të mëposhtme do t'i referohen autoritetit licencues dhe do të kalojnë një vlerësim kardiologjik para se një vlerësim i gjendjes së përshtatshme shëndetësore të merret në konsideratë:

i. ishemi miokardiake;



ii. infarkt miokardi;
iii. rivaskularizimi dhe stentimi për sëmundjen e arteries koronare.

e) Çrregullimet e ritmit/përcjellshmërisë kardiake /:

1) Aplikantët për një certifikatë mjekësore të klasës 3 me çdo çrregullim të rëndësishëm të përcjellshmërisë ose ritmit kardiak, të përhershëm ose të krijuar do t'i referohet autoritetit licencues dhe do të kalojnë vlerësim kardiologjik me rezultate të kënaqshme para se një vlerësim i gjendjes së përshtatshme shëndetësore të merret në konsideratë. Këto çrregullime do të përfshijnë cilëndo nga gjendjet si më poshtë:

- i. takikardia atriale ose supraventrikulare, fibrilacion atrial.
- ii. bllok komplet i degës së majtë;
- iii. bllok atrioventrikular I i tipit Mobitz 2;
- iv. takikardi ventrikulare me komplekse të gjera dhe/ose të ngushta;
- v. sindromi I preragimit ventrikular
- vi. Sindromi I intervalit QT të zgjatur (në EKG);
- vii. Sindromi Brugada në elektrokardiografi.

2) Aplikantët me një prej gjendjeve të mëposhtme të listuara në pikat “i” deri në “viii” mund të vlerësohen si të përshtatshëm nga ana shëndetësore në mungesë të një anomalie tjetër dhe që i nënshtrohen një vlerësimi kardiologjik të kënaqshëm:

- i. bllok jo i plotë;
- ii. bllok i plotë i degës së djathtë;
- iii. devijim stabil i boshtit elektrik majtas;
- iv. bradikardi sinusale asimptomatike;
- v. takikardi sinusale asimptomatike;
- vi. komplekse ektopike të izoluara uniforme asimptomatike supraventrikulare ose ventrikulare;
- vii. bllok atrioventrikular Mobitz 1;
- viii. bllok atrioventrikular i shkallës së parë.

3) Aplikantët me një histori të secilës prej gjendjeve të mëposhtme do t'i referohen autoritetit licencues dhe të kalojnë vlerësimin kardiologjik me rezultate të kënaqshme para se një vlerësim i gjendjes së përshtatshme shëndetësore të merret në konsideratë:

- i. terapia me ablacion;
 - ii. implantim i pacemakerit (stimuluesit) kardiak.
4. Aplikantët me një prej gjendjeve të mëposhtme duhet të vlerësohen me gjendje shëndetësore të paafte:
- i. sëmundje sinoatriale simptomatike;

- ii. bllok i plotë atrioventrikular;
- iii. zgjatje simptomatike e QT;
- iv. një sistem i implantuar automatik I i defribilimit kardiak;
- v. një pacemaler (stimulues) ventrikular antitakikardial.

ATCO.MED.B.015 Sistemi respirator

a) Aplikantët me dëmtim të konsiderueshëm të funksionit pulmonar do t'i referohen autoritetit licencues për vlerësim aeromjekësor. Një vlerësim i përshtatshme shëndetësore mund të merret në konsideratë sapo funksioni pulmonar rikuperohet dhe është i kënaqshëm.

b) Ekzaminimi:

Testet e funksionit pulmonar duhet të kërkohen në ekzaminimin fillestar dhe në bazë të indikacioneve klinike.

c) Aplikantët me një histori ose diagnozë të vendosur të astmës që kërkon mjekim do të kalojnë një vlerësim respirator të kënaqshëm. Një vlerësim i përshtatshme shëndetësore mund të merret në konsideratë nëse aplikanti është asimptomatik dhe trajtimi nuk prek sigurinë në operim.

d) Aplikantët me një histori ose diagnozë të vendosur si më poshtë do t'i referohen autoritetit licencues dhe do të kalojnë vlerësimin respirator me një rezultat të kënaqshëm para se një vlerësim i përshtatshëm shëndetësor mund të merret në konsideratë:

- 1) sëmundje aktive inflamatore e sistemit respirator;
- 2) sarkoidozë aktive;
- 3) pneumotoraks;
- 4) sindroma e apnesë në gjumë;
- 5) operacion/ndërrhyrje kirurgjike madhore e krahavorit;
- 6) sëmundje obstruktive kronike pulmonare;
- 7) transplantim mushkërie.

ATCO.MED.B.020 Aparati tretës

a) Aplikantët me çdo komplikim nga një sëmundje ose ndërhyrje kirurgjikale në çdo pjesë të aparatit të tretjes ose pjese përbërëse të tij që ka gjasë për të shkaktuar pa përshtatshmëri shëndetësore, në veçanti çdo pengesë për shkak të ngushtimit ose shtypjes në aparatit tretës, do të vlerësohen si të papërshtatshëm nga gjendja shëndetësore.

b) Aplikantët nuk duhet të kenë hernie që mund të çojë në simptoma paafësie.

c) Aplikantët me çrregullime të sistemit gastrointestinal, duke përfshirë ato në pikat 1 deri në



5 mund të vlerësohen si në gjendje shëndetësore të përshtatshme nëse i nënshtrohen vlerësimit të kënaqshëm gastroenterologjik dhe pas trajtimit të suksesshëm ose rikuperimit të plotë pas operacionit:

1) çrregullim i përsëritur dispeptik që kërkon mjekim;

2) pankreatiti;

3) gurët simptomatik në tëmth;

4) një diagnozë e vendosur ose histori e sëmundjes kronike inflamatore të zorrës;

5) pas operacionit kirurgjik në traktin e tretjes ose një pjesë të tij, duke përfshirë operacionin që përfshin prerjen totale ose të pjesshme ose një devijim të secilit prej këtyre organeve.

ATCO.MED.B.025 Sistemet metabolike dhe endokrine

a) Aplikantët me keqfunksionim metabolik, të ushqyerjes ose endokrin mund të vlerësohen me gjendje shëndetësore, të përshtatshme nga ana shëndetësore pasi të vlerësohen të qëndrueshëm nga ana klinike dhe vlerësimit të kënaqshëm aeromjekësor.

b) Diabeti melitus:

1) Aplikantët me diabet melitus që kërkojnë përdorim të insulinës do të vlerësohen me gjendje shëndetësore të papërshtatshme.

2) Aplikantët me diabet melitus që kërkojnë mjekim të ndryshëm nga insulina për kontrollin e sheqerit në gjak do t'i referohen autoritetit licencues. Një vlerësim i gjendjes së përshtatshme shëndetësore mund të konsiderohet nëse mund të tregohet që kontrolli i sheqerit në gjak është arritur në nivel të kënaqshëm dhe është i qëndrueshëm.

ATCO.MED.B.030 Hematologjia

a) Testimi i gjakut, duhet të vendoset nga AME ose AeMC duke marrë parasysh historinë mjekësore dhe duke ndjekur ekzaminimin mjekësor.

b) Aplikantët me një gjendje hematologjike, si:

1) çrregullim koagulimi, hemorragjik ose trombotik;

2) leucemi kronike;

3) hemoglobinë jonormale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në anemin, eritrocitozë ose hemoglobinopati;

4) Rritje e konsiderueshme e sistemit limfatik;

5) Rritje e shprekës;

b) do t'i referohen autoritetit licencues. Një vlerësim i gjendjes së përshtatshme shëndetësore mund të merret në konsideratë duke iu nënshtruar vlerësimit aeromjekësor të kënaqshëm.

c) Aplikantët që vuajnë nga leukemia akute do të vlerësohen si të papërshtatshëm të gjendjes shëndetësore.

ATCO.MED.B.035 Sistemi urogenital

a) Analiza e urinës do të përbëjë pjesë e çdo ekzaminimi aeromjekësor. Urina nuk duhet të përmbajë asnjë element jonormal që konsiderohet me rëndësi patologjike.

b) Aplikantët me çdo komplikim sëmundjeje ose procedurë kirurgjikale në sistemin urogenital ose pjesë të tij që ka gjasa të shkaktojë paaftësi, në veçanti çdo bllokim për shkak të ngushtimit ose shtypjes të kanaleve urogenitale, do të vlerësohen si të papërshtatshëm nga ana shëndetësore.

c) Aplikantët me një çrregullim urogenital, si:

1) sëmundje renale;

2) një ose më shumë gurë urinar;

mund të vlerësohen si të përshtatshëm nga ana shëndetësore duke iu nënshtruar vlerësimit të kënaqshëm renal /urologjik.

d) Aplikantët që kanë kaluar:

1) një operacion madhor kirurgjikal në sistemin urogenital ose pjesë të tij duke përfshirë prerjen totale ose të pjesshme ose një devijim të organeve të tij; ose

2) operacion madhor urologjik;

do t'i referohen autoritetit licencues për një vlerësim aeromjekësor pas rikuperimit të plotë para se një vlerësim i shëndetshëm të merret në konsideratë.

ATCO.MED.B.040 Sëmundje infektive

a) Aplikantët që janë HIV pozitiv do t'i referohen autoritetit licencues dhe mund të vlerësohen si të përshtatshëm nga ana shëndetësore duke iu nënshtruar vlerësimit specialist të kënaqshëm dhe me kusht që autoriteti licencues të ketë prova të mjaftueshme që terapia nuk ndikon me ushtrimin e sigurt të privilegjeve të licencës.

b) Aplikantët e diagnostikuar ose që paraqesin simptoma të sëmundjes infektive si:

1) sifilis akut;

2) tuberkuloz akut;

3) hepatit infektiv;

4) sëmundje tropikale;

do t'i referohen autoritetit licencues për një vlerësim aeromjekësor. Një vlerësim përshtatshëm nga ana shëndetësore mund të konsiderohet pas rikuperimit të plotë dhe vlerësimit specialist me kusht që autoriteti licencues të ketë prova të mjaftueshme që terapia



nuk ndikon me ushtrimin e sigurt të privilegjeve të licencës.

ATCO.MED.B.045 Obstetrika dhe gjinekologjia

a) Aplikantët që kanë kaluar një operacion gjinekologjik madhor do të vlerësohen si të përshtatshëm nga ana shëndetësore deri në rikuperimin e plotë.

b) Shtatzënia:

Në rastin e shtatzënisë, nëse AeMC ose AME konsideron që mbajtësja e licencës është e përshtatshëm nga ana shëndetësore për të ushtruar privilegjet e saj, ai/ajo do të kufizojë periudhën e vlefshmërisë së certifikatës mjekësore deri në fund të javës së 34-të të ngjizjes. Mbajtësja e licencës do të kalojë një ekzaminim dhe vlerësim aeromjekësor rivlerësimi pas rikuperimit të plotë pas përfundimit të shtatzënisë.

ATCO.MED.B.050 Sistemi muskuloskeletor

a) Aplikantët duhet të kenë përdorim funksional të kënaqshëm të sistemit muskuloskeletor për t'i mundësuar atyre që të ushtrojnë në mënyrë të sigurt privilegjet e licencës.

b) Aplikantët me gjendje statike ose progresive muskuloskeletore ose reumatologjike që ka gjasa të ndërhyjnë në ushtrimin e sigurt të privilegjeve të licencës do t'i referohen autoritetit licencues. Një përshtatshëm nga ana shëndetësore mund të konsiderohet pas vlerësimit kënaqshëm të specialist.

ATCO.MED.B.055 Psikiatria

a) Aplikantët me një çrregullim mendor ose të sjelljes për shkak të alkoolit ose përdorimit tjetër ose keqpërdorimit të substancave psikoaktive, duke përfshirë substancat rekreative me ose pa varësi, do të vlerësohen si të papërshtatshëm nga ana shëndetësore deri në një periudhë të vetëpërmbajtjes së dokumentuar ose mos përdorimit ose keqpërdorimit të substancave psikoaktive dhe i nënshtrohen vlerësimit psikiatrik të kënaqshëm pas trajtimit të suksesshëm. Aplikantët do t'i referohen autoritetit licencues.

b) Aplikantët me një gjendje psikiatrike, si:

- 1) çrregullim humori;
- 2) çrregullim neurotik;
- 3) çrregullim personaliteti;
- 4) çrregullim mendor ose i sjelljes;

do të kalojnë vlerësimin psikiatrik të kënaqshëm para se një vlerësim përshtatshëm nga ana shëndetësore të merret në konsideratë. Aplikantët do t'i referohen autoritetit licencues për vlerësimin e

përshtatshmërisë së tyre mjekësore.

c) Aplikantët me një histori të vetme ose të përsëritur të vetë-dëmtimit të paramenduar do të vlerësohen si të papërshtatshëm. Aplikantët do t'i referohen autoritetit licencues dhe do të kalojnë një vlerësim psikiatrik të kënaqshëm para se një vlerësim përshtatshëm nga ana shëndetësore të merret në konsideratë.

d) Aplikantët me një histori ose diagnozë klinike të skizofrenisë, skizotipalit, çrregullimit deluzional ose manisë do të vlerësohen si të pashëndetshëm.

ATCO.MED.B.060 Psikologjia

a) Aplikantët që paraqesin simptoma të lidhura me stresin që kanë gjasa të ndërhyjnë në aftësinë e tyre për të ushtruar privilegjet e licencës në mënyrë të sigurt do t'i referohen autoritetit licencues. Një vlerësim i përshtatshëm nga ana shëndetësore mund të merret në konsideratë vetëm pasi një vlerësim psikologjik dhe/ose psikiatrik të ketë treguar që aplikanti është rikuperuar nga simptomat e lidhura me stresin.

b) Një vlerësim psikologjik mund të kërkohet si pjesë ose shtesë e ekzaminimit psikiatrik ose neurologjik.

ATCO.MED.B.065 Neurologjia

a) Aplikantët me një histori ose diagnozë klinike si më poshtë do të vlerësohen si të papërshtatshëm nga ana shëndetësore:

1) epilepsi përveç në rastet në shkronjën (b)(1) dhe (2);

2) episode të përsëritura të çrregullimit të ndërgjegjes me shkak të pacaktuar;

3) gjendjet me pritshmëri të lartë për mosfunksionim cerebral.

b) Aplikantët me një histori ose diagnozë klinike të gjendjeve të mëposhtme do t'i referohen autoritetit licencues dhe kalojnë një vlerësim të mëtejshëm para se një vlerësim përshtatshëm nga ana shëndetësore të merret në konsideratë:

1) epilepsi pa episode të përsëritjes pas moshës 5-vjeçare;

2) epilepsi pa epizode të përsëritjes dhe pa trajtim për më shumë se 10 vjet;

3) anomali epileptiformë EEG dhe valë fokale të ngadalta;

4) sëmundje progresive ose joprogresive të sistemit nervor;

5) një episod i vetëm i shqetësimeve ose humbje e vetëdijes;

6) dëmtim truri;



7) dëmtim nervi spinal ose periferik;

8) çrregullime të sistemit nervor për shkak të deficiencave vaskulare duke përfshirë ngjarjet hemorragjike dhe ishemike.

ATCO.MED.B.070 Sistemi i shikimit

a) Ekzaminimi:

1) Një ekzaminim gjithëpërfshirës i syrit duhet të jetë pjesë e ekzaminimit fillestar dhe do të ndërmerret periodikisht në varësi të aftësisë së përthyerje së dritës dhe performancës funksionale të syrit.

2) Një ekzaminim rutinë i syrit do të përbëjë pjesë të të gjitha ekzaminimeve të rivlerësimit dhe të rinovimit.

3) Aplikantët duhet të kryejnë një tonometri në ekzaminimin e parë të rivlerësimit pas moshës 40-vjeçare, në rast indikacioni klinik dhe nëse tregohet duke marrë në konsideratë historinë e familjes.

4) Aplikantët do t'i vënë në dispozicion AeMC ose AME një raport ekzaminimi oftalmik në rastet kur:

i. performanca funksionale tregon ndryshime të konsiderueshme;

ii. standardet vizuale të distancës mund të arrihen vetëm me lente korrigjuese.

5) Aplikantët me një gabim të lartë përthyerjeje të dritës do t'i referohen autoritetit licencues.

b) Mprehtësia vizuale në distancë, me ose pa korrigjim optimal, do të jetë 6/9 (0,7) ose më mirë në secilin sy ndarazi dhe mprehtësia vizuale me të dy sytë do të jetë 6/6 (1,0) ose më mirë.

c) Aplikantët fillestar që kanë një vizion monokular ose funksional monokular, duke përfshirë problemet e balancës së muskulit të syrit, do të vlerësohen si të papërshtatshëm nga ana shëndetësore. Në ekzaminimet e rivlefshmërimit ose rinovimit aplikanti mund të vlerësohet si përshtatshëm nga ana shëndetësore me kusht që një ekzaminim oftalmologjik të jetë i kënaqshëm. Aplikanti do t'i referohet autoritetit licencues.

d) Aplikantët fillestar me vizionin e fituar nën standard në njërin sy do të vlerësohen si të papërshtatshëm nga ana shëndetësore. Në ekzaminimet e rivlefshmërimit ose rinovimit aplikanti do t'i referohet autoritetit licencues si i shëndetshëm me kusht që një ekzaminim oftalmologjik të jetë i kënaqshëm.

e) Aplikantët duhet të jenë në gjendje të lexojnë një tabelë N5 ose ekuivalente në 30–50 cm distancë dhe një tabelë N14 ose ekuivalente në distancë 60–

100 cm, nëse është e nevojshme me ndihmën e korrigjimit.

f) Aplikantët duhet të kenë fusha normale të të parit dhe funksion binokular normal.

g) Aplikantët që kanë kaluar një operacion në sy do të vlerësohen si të pashëndetshëm deri në rikuperimin e plotë të funksionit vizual. Një vlerësim i shëndetshëm mund të merret në konsideratë nga autoriteti licencues duke iu nënshtruar vlerësimit oftalmik të kënaqshëm.

h) Aplikantët me një diagnozë klinike të keratokonus do t'i referohen autoritetit licencues dhe mund të vlerësohen si të përshtatshëm nga ana shëndetësore pas një ekzaminimi të kënaqshëm nga një oftalmolog.

i) Aplikantët me diplopi do të vlerësohen si papërshtatshëm nga ana shëndetësore.

j) Syzet dhe lentet e kontaktit.

1) Nëse funksioni vizual është i kënaqshëm për detyrat e vlerësuara dhe arrihet vetëm me përdorimin e korrigjimit, syzet ose lentet e kontaktit duhet të sigurojnë funksion vizual optimal, të mirë toleruar dhe të përshtatshëm për qëllime të kontrollit të trafikut ajror.

2) Jo më shumë se një palë syze do të përdoren, gjatë ushtrimit të privilegjeve të licencës për të përmbushur kërkesat vizuale në të gjitha distancat.

3) Një set rezervë i syzeve korrigjuese të ngjashme do të jetë në dispozicion kur ushtrohen privilegjet e licencës.

4) Lentet e kontaktit, kur vihen gjatë ushtrimit të privilegjeve të licencës do të jenë lente kontakti monofokale, jo të lyera dhe joortokeratologjike. Lente kontakti memonovizion nuk do të përdoren.

5) Aplikantët me një gabim përthyerje të madh të dritës duhet të përdorin lente kontakti ose lente syzesh me indeks të lartë.

ATCO.MED.B.075 Të parit me ngjyra

Aplikantët duhet të jenë trikromatë normal.

ATCO.MED.B.080 Otorinolaringologjia

a) Ekzaminimi:

1) Një ekzaminim rutinë otorinolaringologjik do të përbëjë pjesë të të gjitha ekzaminimeve fillestare, rivlerësimit dhe rinovimit.

2) Dëgjimi do të testohet në të gjitha ekzaminimet. Aplikanti duhet të kuptojë me saktësi bisedat/të folurin kur testohet me secilin vesh në një distancë prej 2 metrash dhe me kokën e kthyer drejt AME.

3) Dëgjimi do të testohet me audiometri me ton



të pastër në ekzaminimin fillestar dhe në ekzaminimet e rivlerësimit ose rinovimit pasues çdo 4 vjet deri në moshën 40-vjeçare dhe çdo 2 vjet më pas.

4) Audiometri me ton të pastër:

i. Aplikantët për një certifikatë mjekësore të klasës 3 nuk duhet të kenë një humbje dëgjimi prej më shumë se 35 dB në secilën frekuencë prej 500, 1 000 ose 2 000 Hz, ose më shumë se 50 dB në 3 000 Hz, në secilin vesh ndarazi.

ii. Aplikantët që nuk përmbushin kriteret e dëgjimit më sipër do t'i referohen autoritetit licencues dhe do të kalojnë një vlerësim specialist para se një vlerësim përshtatshëm nga ana shëndetësore të merret në konsideratë. Aplikantët fillestar do të kalojnë një test të veçuar në bisedë. Aplikantët për një rivlerësim ose rinovim të certifikatës mjekësore të klasës 3 do të kalojnë një test dëgjimi funksional në mjedisin operacional.

5) Aparatet e dëgjimit:

i. Ekzaminimi fillestar: nevoja për aparate dëgjimi për t'u pajtuar me kërkesat e dëgjimit sjell papërshtatshmërinë.

ii. Ekzaminimet e rivlerësimit dhe rinovimit: një vlerësim përshtatshëm nga ana shëndetësore mund të merret në konsideratë nëse përdorimi i aparateve të dëgjimit ose një aparat i përshtatshëm prostetik përmirëson dëgjimin për të arritur një standard normal siç vlerësohet nga testimi funksional plotësisht në mjedisin operacional.

iii. Nëse një aparat prostetik nevojitet për të arritur standardin e dëgjimit normal, një set rezervë pajisjesh dhe aksesorësh, si bateri, do të jenë në dispozicion kur ushtrohen privilegjet e licencës.

b) Aplikantët me:

1) një proces patologjik kronik aktiv të veshit të brendshëm ose të mesëm;

2) shpimi i pashëruar ose keqfunksionimi i membranës së timpanit;

3) çrregullim i funksionit vestibular;

4) keqformimi i konsiderueshëm ose infeksioni kronik i konsiderueshëm i kavitetit oral ose traktit respirator të sipërm;

5) çrregullim i konsiderueshëm i të folurit ose zërit që redukton kuptueshmërinë;

do t'i referohen autoritetit licencues dhe do të kalojnë ekzaminimin dhe vlerësimin e mëtejshëm ORL për të vendosur që gjendja nuk ndërhyr me ushtrimin e sigurt të privilegjeve të licencës.

ATCO.MED.B.085 Dermatologjia

Aplikantët nuk duhet të kenë gjendje dermatologjike të tillë që të çrregullojë ushtrimin e sigurt të privilegjeve të licencës së mbajtur.

ATCO.MED.B.090 Onkologjia

a) Pas diagnozës së sëmundjes malinje primare ose sekondare, aplikantët do t'i referohen autoritetit licencues dhe do të kalojnë vlerësimin e kënaqshëm onkologjik para se një vlerësim përshtatshëm nga ana shëndetësore mund të merret në konsideratë.

b) Aplikantët me një histori të vendosur ose diagnozë klinike të një tumori malinj intracerebral do të vlerësohen si të pashëndetshëm.

NËNPJESA C

EKZAMINUESIT AEROMJEKËSOR (AME)

ATCO.MED.C.001 Privilegjet

a) Në përputhje me këtë pjesë, privilegjet e një AME janë për të rivlerësuar dhe rinovuar certifikatat mjekësore të klasës 3 dhe për të kryer ekzaminimet dhe vlerësimet aeromjekësore përkatëse.

b) Qëllimi i privilegjeve të AME, dhe çdo kushti këtu, do të specifikohet në certifikatë.

c) Mbajtësit e një certifikatë AME nuk do të ndërmarrin ekzaminime dhe vlerësime aeromjekësore në një vend të ndryshëm nga vendi që ka lëshuar certifikatën e tyre AME, përveç nëse:

1) u është dhënë akses nga vendi pritës për të ushtruar aktivitetet e tyre profesionale si një doktor i specializuar;

2) kanë informuar autoritetin kompetent të vendit pritës mbi qëllimin e tyre për të kryer ekzaminimet dhe vlerësimet aeromjekësore dhe për të lëshuar certifikata mjekësore brenda qëllimit të privilegjeve të tyre si AME; dhe

3) kanë marrë udhëzime nga autoriteti kompetent i vendit pritës.

ATCO.MED.C.005 Aplikimi

a) Aplikimi për një certifikatë AME do të dorëzohet në përputhje me procedurën e vendosur nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Aplikantët për një certifikatë AME do t'i sigurojnë Autoritetit të Aviacionit Civil:

1) detajet personale dhe adresën profesionale;

2) dokumentacionin që tregon që ata përputhen me kërkesat e vendosura në ATCO.MED.C.010, duke përfshirë certifikatat e përfundimit të kurseve të trajnimit në mjekësinë e aviacionit të



përshtatshme për privilegjet që ata aplikojnë;

3) një deklaratë me shkrim që AME do të lëshojë certifikatat mjekësore mbi bazën e kërkesave të kësaj pjese.

c) Kur AME-të marrin përsipër ekzaminimet aeromjekësore në më shumë se një vend, ata do t'i ofrojnë Autoritetit të Aviacionit Civil të gjitha informacionet përkatëse në lidhje me të gjitha vendet e praktikës dhe facilitetet.

ATCO.MED.C.010 Kërkesat për lëshimin e një certifikatë AME

Aplikantët për një certifikatë AME me privilegjet për rivlefshmërimin dhe rinovimin e certifikatave mjekësore të klasës 3:

a) do të jenë plotësisht të kualifikuar dhe licencuar për praktikën e mjekësisë dhe do të mbajnë një Certifikatë Përfundimi ose do të kenë dëshmi të trajnimit mjekësor si specialist;

b) do të kenë përfunduar me sukses kurset e trajnimit bazë dhe të avancuar në mjekësinë e aviacionit, duke përfshirë modulet specifike për vlerësimin aeromjekësor të kontrollorëve të trafikut ajror dhe mjedisin specifik në kontrollin e trafikut ajror;

c) do t'i tregojnë Autoritetit të Aviacionit Civil që ata:

1) kanë facilitetet, procedurat, dokumentacionin dhe pajisjet e funksionimit të përshtatshme për ekzaminimet aeromjekësore; dhe

2) kanë procedurat dhe kushtet e nevojshme për të siguruar konfidencialitetin mjekësor.

ATCO.MED.C.015 Kurset e trajnimit në mjekësinë e aviacionit

a) Kurset e trajnimit në mjekësinë e aviacionit duhet të miratohen nga autoriteti kompetent i vendit ku ofruesi i trajnimit ka vendin e tij kryesor të biznesit. Ofruesi i trajnimit do të tregojë që plani i kursit përmban objektivat mësimore për të fituar kompetencat e nevojshme dhe personat e ngarkuar me ofrimin e trajnimit kanë njohuritë dhe eksperiencën e përshtatshme.

b) Përveç në rastin e trajnimit rifreskues, kurset duhet të kenë nga një ekzaminim me shkrim mbi subjektet e përfshira në përmbajtjen e kursit.

c) Ofruesi i trajnimit do të lëshojë një certifikatë të përfundimit për aplikantët kur ata kanë kaluar ekzaminimin.

ATCO.MED.C.020 Ndryshimet në certifikatën AME

a) AME do të njoftojë Autoritetin e Aviacionit

Civil për rrethanat e mëposhtme që mund të prekin certifikatën e tyre:

1) AME i nënshtrohet procedimeve disiplinore ose investigimit nga një organ rregullator mjekësor;

2) ka ndryshime në kushtet mbi të cilat certifikata është dhënë, duke përfshirë përmbajtjen e deklaratave të ofruara me aplikimin;

3) kërkesat për lëshimin e një certifikatë AME nuk përmbushen më;

4) ka një ndryshim në vendin e praktikës së ekzaminuesit aeromjekësor ose adresën korresponduese.

b) Dështimi për të informuar Autoritetin e Aviacionit Civil do të çojë në pezullimin ose revokimin e privilegjeve të certifikatës AME, mbi bazën e vendimit të Autoritetit të Aviacionit Civil që pezullon ose revokon certifikatën.

ATCO.MED.C.025 Vlefshmëria e certifikatave AME

Një certifikatë AME do të lëshohet për një periudhë që nuk kalon 3 vjet. Ajo do të rivlefshmërohet me kusht që mbajtësi:

a) Vazhdon të përmbushë kushtet e përgjithshme të kërkuara për praktikën mjekësore dhe qëndron i regjistruar si një praktikues mjekësor;

b) Ka ndërmarrë trajnimin e përditësuar në mjekësinë e aviacionit dhe në mjediset e punës së kontrollorëve të trafikut ajror brenda 3 vjetëve të fundit;

c) Ka kryer së paku 10 ekzaminime aeromjekësore çdo vit. Ky numër i ekzaminimeve mund të reduktohet vetëm nga Autoriteti i Aviacionit Civil në rrethana të justifikuara siç duhet;

d) Qëndron në përputhje me termat e certifikatës së tij AME; dhe

e) Ushtron privilegjet e AME në përputhje me këtë pjesë.

**VENDIM****Nr. 294, datë 13.11.2025****MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT “PËR MËNYRËN E PASQYRIMIT TË KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË FATURËN MUJORE DHE IDENTIFIKIMIN E NDARË TË KATEGORIVE TË KONSUMATORËVE DHE ZBATIMIN E ÇMIMEVE PËRKATËSE”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 81 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “c”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe PROCEDURAT e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Konsumatori, Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve dhe Sekretari i Përgjithshëm me nr. 2818 prot., datë 10.11.2025, “Mbi miratimin e udhëzimit ‘Për mënyrën e pasqyrit të konsumit të energjisë elektrike në faturën mujore dhe identifikimin e ndarë të kategorive të konsumatorëve dhe zbatimin e çmimeve përkatëse’”;

konstatoi se:

- ERE në ushtrim të kompetencave të tij ligjore të përcaktuara ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, me qëllim sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm, mbrojtjen e konsumatorëve dhe garantimin e transparencës dhe efikasitetit në tregun e furnizimit.

- ERE ka kompetencën për të miratuar metodologjitë e tarifimit, tarifat dhe çmimet e furnizimit publik me pakicë, për kategori të ndryshme konsumatorësh, si dhe për të përcaktuar rregullat e faturimit dhe detyrimet e furnizuesve ndaj konsumatorëve fundorë.

- Në zbatim të kësaj kompetence, ERE ka miratuar vendime të veçanta për miratimin e tarifave të furnizimit publik me energji elektrike për kategoritë e mëposhtme të konsumatorëve, të cilat janë në fuqi dhe zbatohen nga furnizuesit publikë:

- Familjar;
- Familjar me konsum nën 700 kwh;

- Jofamiljar;
- Objekte kult;
- Furra buke/prodhim mielli;
- Pika/stacione karikimi automjetesh elektrike (EV);

- Ujësjiellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV/20 kV/10 kV/6 kV.

- ERE vlerëson të nevojshëm hartimin e një udhëzimi për të përcaktuar modalitetet e pasqyrit në fatura mujore të konsumit të energjisë elektrike dhe çmimit të miratuar të aplikueshëm, në varësi të kategorisë së cilës i përket konsumatori.

- Aktualisht, rezulton se FSHU sh.a., në cilësinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, nuk evidenton në emërtesë apo të dhënat e faturës kategorinë e konsumatorit ndaj të cilit ofron shërbimin si FSHU, apo si FMF.

- Në faturat e lëshuara nga Furnizuesit për kategorinë e konsumatorëve vetëprodhues nuk evidentohet kategoria së cilës konsumatori i përket, si dhe ndarja mes sasisë së energjisë së prodhuar nga konsumatori vetëprodhues dhe sasisë së energjisë së marrë nga vetëprodhuesi prej furnizuesit që i ofron shërbimin e furnizimit.

- Faturimi për konsumatorët që i përkasin kategorisë furrë buke/prodhim mielli, nuk evidenton në të dhënat e faturës kategorinë apo nënkategorinë së cilës i përket konsumatori për të cilin lëshohet fatura e konsumit të energjisë sipas nënkategorive: kategoria I – vetëm furra buke/prodhim mielli; kategoria II – furrë buke, produkte mielli shoqëruese, pastiçeri; kategoria III – furrë buke, produkte mielli shoqëruese, pastiçeri, shërbim kafe (ekspres) parashikon aplikimin e çmimeve të ndryshme.

- Me qëllim pasqyrimin e saktë e të drejtë të kategorisë së cilës i përket konsumatori, i cili përfiton çmimin sipas nënkategorive të miratuara nga ERE, në këtë udhëzim të parashikohen detyrime për reflektimin e të dhënave të detajuara të kategorisë së konsumatorit, në informacionin e përcjellë në faturën e konsumit të energjisë elektrike apo së bashku me faturën.

- Mbështetur në parimet e nenit 81, të ligjit nr. 43/2015, konsumatori, së bashku me faturën e energjisë, ka të drejtë të informohet në mënyrë të qartë dhe të plotë për çmimet, tarifat, kushtet e furnizimit dhe elementet që përbëjnë faturën mujore të energjisë elektrike.



- Po ashtu, mbështetur në neni 11 i Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Furnizimit të Energjinë Elektrike përcakton se furnizuesi është i detyruar të përfshijë në faturë, të dhënat identifikuese të konsumatorit dhe pikës së lidhjes, periudhën e faturimit, sasinë e konsumuar të energjisë elektrike, çmimin për njësi sipas strukturës së tarifës së miratuar nga ERE, dhe çdo informacion tjetër që lidhet me kostot e shërbimit të furnizimit.

- Zbatimi i këtij udhëzimi do të mundësojë kontrollin efektiv të zbatimit të tarifave të miratuara, do të shmangë abuzimet e mundshme në klasifikimin e konsumit dhe do të garantojë një nivel të lartë transparence, në përputhje me detyrimet ligjore dhe standardet e mbrojtjes së konsumatorit në sektorin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Udhëzimit për mënyrën e pasqyrimit të konsumit të energjisë elektrike në faturën mujore, identifikimin e ndarë të kategorive të konsumatorëve dhe zbatimin e çmimeve përkatëse” (bashkëlidhur).

2. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Konsumatore të njoftojë palët e interesit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe aplikohet për faturimet që kryhen, duke filluar nga muaji dhjetor 2025.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

UDHËZIM

PËR MËNYRËN E PASQYRIMIT TË KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË FATURËN MUJORE, IDENTIFIKIMIN E NDARË TË KATEGORIVE TË KONSUMATORËVE DHE ZBATIMIN E ÇMIMEVE PËRKATËSE

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së detajuar të pasqyrimit të konsumit të energjisë elektrike në faturat mujore të furnizimit, me qëllim sigurimin e transparencës, ndarjen e qartë të konsumit sipas kategorive të konsumatorëve dhe garantimin e aplikimit të drejtë të tarifave dhe çmimeve përkatëse për çdo kategori konsumatori.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim zbatohet nga furnizuesi publik i energjisë elektrike, furnizuesit e tregut të lirë për kategoritë përkatëse të konsumatorëve ndaj të cilëve ofrojnë shërbim dhe operatorin e sistemit të shpërndarjes (OSSH), si dhe për të gjithë konsumatorët fundorë, që kanë lidhur kontrata furnizimi për kategori të ndryshme konsumatore të përcaktuara nga ERE.

2. Dispozitat e këtij udhëzimi janë të detyrueshme për subjektet që realizojnë faturimin, matjen dhe raportimin e konsumit të energjisë elektrike ndaj konsumatorëve.

Neni 3

Ndarja e konsumit në faturë sipas kategorive tarifore

1. Konsum familjar/jofamiljar:

a) Konsumi për nevoja familjare duhet të pasqyrohet në faturë në mënyrë të qartë dhe të veçantë, me aplikimin e çmimit të miratuar nga ERE.

b) Rubrika përkatëse në faturë duhet të mbajë titullin “Konsum familjar” dhe të shoqërohet me matësin përkatës.

2. Konsum për karikimin e automjeteve elektrike (EV):

a) Në rastet kur konsumatori ka të instaluar një pikë/stacion karikimi të makinave elektrike me fuqi



të instaluar mbi 11 kw dhe është i lidhur në nivelin e tensionit 04 kV, energjia e përdorur për karikimin e automjetit elektrik duhet të matet përmes një njësie matëse të pavarur.

b) Konsumi për karikimin e automjetit elektrik duhet të pasqyrohet në faturë të veçantë me titullin “Konsum për karikim automjeti elektrik (EV)”, me aplikimin e çmimit përkatës të miratuar nga ERE.

c) Furnizuesi duhet të specifikojë në faturë-fuqinë përkatëse të instaluar në kw për kategorinë e konsumatorit mbi 11 kw.

3. Konsumatorë vetëprodhues:

a) Për konsumatorët që prodhojnë energji elektrike nga burime të rinovueshme (panele fotovoltaike etj.), fatura mujore duhet të përmbajë dy rubrika të ndara:

- “Energjia e prodhuar nga vetë konsumatori (kwh)”;

- “Energjia e marrë nga rrjeti (kwh)”.

b) Faturimi neto ndërmjet energjisë së prodhuar dhe asaj të marrë nga rrjeti llogaritet dhe reflektohet në faturë, sipas metodologjisë së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

c) Furnizuesi është i detyruar të garantojë pasqyrimin e qartë dhe të lexueshëm të të dhënave të vetëprodhimit në faturën mujore.

Neni 4

Identifikimi i kategorisë së konsumatorit në faturë

1. Çdo faturë mujore duhet të përmbajë seksionin “Kategoria e konsumatorit sipas kontratës”, ku të shënohet qartë kategoria përkatëse.

2. Kategoritë që duhet të identifikohen në faturë janë:

- Familjar;
- Të tjerë të lidhur në 0.4 të furnizuar nga Furnizuesi Universal;
- Familjar me konsum nën 700 kw
- Konsumator i FMF-së;
- Objekt kulturi;
- Furra buke/prodhim mielli (sipas nënkategorive);
- Pika/stacione karikimi automjeteve elektrike (EV);
- Vetëprodhues (me burime të rinovueshme të energjisë);
- Ujësjellës-kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV/20/10/6 kV.

- Të tjera, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

3. Mosidentifikimi i kategorisë përbën shkelje të detyrimeve të faturimit dhe u nënshtrohet masave administrative sipas vendimeve të ERE-s.

Neni 5

Detyrimet e furnizuesve dhe operatorëve të rrjetit

1. Furnizuesit e energjisë elektrike janë të detyruar të:

- përditësojnë sistemet e faturimit elektronik për të mundësuar pasqyrimin dhe faturimin e konsumit sipas kategorive të konsumatorëve;

- raportojnë çdo tre muaj pranë ERE-s listën e kontratave të konsumatorëve që disponojnë pajisje karikimi për automjete elektrike dhe/ose kapacitete vetëprodhimi.

2. Operatori i sistemit të shpërndarjes (OSSH) ose Operatori i Transmetimit ka detyrimin të:

- verifikojë instalimet matëse për konsumet e ndara;

- sigurojnë që matjet të jenë të sakta, të certifikuar dhe të azhurnuara sipas standardeve metrologjike në fuqi.

- raportojnë çdo tre muaj pranë ERE mbi sasinë e energjisë së shpërndarë për çdo kategori të përcaktuar në nenin 4 pika 2, fuqinë e instaluar/ngarkesë për çdo pikë, si dhe shpërndarjen gjeografike të çdo pike.

Neni 6

Zbatimi dhe kontrolli

1. Zbatimi i këtij udhëzimi është detyrë e furnizuesve dhe operatorëve të sistemit të shpërndarjes.

2. Kontrolli i zbatimit kryhet nga ERE dhe njoftohet rregullisht Agjencia për Eficiencën e Energjisë (AEE) për gjetjet.

3. Në rastet e shkeljeve të përcaktuara në këtë udhëzim, ERE do të marrë masa administrative në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 7

Të tjera

1. Për konsumatorët ekzistues, të cilët kanë një pikë/stacion karikimi me fuqi të instaluar mbi 11 kw, të lidhur në nivelin e tensionit 0,4 kV, të cilët kanë



një pikë lidhjeje të miratuar, por nuk kanë një kontratë furnizimi, Furnizuesi i Shërbimit Universal duhet të gjenerojë një kontratë të re furnizimi. Konsumatorët ekzistues nuk ngarkohen me kosto shtesë për instalimin e një sistemi matjeje për këto pika/stacione karikimi.

2. Të gjithë konsumatorët që aplikojnë për herë të parë për një pikë/stacion karikimi me fuqi të instaluar mbi 11 kw të lidhur në nivelin e tensionit 0,4 kV, duhet të lidhin kontratë të re me furnizuesin, i cili ofron këtë shërbim.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rruga “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 480 lekë

